


 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	001 Nr.49/2026	Data: 30.03.2026	

Kuvendi i Komunës në baze të nenit 40 paragrafi 40.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008) dhe nenit 33 paragrafi 33.1 pika 4 të Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62/2010, në mbledhjen e mbajtur me 30.03.2026 Shqyrtoj Raportin e punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2025, dhe nxjerri këtë:

NJOFTIMIN ME RAPORTIN E PUNË SË KRYETARIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2025

1. Kuvendi i Komunës shqyrtojë Raportin e punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2025.
2. Raporti është pjesë përbërës e këtij njoftimi.
3. Me kopje të këtij Njoftimi të njoftohen: Kryetari i Komunës dhe një kopje mbetet në arkivin e Kuvendi.

 REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E ISTOGUT - OPŠTINA ISTOK DIREKTORATI PËR ADMINISTRATË - DIREKCIJA UPRIVE	
Nr./Br. <u>001-039-11</u> Nr. i faq/Br.str. <u>1</u>	
Data/Datum <u>31 / 03 / 2026</u> ISTOG • ISTOK	

Kryesuesi i Kuvendit
z. Enver Rugova

Enver Rugova





REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E ISTOGUT - OPSTINA ISTOK
DREJTORATI PER ADMINISTRATE - DIREKCIJA UPRAVE

Nr./Br. 01-016-8641 II Nr. i faq/Br.str.

Data/Datum 19 / 03 / 2026
ISTOG • ISTOK



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E ISTOGUT/ OPSTINA ISTOK/ MUNICIPALITY OF ISTOG

KRYETARI/PREDSIEDNIK/MAYOR

R A P O R T

I PUNËS SË KRYETARIT PËR PERIUDHËN

JANAR-DHJETOR 2025

PËRMBAJTJA:

1. HYRJE	3-9
2. DREJTORIA PËR ADMINISTRATË KOMUNALE.....	10-26
3. DREJTORIA PËR INSPEKSION.....	27-31
4. DREJTORIA PER BUXHET DHE FINANCA.....	31-71
5. DREJTORIA PËR EKONOMI DHE ZHVILLIM.....	72-77
6. DREJTORIA PËR KADASTËR, PRONË DHE GJEODEZI.....	78-79
7. DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MJEDIS.....	80-84
8. DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT.....	85-91
9. DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT	92-99
10. DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL.....	100-106
11. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI	106-118
12. DREJTORIA PËR EMERGJENCA MBROJTJE DHE SHPETIM.....	119-131
13. DREJTORIA PËR PUNË DHE MIRËQENIE SOCIALE.....	132-158
14. DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE.....	158-162
15. ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM.....	163-165

HYRJE

Udhëheqësi i Komunës

Komuna, si njësi themelore e pushtetit lokal, funksionon në bazë të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/08), Statutit të Komunës si akti më i lartë i komunës, si dhe Ligjeve të tjera me të cilat janë përcaktuar kompetencat dhe fusha e veprimtarisë së saj. Me ligjin e përmendur janë përcaktuar struktura dhe organet e pushtetit lokal, ndërsa Komunave u është lënë hapësirë për formimin e drejtorive, respektivisht përcaktimin e numrit të tyre. Në këtë kontekst, si organet e Komunës në Ligjin për vetëqeverisjen lokale janë përcaktuar: Kryetari, si organi më i lartë ekzekutiv, i zgjedhur drejtpërdrejt nga qytetarët, dhe Kuvendi Komunal, si organi më i lartë vendimmarrës.

Kryetari i Istogut, z. Ilir Ferati (LDK), është zgjedhur në zgjedhjet lokale të vitit 2025. Lidhja Demokratike e Kosovës mban 12 nga 27 ulëset në Asamblenë Komunale. Partia e dytë më e madhe, me 6 ulëse, është AAK, e përcjellur nga VV me 5 anëtarë të asamblesë, PDK me 3 anëtar dhe GIBI me një ulëse. Në kuadër të kuvendit janë themeluar dy komitete obligative: Komiteti për Politikë dhe Financa, Komiteti për Komunitete, Komiteti për barazi gjinore dhe komitete të tjera, siç parashihen me ligj. Komuna publikon procesverbalin dhe të gjitha aktet e miratuara nga takimi i Asamblesë në ueb-faqen komunale.

Komuna e Istogut është e organizuar në 13 drejtori dhe Zyra Komunale për Komunitet dhe Kthim, duke shtuar Zyrën e Kryetarit, përgjegjëse për obligimet horizontale të komunës.

KRYETARI I KOMUNËS

Kryetari është organi më i lartë ekzekutiv, i zgjedhur drejtpërdrejt nga qytetarët, i cili e përfaqëson komunën. Gjatë këtij viti, Kryetari i Komunës, në veçanti, krahas punëve dhe obligimeve të tjera, ka shqyrtuar dhe realizuar çështje të rëndësishme nga përgjegjësitë komunale duke:

- Realizuar projektet prioritare të përcaktuara nga viti i kaluar dhe ato të përcaktuara nga ky vit;
- Shqyrtuar kërkesat e ndryshme të qytetarëve;

- Organizuar dhe menaxhuar organet komunale të administratës dhe i ka kompletuar ato me profesionistë, duke angazhuar përkushtim të vazhdueshëm në organizimin dhe sistematizimin e shërbimit civil, në mënyrë që qytetarët të kenë qasje më të lehtësuara për kryerjen e shërbimeve komunale;
- Hartuar dhe propozuar rregulloret dhe vendimet e ndryshme në fushën e kompetencave komunale, të cilat kanë kaluar nëpër Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Kuvendin për miratim;
- Kryer detyrat dhe punët e tjera të rregullta, të përcaktuara nga fusha e veprimtarisë dhe kompetencat e tij.

Kryetari i Komunës në periudhën Janar-Dhjetor 2025 ka nënshkruar gjithsej 23 (njëzetë e tre) Memorandume Bashkëpunimi (MB), ndër to marrëveshje me Ministrinë e Administratës së Pushtetit Lokal, MBPZHR-në, KFOR-in, Këshillin Evropian, Fondin Kosovar për Efikasitet të Energjisë, Organizata Joqeveritare (OJQ), etj. Në kuadër të Zyrës së Kryetarit funksionojnë edhe: Zyra e Integriteteve Evropiane, Zyra Ligjore, Zyra e Komunikimit dhe Informimit, Zyra e Menaxherit të Personelit, Avokati Publik dhe Auditori i Brendshëm. Në kuadër të Zyres së Integriteteve Evropiane dhe Zyres Ligjore hartohen planet operative për përmbushjen e prioriteteve për integritete evropiane, ofrohen këshillime dhe mendime profesionale juridike, ofrimi i ndihmës dhe hartimi i projekt-rregulloreve komunale, etj. Në kuadër të Zyres së Informimit në mënyrë të rregullt ofrohen informata për opinionin dhe mediat elektronike dhe ato të shkruara për të gjitha aktivitetet e Kryetarit, Drejtorateve, dhe punën në përgjithësi të organeve komunale të administratës, si dhe bëhet azhurnimi dhe mirëmbajtja e ueb faqes së komunës.

Avokati publik, në pajtim me ligjet pozitive në fuqi, mbron interesat e Komunës pranë gjykatave kompetente.

Gjatë kësaj periudhe të qeverisjes, është bërë një punë e madhe në aspektet e propozimeve dhe realizimeve të projekteve kapitale të rëndësishme për komunën tonë. Janë identifikuar prioritetet e tjera, dhe është vazhduar me prioritetet të cilat janë realizuar dhe do të paraqiten në vijim në kuadër të raportimeve të drejtorateve përkatëse. Krahas synimeve të cekura më lartë, Kryetari ka kryer edhe punë të tjera, duke përfshirë kontaktimin me organizata të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare, përfaqësues të OSBE-së dhe KFOR-it dhe vizita të ndryshme të niveleve ndërkombëtare, qeveritare, komunale, që i ka bërë Kryetari dhe që i janë bërë komunës sonë në këtë periudhë njëvjeçare.

ZYRA E INTEGRIMEVE EVROPIANE

RAPORTI I PUNËS PËR PËRIUDHËN JANAR-DHJETOR 2025

Zyra për Integritet Evropian (ZIE) nuk ka zyrtarin përgjegjës i cili kryen punët dhe obligimet në përputhje me Rregulloren 08/2011 për Organizimin dhe Përgjegjësitë e Zyrave Komunale për Integritet Evropian. Zyrtarët vazhdimisht informohen për të siguruar se punët janë në përputhje me standardet evropiane si dhe hulumtojnë programe të ndryshme të asistencës së BE-së dhe donatorëve të tjerë për të ofruar mbështetje për qeverisje të mirë dhe zhvillim lokal.

SEKTORI LIGJOR

RAPORTI I PUNËS PËR PËRIUDHËN JANAR-DHJETOR 2025

Raporti punës i Sektorit Ligjor për periudhën janar-dhjetor të vitit 2025

Janë nxjerr:

- Vendime- njëmijënjëqindpesëdhjetë (1,152);
- Kontrata të ndryshme- njëqindpesëmbëdhjetë (115);
- Marrëveshje të ndryshme- tridhjeteshtatë (37);
- Shkresa të ndryshme- tridhjetepesë(35);
- Autorizime-gjashtëmbëdhjetë (16);
- Propozim-vendime të ndryshme për Kuvend- katër dhjetë e dy (42);
- Njoftime për dëgjime me qytetar- dhjetë (10);

- Lëndë për shqyrtimin e të drejtës banesore- gjashtë (6),
- Në këtë vit janë pranuar- njëqindnjëzetetë (128) kërkesa për legalizime;
- Vendime për legalizime janë nxjerr- pesëdhjetë (50);
- Në listë të pritjes janë- njëmbëdhjetë (11) kërkesa;
- Pëlqime- pesë (5);
- Pezullime janë lëshuar- shtatëdhjetepesë (75)
- Njoftime për parashtruesit e kërkesave janë lëshuar- trembëdhjetë (13);
- Informata për palët janë dhënë për PZHK dhe HZK ndërrim destinimi të pronës- pesë (5);
- Për emërimin dhe riemërimin e rrugëve janë pranuar- katër (4) kërkesa;
- Pajisja me numra të shtëpisë- tetëdhjeteshtatë (87);
- Janë shqyrtuar dhe përfunduar shumë lëndë të shërbimit pronëso- juridik shumë lëndë të Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mjedis; shumë lëndë të Drejtorisë për Gjeodezi e Kadastër të protokolluara me protokoll të Drejtorive.
- Gjata kësaj periudhe kanë prezantuar ne teren në njëmbëdhjetë (11) raste të uzurpimeve;
- Gjata kësaj periudhe kanë prezantuar ne teren në tetë (8) raste të matjeve të parcelave me ekipin e gjeodetëve .
- Kanë përpiluar njoftimet për palët të cilët kanë në shfrytëzim pronat komunale dhe lokalet e karakterit

të përkohshëm .

Kanë marr pjesë ne komisionin si pjesë teknike për hapjen e ofertave për Dhënien në shfrytëzim të pronës paluajtshme komunale.

Udhëheqësja e Sektorit Ligjor në bashkëpunim me Zyrtaret Ligjor, kanë punuar në Grupe punuese për hartimin e rregulloreve të ndryshme komunale; për hartimin e Planeve të Veprimit; Puna në Komisione të ndryshme; monitorimi i zbatimit të Rregulloreve Komunale; monitorimi i zbatimit të Planit të Veprimit për Barazi Gjinore; Puna për mbledhjen e të dhenave në fushën e legjislacionit gjatë vitit 2025 për performancën komunale; Përgatitja dhe marrja pjesë në mbledhjet e Kuvendit të Komunës; mbledhjen e Komitetit për Politik dhe Financa; Bashkëpunimi-konsulltimi me Drejtoret e Drejtorive si dhe zyrtaret komunal lidhur me zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi; dhënia e mendimeve ligjore; Punimi i raporteve të ndryshme; Futja në sistem elektronik e të gjitha lendve të kryera; Pjesëmarrja në trajnime të ndryshme brenda vendit dhe jashtë vendi; në trueza të rumbullakëta; në konferencat të ndryshme si dhe janë kryer edhe shumë punë tjera të dhënë nga mbikëqyrësi.

ZYRA PËR KOMUNIKIM DHE INFORMIM
RAPORTI I PUNËS PËR PËRIUDHËN JANAR-DHJETOR 2025

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2025, Zyra për Informim dhe Komunikim me Publikun e cila funksion në kuadër të Kabinetit të Kryetarit të Komunës z. Ilir Ferati, ka vazhduar me punën e saj të përditshme, duke pasqyruar në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha informacionet e duhura që kanë të bëjnë me punën dhe aktivitetet e Komunës së Istogut.

Kjo zyrë ka lëshuar çdo ditë të punës komunikata nga më të ndryshme të cilat kanë pasqyruar punën e cila zhvillohet brenda institucionit të Komunës së Istogut.

Zyra për Informim dhe Komunikim me Publikun (ZIK), ka arritur që të lëshoj mbi 700 komunikata dhe komunikime të ndryshme që përmes ueb-faqes dhe faqes zyrtare të Komunës së Istogut në rrjetet sociale, kanë informuar qytetarët mbi menaxhimin si dhe aktivitete të përditshme të komunës sonë.

Ueb-sajti i komunës sonë çdo ditë është i freskët me plasimin e të gjitha lajmeve dhe ngjarjeve në komunën tonë, përfshirë këtu paralajmërimet e ngjarjeve, përcjelljen e ngjarjeve në komunë, por edhe jashtë komunës.

Në mënyrë që Komuna e Istogut të jetë sa më efikase dhe të ketë një transparencë sa më të madhe karshi shoqërisë civile, medias dhe faktorëve të tjerë relevantë, kemi bërë raportime të rregullta edhe mbledhjet e kuvendit, procesverbalet e kuvendit, po ashtu edhe procesverbalet e mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete, komitete këto që janë obligative për komunën.

Rregulloret e nxjerra nga Kuvendi i Komunës, të gjitha janë publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Po ashtu vlen të theksohet se ne ueb faqe, bëhen publike vazhdimisht të gjitha njoftimet dhe konkurset, ndërkohë që aty pasqyrohen edhe të gjitha vendimet e marra nga Kryetari i Komunës si dhe vendimet e drejtorive komunale. Është punuar mjaft shumë edhe në publikimin e të gjitha kontratave të Zyrës së Prokurimit, por edhe njoftimeve të ndryshme të po kësaj zyreje.

Përparësi e ueb faqes së Komunës së Istogut është edhe ajo se secili lajm, informacion, njoftim dhe konkurs bëhet përveç në gjuhën shqipe, edhe në atë të komunitetit pakicë serb.

Në ueb faqen tonë, qytetarët e interesuar, shoqëria civile dhe mediat po ashtu mund të gjejnë të publikuara edhe të gjitha pasqyrat financiare, projektet e realizuara, projektet që do të realizohen dhe gjithçka tjetër që mund të jetë në interesin e tyre.

Në kuadër të Zyrës për Informim dhe Komunikim me Publikun funksionon edhe zyrtarja për Qasje në Dokumente Publike. Gjate periudhës Janar-Dhjetor kemi pasur nënte (17) kërkesë për qasje të miratuar.

Po ashtu në zyrën për Informim dhe Komunikim me Publikun funksionon edhe zyrtari për konsultime publike. Gjatë periudhës Janar – Dhjetor janë mbajtur një (2) Takime Publike të Kryetarit, shtatë (6) Dëgjime Buxhetore dhe pesë (8) Konsultime Publike, gjithsej 16 Takime Publike me Qytetarë.

ZYRA E MENAXHERIT TË PERSONELIT

RAPORTI I PUNËS PËR PËRIUDHËN JANAR-DHJETOR 2025

I. QËLLIMI I RAPORTIT

Ky raport përmbledh punën Një vjeçare të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (NMBNJ), duke reflektuar aktivitetet, sfidat, arritjet dhe rekomandimet për përmirësim në funksion të menaxhimit efikas të personelit komunal.

II. FUSHAT KRYESORE TË PUNËS

1. Menaxhimi i dokumentacionit personal të stafit

- Janë rifreskuar dhe sistemuar dosjet personale për të gjithë të punësuarit në përputhje me udhëzimet administrative.
- Janë përditësuar të dhënat në sistemin elektronik të menaxhimit të personelit.

2. Procedurat e rekrutimit dhe avancimeve

- Janë shpallur gjithsej shtatë (7) konkurse publike për vende të lira pune.
- Janë përmbyllur me sukses gjashtë (6) procese rekrutimi, ndërsa një(1) janë në fazën e intervistimit.
- Janë realizuar dhjetë (10) procedura të Pensionimit, një(1) nga pensionimet i takon stafit tëmbështetës.
- Një(1) pozitë e liruar me vullnetin e lire te zyrtarit .
- Ne total janë njëqind e tetdhjetë e shtatë (187) zyrtarë të Punësuar në Administratë.

3. Zhvillimi profesional i stafit

- Janë evidentuar nevojat për trajnim dhe janë dërguar 24 punonjës në trajnime të organizuara nga MAP/DAP, OSH-të apo ofrues tjerë të licencuar.
- Është hartuar plani vjetor për trajnime (i miratuar në shkurt 2025).

4. Zbatimi i legjislacionit për marrëdhënie pune

- Është zbatuar me përpikëri Ligji për Zyrtarët Publik dhe rregulloret përkatëse për sistemimin dhe vlerësimin e performancës.
- Është hartuar rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe sistematizimin e Vëndeve të Punës në Administratën Komunale

- Janë shqyrtuar kërkesa të ndryshme si (transferime, pushime pa pagesë, ndërprerje të marrëdhënies pune, etj.).

5. Disiplina dhe etika në punë

- Nuk ka pas asnjë rast për shqiptim të masës dicitlinore ndaj zyrtarëve komunal.

6. Raportim dhe bashkëpunim ndërinstitutional

- Janë përgatitur dhe dërguar në afat të gjitha raportet periodike për MAP, DAP dhe auditorin e brendshëm/lokal.
- Është mbajtur komunikim dhe koordinim me zyrat e tjera brenda komunës për çështje të përbashkëta të personelit.

7. Udhëheqësit e Sektoreve

Në Administratë si stafë menaxhues (Udhëheqës) në institucionet e Komunës së Istogut janë 14 prej tyre 8 meshkuj dhe 6 femra.

Në DKA si stafë menaxhues (Udhëheqës) në institucionet e Komunës së Istogut janë 19 prej tyre 10 meshkuj dhe 9 femra.

Në DKSH si stafë menaxhues (Udhëheqës) në institucionet e Komunës së Istogut janë 5 prej tyre 3 meshkuj dhe 2 femra.

Në Drejtorinë për Kultur, Rini dhe Sport nuk ka asnjë Udhëheqës.

Numri i Pozitave Udhëheqëse në Komunitete nga gjinia mashkullore është 1, ndërsa nga gjinia femërore nuk ka.

Në Komunën e Istogut gjatë vitit 2025 kemi gjithësej 18 poste politike.

III. SFIDAT E HASURA

- Mungesa e një sistemi të automatizuar për menaxhimin e të dhënave të personelit, që e zgjat procesin e përpunimit të të dhënave.
- Kapacitetet e kufizuara në staf, sidomos gjatë muajve të pushimeve dhe kur ka rritje të kërkesave për dokumente.

IV. REKOMANDIME

- Të sigurohet një platformë elektronike funksionale për HR, e ndërlidhur me sistemet qendrore të MAP/DAP.
- Të rritet buxheti për zhvillimin e kapaciteteve të stafit dhe të përfshihet si zë i veçantë në buxhetin komunal.
- Të rishikohet struktura e njësisë për të mundësuar angazhimin e një numri të mjaftueshëm të zyrtarëve në kohë me fluks të lartë.

V. PLANIFIKIMI PËR VITIN 2026

- Riorganizimi i skedave të reja për vitin 2026.

- Planifikimi i trajnimeve të brendshme në bashkëpunim me zyrën për trajnime.
- Përgatitja e draft-strategjisë për zhvillimin e burimeve njerëzore në institucion.

DREJTORIA PËR ADMINISTRATË KOMUNALE
RAPORTI I PUNËS PËR PËRIUDHËN JANAR-DHJETOR 2025

Drejtorja për Administratë Komunale është drejtorja më e madhe, në kuadër të organeve komunale të administratës, dhe me qëllim të realizimit sa më me sukses të përgjegjësive, në fillim është hartuar plani i punës në të cilin janë paraqitur synimet që do të përmbushën në këtë periudhë.

Administrata komunale është një segment i rëndësishëm i komunës, ku qytetarët në realizimin e të drejtave dhe obligimeve të tyre kanë kontakte të drejtpërdrejta me pushtetin komunal. Gjatë kësaj periudhe kemi bërë përpjekje që administrata të jetë sa më funksionale dhe në pajtim me standardet bashkëkohore, përkatësisht që qytetarët si në aspektin kohor gjithashtu edhe në aspektin cilësor t'i realizojnë të drejtat e tyre nga përgjegjësitë dhe kompetencat e komunës. Në këtë drejtim veprimtaria kryesisht ka qenë e orientuar në realizimin e synimeve programore, respektimin dhe zbatimin e ligjit, si dhe akteve tjera të përgjithshme juridike si parakushte këto për krijimin e një administrate funksionale dhe efikase, në interes të përmbushjes së kërkesave të përgjithshme dhe individuale të qytetarëve pa dallim përkatësie nacionale, fetare, gjinore dhe racore. Orientimet e tilla sipas planit strategjik të punës dukshëm kanë ndikuar në ngritjen e shkallës së përgjegjësisë në punë, disiplinës në punë, avancimit të metodës së punës dhe efikasitetit në punë. Në kontekst të kryerjes së shërbimeve deri tani nuk kemi pasur asnjë vërejtje nga qytetarët tanë, që do të thotë se sipas vlerësimit të përgjithshëm administrata i përmbushë obligimet e saja në mënyrë korrekte dhe cilësore.

Në kuadër të kësaj drejtorie për këtë periudhë raportuese janë realizuar dhe janë në fazën e realizimit dhe në fazën e inicimit projektet si në vijim:

1. “Blerja e materialit higjeniko-sanitar”, vlera 25,000.00 euro (kontratë kornizë);
2. “Mirëmbajtja e e-kioskave”, vlera 18,000.00 euro (këtë periudhë janë paguar 2,800.00 euro);
3. “Infrastruktura për “smart city””, (kontratë tri vjeçare, këtë vit përmbillet) vlera për këtë vit 42,000.00 euro;
4. “Mirëmbajtja e automjeteve zyrtare”, (kontratë kornizë tri vjeçare), vlera afër 39,000.00 euro
6. Komuna në bashkëpunim me ASHI (Agresionin e Shoqërisë së Informacionit) ka plasuar përmes Platformës E-Kosova cila është vendosë edhe në ueb faqen e komunës se Istogut; kk.rks-gov.net/Istog ku qytetari mund te aplikoj dhe t'i tërheq dokumentet gjendjes civile online e qe janë të vlefshme për te gjitha shërbimet brenda Kosovës.

7. Po ashtu përmes Platformës E-Kosova Komuna në bashkëpunim me ASHI ka bere te mundur aplikimin qe qytetari te beje pagesën e faturës për takse komunale për regjistrim te automjeteve.
8. Komuna në bashkëpunim me MAPL është duke bere rifreskimin dhe azhurnimin e Intranetit komunal ku pala përmes Intranetit ne 3 faza mund te aplikoj për Leje Ndërtimore.

Duke pasur parasysh synimet e përcaktuara në fillim të këtij viti, mund të përfundojmë se ato deri tani janë realizuar me dinamikën e përcaktuar dhe në pajtim me planin për këtë periudhë.

Drejtoria për Administratë Komunale është e ndarë në:

1. Sektori i gjendjes civile me zyrat e vendit;
2. Sektori për administratë;
3. Qendra për shërbim të qytetarëve;
4. Arkivi komunal;
5. Zyra e prokurimit publik dhe
6. Sektori për të drejtat e njeriut dhe komunitete.

ii. Sektori i Gjendjes Civile

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2025

Sektori i Gjendjes Civile

Me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më efikase dhe profesionale për qytetarët, Sektori i Gjendjes Civile është i organizuar përmes zyrave të gjendjes civile në bashkësitë lokale.

Shërbimet ofrohen nga:

|| Zyra e Gjendjes Civile në Istog e cila përveç qytetit të Istogut përfshin edhe zyrat në Rakosh dhe Vrellë;

|| Zyra e Gjendjes Civile në Gjurakoc, e cila mbulon edhe shërbimet për fshatin Dobrushë dhe

|| Zyra e Gjendjes Civile në Banjë.

Qytetarët në këto zyra realizojnë të drejtat e tyre në rregullimin e dokumenteve personale të gjendjes civile.

Për të lehtësuar qasjen në shërbime, janë funksionalizuar edhe e-Kioskat, të cilat ofrojnë shërbime 24 orë në

ditë. Kjo mundësi është veçanërisht e dobishme për qytetarët e punësuar, të cilët mund t'i kryejnë shërbimet

edhe gjatë fundjavave dhe ditëve të festave. E-Kioskat janë të vendosura në Istog, Gjurakoc, Vrellë, Banjë dhe

Rakosh.

Shërbimi i Gjendjes Civile si pjesë e Drejtorisë për Administratë ushtron një sërë shërbimesh të ndryshme, përfshirë:

|| Regjistrimin e lindjeve brenda dhe jashtë vendit në librat amë të të lindurve;

|| Kurorëzimin dhe regjistrimin e martesave në librin amë të martesave, brenda dhe jashtë vendit;

|| Regjistrimin e vdekjeve brenda dhe jashtë vendit;

|| Lëshimin e certifikatave të ndryshme të gjendjes civile, si: certifikata e lindjes, ekstrakti nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile, certifikata e shtetësisë, e martesës, e vdekjes, e vendbanimit, e gjendjes martesore dhe e bashkësisë familjare

|| Regjistrimin e adresave të vendbanimit;

|| Pranimin e kërkesave me dokumentacion përcjellës për fitimin e shtetësisë së Republikës së Kosovës dhe përcjelljen e tyre në Departamentin për Shtetësi në Prishtinë dhe

|| Pranimin dhe trajtimin e kërkesave të tjera në kuadër të kompetencave të shërbimit të gjendjes civile.

Ky organizim dhe këto shërbime kanë për qëllim rritjen e efikasitetit, transparencës dhe cilësisë së shërbimeve për qytetarët.

Kërkesat e shqyrtuara gjatë vitit 2025

Gjatë vitit 2025, përveç lëshimit të 40,974 të dokumenteve të gjendjes civile janë pranuar dhe trajtuar gjithsej 455 kërkesa, nga të cilat 227 kërkesa të ndryshme administrative dhe 228 kërkesa për fitimin, humbjen dhe rifitimin e shtetësisë së Republikës së Kosovës. Struktura e kërkesave është si në vijim:

1. Kërkesa për Regjistrimin e mëvonshëm të vdekjes (96 kërkesa dhe 96 aktvendime)

2. Kërkesa për lëshimin e kopjes së vërtetuar të kartonit apo pasaportës së ish RFJ-së (31 kërkesa);

3. Kërkesa për ndërrimin e emrit personal (emrit dhe mbiemrit) - 48 kërkesa dhe 48 aktvendime;
4. Kërkesa për plotësimin dhe korrigjimin në dokumentet e arkivuara (4 kërkesa dhe 4 aktvendime)
5. Kërkesa zyrtare për korrigjimin e akteve të martesës (2 kërkesa dhe 2 aktvendime)
6. Kërkesë për dërgimin e dokumentacionit shtesë për shtetësi (1 kërkesë);
7. Kërkesë për përmirësimin e emrit të nënës në certifikatën e saj të vdekjes (1 kërkesë);
8. Kërkesë për lëshimin e aktit të vdekjes për raste të veçanta (3 kërkesa dhe 3 aktvdekje);
9. Kërkesë për regjistrimin në Kosovë të martesës së lidhur jashtë Kosovës (1 kërkesë dhe 1 aktvendim);
10. Kërkesa zyrtare për anulimin e aktit të martesës (1 kërkesë dhe 1 aktvendim);
11. Kërkesa zyrtare për korrigjimin e aktit të lindjes (2 kërkesa dhe 2 aktvendime);
12. Kërkesa zyrtare për korrigjimin e akteve të veçanta të lindjes (2 kërkesa dhe 2 aktvendime);
13. Kërkesa për regjistrimin e mëvonshëm të lindjeve (3 kërkesa dhe 3 aktvendime);
14. Kërkesa për korrigjimin e datës së lindjes (3 kërkesa dhe 3 aktvendime);
15. Kërkesa për regjistrimin e mëvonshëm të vdekjeve pa lindje (10 kërkesa dhe 10 aktvendime);
16. Kërkesë për anulimin e regjistrimit të dyfishtë të lindjes (1 kërkesë dhe 1 aktvendim);
17. Kërkesë zyrtare për korrigjimin e gjinisë (1 kërkesë dhe 1 aktvendim);
18. Kërkesa për njohjen e vendimit nga shteti i huaj për ndërrimin e emrit personal (3 kërkesa dhe 3 aktvendime)
19. Kërkesë për regjistrimin e qytetarit si shtetas të Kosovës (1 kërkesë dhe 1 aktvendim);
20. Kërkesë për lëshimin e certifikatës së martesës (1 kërkesë);
21. Kërkesë zyrtare për zbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës (1 kërkesë);
22. Kërkesë për heqjen e njërit numër personal për shkak të ekzistimit të të dy numrave (1 kërkesë dhe 1 aktvendim);
23. Kërkesë zyrtare për anulimin e regjistrimit të veçantë të lindjes (1 kërkesë dhe 1 aktvendim);
24. Kërkesë për regjistrimin e vdekjes së rregullt (1 kërkesë dhe 1 aktvendim);
25. Ankesa kundër vendimeve të ZGJC-Istog (2 ankesa);
26. Kërkesa për ndërrimin e emrit personal për fëmijë (4 kërkesa dhe 4 aktvendime);
27. Kërkesë për regjistrimin e shtetësisë sipas nenit 32 (1 kërkesë dhe 1 përgjigje në kërkesë);
28. Kërkesa zyrtare për korrigjimin e aktit të vdekjes (1 kërkesë dhe 1 aktvendim);
29. Kërkesa për fitimin, humbjen dhe rifitimin e shtetësisë së Kosovës (228 kërkesa)

Raporti për Dokumentet e Gjendjes Civile të lëshuara nga Zyra e Gjendjes Civile për vitin 2025

Planifikimi dhe funksionimi i menaxhimit për vitin 2026

Planifikimi i punës dhe mënyra e funksionimit të menaxhimit për vitin 2026 bazohet në përcaktimin e objektivave konkrete dhe veprimeve të nevojshme për arritjen e tyre. Përveç obligimeve të rregullta dhe aktiviteteve të realizuara gjatë vitit 2025, të paraqitura në raportin vjetor, Sektori i Gjendjes Civile, në bashkëpunim të ngushtë dhe me përkrahjen e Drejtorisë për Administratë, planifikon ngritjen e mëtejme të cilësisë së shërbimeve për qytetarët.

Fokus i veçantë gjatë vitit 2026 do të jetë rritja e nivelit të digjitalizimit të shërbimeve të gjendjes civile dhe

zgjerimi i mundësive për vetëofrim të shërbimeve nga qytetarët. Në këtë drejtim, rëndësi e posaçme do t'i kushtohet mirëmbajtjes dhe funksionimit të rregullt të e-kiosqeve, me qëllim që qytetarët të kenë qasje në shërbimet e gjendjes civile edhe jashtë orarit zyrtar të punës, gjatë fundjavave dhe ditëve të festave.

Planifikimi përfshin gjithashtu organizimin e mirëfilltë të strukturës organizative dhe shpërndarjen e

burimeve njerëzore, në mënyrë që të sigurohet përmbushja efikase e objektivave vjetore.

Mirëmbajtja e regjistrave dhe akteve të gjendjes civile

Gjatë vitit 2026 planifikohet të realizohet lidhja e akteve të lindjeve, martesave dhe vdekjeve si dhe ndërrimi

i kopertinave të regjistrave fizikë që janë dëmtuar ndjeshëm si pasojë e përdorimit të vazhdueshëm ndër vite.

Aktet e gjendjes civile janë të klasifikuara si në vijim:

Aktet e lindjeve :

1. Aktet e Rregullta (lindjet brenda vendit) = 1 akt brenda 1 viti (e kaltër e mbyllur)

2. Aktet e Veçanta (lindjet jashtë vendit)= 1 akt brenda 1 viti (e kaltër e hapur)

Aktet e martesave:

1. Aktet e Rregullta (martesat brenda vendit) 1 akt brenda 1 viti (e kuqe e mbyllur)

2. Aktet e Veçanta (martesat jashtë vendit) =1 akt brenda 1 viti (e kuqe e hapur)

Aktet e vdekjeve:

1. Aktet e Rregullta (vdekjet brenda vendit) 1 akt brenda 1 viti (ngjyrë hiri e mbyllur)

2. Aktet e Veçanta (martesat jashtë vendit) =1 akt brenda 1 viti (ngjyrë hiri e hapur)

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se për secilën Zyrë të Gjendjes Civile nevojiten gjithsej 6 akte në vit, të

ndara sipas llojit të shërbimit, si në vijim: 1). Zyra e Gjendjes Civile në Istog: 6 akte; 2). Zyra e Gjendjes Civile

në Vrellë: 6 akte; 3). Zyra e Gjendjes Civile në Rakosh: 6 akte; 4). Zyra e Gjendjes Civile në Gjurakoc: 6 akte;

5). Zyra e Gjendjes Civile në Dobrushë: 6 akte dhe 6). Zyra e Gjendjes Civile në Banjë: 6 akte.

Paraqitja e punëve dhe aktiviteteve të planifikuara më lart nuk nënkupton se janë përfshirë të gjitha aktivitetet e mundshme për vitin 2026. Sipas nevojës dhe zhvillimeve gjatë vitit, mund të shtohen edhe aktivitetet e tjera

iii. Sektori për administratë

Në kuadër të këtij sektori janë: udhëheqësi i sektorit, shërbimi i teknologjisë së informimit (2 IT), autoparku (2 shërbyes), zyrtari për logjistikë (1 shërbyes), shërbimi i përkthimit (2 shërbyes) dhe shërbimi për mirëmbajtje dhe pastrim të objektit të komunës (5 stafi administrativo mbështetës).

Gjatë periudhës janar-dhjetor të këtij viti, stafi kryesisht janë marr me realizimin e punëve: mirëmbajtja e rrjetit të internetit dhe intranetit, instalimi i programeve softuerike në kompjuterët e stafit civil, mirëmbajtja dhe riparimet softuerike të kompjuterëve të tërë stafit civil dhe politik të administratës

komunale dhe punë të tjera të teknologjisë së informimit. Shërbimi i përkthyesve gjatë periudhës raportuese ka bërë përkthime të të gjitha shkresave, vendimeve, procesverbaleve, raporteve dhe dokumenteve të lëshuara nga zyra e kryetarit, drejtorit komunale, kuvendi, komitetet e tij dhe organet të tjera të themeluara nga kuvendi dhe Kryetari. Në këtë periudhë raportuese janë përkthyer më shumë se 584 shkresa dhe dokumente të cekura. Po ashtu shërbimi i përkthimeve ka bërë përkthimin simulant dhe përkthime të drejtpërdrejta gjatë të gjitha mbledhjeve të kuvendit të komunës, dhe takimeve të ndryshme të organizuara nga Kryetari dhe komisioneve dhe komiteteve të themeluara nga kuvendi dhe Kryetari. Nga stafi i autoparkut është bërë furnizimi i rregullt i të gjitha automjeteve zyrtare me karburante dhe evidenca e shpenzimeve të tyre sipas drejtorive komunale, është bërë mirëmbajtja e automjeteve, duke u kujdesur që të gjitha automjetet të jenë në gjendje funksionale. Nga zyra e logjistikës është bërë, sipas kërkesës së stafit, furnizimi me material të nevojshëm për zyre dhe furnizim me material higjieniko-sanitar. Nga shërbimi i mirëmbajtjes, është bërë mirëmbajtja e objektit të komunës në aspektin e pastërtisë të të gjitha zyrave, nyjave sanitare dhe korridoreve, mënjanimi i defekteve dhe riparimi i prishjeve të dyerve, dritareve mobileve dhe karrigeve të stafit si dhe mirëmbajtja e ngrohjes qendrore të objektit të komunës, duke përfshirë edhe furnizimin me lëndë djegëse.

Në kuadër të Drejtorisë, shqyrtohen kërkesa të ndryshme nga kadri mi fushëveprimit të drejtorisë, duke përfshirë kërkesa për vijimin e stazhit të praktikës, si nga ata/ato që kanë përfunduar studimet, në të gjitha fakultete, si në ato private dhe publike dhe studentët të cilët ende i vijnë studimet, po ashtu në të gjitha fakultetet, pa dallim, si ato private dhe publike. Gjatë kësaj periudhe raportuese janë lëshuar: 8 vendime dhe 13 vërtetime të ndryshme nga përgjegjësia e drejtorisë, dhe 44 kërkesa dhe shkresa të ndryshme të komunikimit të brendshëm dhe komunikimit jashtë komunës.

iv. Arkivi komunal

Institucioni	Departamenti	Numri i lëndëve të arkivuara	Numri i lëndëve të asgjësuara	Numri i dokumenteve
Komuna Istog	Drejtoria për Administratë dhe Personel	26	0	38
	Drejtoria për Administratë dhe Personel-joaktive	0	0	0
	Drejtoria për Arsimit	4	0	5
	Drejtoria për Arsimit	0	0	0

Kultur dhe Shkencë-joaktive			
Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	155	0	285
Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural-joaktive	0	0	0
Drejtoria për Buxhet dhe Financa	80	0	8
Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim	151	0	243
Drejtoria për Ekonomi, Financa dhe Buxhet-joaktive	0	0	0
Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë	2404	0	3767
Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport	0	0	0
Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis	28	0	57
Drejtoria për Punë të Inspeksionit	3	0	7
Drejtoria për Punë të Inspeksionit-joaktive	0	0	0
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	567	0	1184
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale-joaktive	0	0	0
Drejtoria për Shërbime Publike dhe Siguri	415	0	417
Drejtoria për Shërbime Publike dhe Siguri-joaktive	0	0	0
Drejtoria për	0	0	0

Urbanizëm, Gjeodezi, Pronë dhe Kadastër-joaktive			
Kryetari i Komunes	338	0	426
Kryetari Komunes-joaktive	0	0	0
Kuvendi Komunal	0	0	0
Kuvendi Komunal-joaktive	0	0	0
NUK EXISTON si DEPARTAMENT por ka Lende	0	0	0
	0	0	0
Zyra Lokale e Komuniteteve	0	0	0
Zyra Lokale e Komuniteteve-joaktive	0	0	0
Totali:	4171	0	6437

v. Qendra për shërbim të qytetarëve.

Përmes kësaj zyre qytetarët më lehtë mund t'i adresojnë kërkesa e tyre dhe të marrin përgjigje. Në këtë kuptim të gjitha kërkesat për të gjitha organet komunale kalojnë përmes këtij shërbimi. Gjithashtu nga kjo zyre udhëzohen të gjithë qytetarët për realizimin e të drejtave të tyre në pushtetin lokal dhe për procedurat e realizimit të këtyre të drejtave. Gjatë periudhës Janar-Qershor 2025, në këtë shërbim janë pranuar një numër i madh i kërkesave të cilat gjenden në tabelën e mëposhtme të drejtuar të gjitha drejtoritë, kryetarit dhe kuvendit.

Numri i kërkesave sipas Drejtorive, gjashtëmuor: 03.01-16.06-2025

Shkurte	Pershkrimi	Pranu	Ne	Mirat	Refuzu	Hedh	Pezullu	Cedu	Anulu	Perfund	Tota
---------	------------	-------	----	-------	--------	------	---------	------	-------	---------	------

sa		ar	Proces	ar	ar	ur Posht e	ar	ar	ar	uar	li
DAP	Drejtoria për Administratë dhe Personel	13	52	2,221	11	0	0	0	19	29,981	32,297
DBZHR	Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	0	0	42	32	0	0	0	4	0	78
DEZH	Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim	0	0	111	6	0	0	0	1	0	118
DKRS	Drejtoria për Arsim	4	14	3,390	270	0	4	0	96	0	3,778
DPI	Drejtoria për Punë të Inspeksionit	0	49	141	0	1	0	0	3	0	194
DSHMS	Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	5	199	1,286	139	0	110	0	11	0	1,750
DSHPS	Drejtoria për Shërbime Publike dhe Siguri	1	32	599	339	0	0	0	20	0	991
DGJKP	Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë	6	27	7,206	13	0	0	0	18	0	7,270
KK	Kryetari i Komunes	0	204	185	39	0	0	2	4	0	434
ZLK	Zyra Lokale e Komuniteteve	0	14	11	6	0	3	0	0	0	34
KK	Kuvendi Komunal	0	3	0	0	0	0	0	1	0	4
DPUM	Drejtoria për	0	179	554	63	0	135	0	13	0	944

	Planifikim Urban dhe Mjedis										
DKRS	Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport	0	0	60	15	0	0	0	9	0	84
DBF	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	0	22	291	0	0	0	0	12	0	325
		29	795	16,097	933	1	252	2	211	29,981	48,301

vi. Zyra e Prokurimit

*Ju njoftojmë për procedurat e zhvilluara të cilat janë të procesuara nga zyra e prokurimit: për të gjitha vlerat dhe llojet e procedurave për periudhën **01.01.2025** deri me **31.12.2025**. Në këtë raport përfshihen: Njoftimet për kontratë, Njoftimet për dhënie të kontratës, Njoftimet për nënshkrim të kontratës, Kërkesat për rishqyrtim në AK dhe Ankesat në OSHP.*

Zyra e Prokurimit në Komunën e Istogut ka vazhduar të operojë në përputhje me ligjet dhe rregulloret vendore për administratën publike.

Prokurimin e mallrave, shërbimeve dhe punëve sipas nevojave nga njësitë - drejtoritë e ndryshme të komunës bazuar në Planifikimin e prokurimit për vitin 2025.

Lloji i njoftimit të publikuar	Numri i publikimeve
Njoftim për kontratë	80
Njoftim për dhënie të kontratës	67
Njoftim për nënshkrim të kontratës	66
Kërkesa për rishqyrtim në AK	19
Ankesa në OSHP	7
Aktivitetet e publikuara në LOT-e	23

Nga 80 Njoftimet për kontratë të publikuara, 23 Njoftime për kontratë janë të publikuara me pjesë (lote), 80 Njoftimet për kontratë përmbajnë 146 aktivitete të prokurimit. Nga keto aktivitete të prokurimit të cilat janë furnizime, shërbime dhe punë të ndryshme si: vlerë e madhe, vlerë e mesme, vlerë e vogël dhe vlerë minimale në total numri i kontratave të nënshkruara për vitin buxhetor 2025 është 66.

Ky raport përfshinë një pasqyrë të qartë dhe të përgjegjshme të performancës së Zyrës së Prokurimit në Komunën e Istogut gjatë periudhës 01.01.2025 deri me 31.12.2025. Të gjitha proceset e prokurimit janë proceduar duke u bazuar në Ligjet dhe rregulloret vendore dhe qendrore të prokurimit publik, duke siguruar transparencë dhe drejtësi në zgjedhjen operatorëve të kontraktuar.

Zyra e Prokurimit angazhohet për vazhdimin e përmirësimit të proceseve dhe për të përmbushur nevojat e përdoruesve të tij brenda standardeve të larta të qeverisjes dhe përgjegjshmërisë administrative.

vii. Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete

Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete është mekanizëm monitorues për respektimin e të drejtave të njeriut në relacionin komunë-qytetarë, funksion si sektor/njësi e veçantë në kuadër të Drejtorisë për Administratë Komunale.

Misioni i Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete është vëzhgimi i respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe reagimi për vënien e tyre në vend, sensibilizimi i qytetarëve për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tyre, përmirësimi i akteve nënligjore komunale, praktikës për zbatimin e këtyre akteve, barazia gjinore, të drejtat e fëmijëve, mundësi të barabarta dhe mos diskriminim, të drejtat e komuniteteve, përdorimi i gjuhëve, kundër trafikimit me qenie njerëzore, personat me aftësi të kufizuar.

Struktura e Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete :

1. Udhëheqësja e Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete;
2. Zyrtarja për Barazi Gjinore e caktuar edhe në detyrat: Zyrtare për Mbrojtje nga Diskriminimit dhe
3. Zyrtarja për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Rintegrim.

Buxheti i Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete për vitin 2025 ka qenë i planifikuar gjithsej 6000 euro në kategorinë subvencione dhe transfere për realizim të aktiviteteve.

Në pajtim me procedurat e përcaktuara në Rregulloren e Ministrisë së Financave, Nr.04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik, janë përkrahur disa OJQ, lidhur me tryeza/aktivitete për të drejtat e njeriut.

Pasi një nder përgjegjës të këtij sektori është edhe vetëdijesimi dhe sensibilizimi i qytetarëve lidhur me të drejtat e tyre, kemi organizuar tryeza/aktivitete dhe shënuar data, të cilat kanë të bëjnë me avokimin dhe

sensibilizimin e qytetarëve për të drejtat në përgjithësi e në veçanti për të drejtat e grave, fëmijëve, personave më aftësi të kufizuar, të komuniteteve dhe mos diskriminim.

Në periudhën Janar-Dhjetor 2025 janë mbajtur këto tryeza/aktivitete të parapara me planin e punës së SDNJK:

Shënimi i 8 Marsit “Dita Ndërkombëtare e Gruas”

Tryezë diskutimit në bashkëpunim me OJQ “Qendrën për Mirëqenien e Gruas”, më rastin e shënimit të 8 Marsit “Dita Ndërkombëtare e Gruas”. Tema kryesore e kësaj tryeze ishte “Sfidat, vështirësitë dhe të arriturat e grave”. Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi lidhur më sfidat që kanë gratë, diskriminimi gjinor, mungesa e përfaqësimit si dhe fuqizimi i rolit të gruas në të ardhmen.

Pjesë e kësaj tryeze ishin: asamblistët e kuvendit të komunës, drejtoreshat e drejtorive përkatëse, udhëheqëset e sektorëve, përfaqësues të OJQ-ve dhe zyrtare komunale. Në fund të takimit u dhuruan lule për nderë të festës së 8 Marsit.

Në tryezën e diskutimit ishin prezentë 16 pjesëmarrës/pjesëmarrëse prej tyre 15 F dhe 1 M.

21 Marsi “Dita Ndërkombëtare e Sindromës Down”

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Sindromës Down, Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete – Drejtoria për Administratë Komunale, në bashkëpunim me OJQ “Handikos” në Istog dhe iniciuesin e këtij aktiviteti, Fatbardha Hakaj Demaj, kryetare e Këshillit të Prindërve të Kopshtit “Gëzimi Ynë”, ka organizuar një aktivitet të veçantë në “Parkun e Qytetit” në Istog.

Ky aktivitet mbledhi së bashku prindër dhe fëmijë/persona me Sindromën Down, me qëllim gjithëpërfshirës dhe mbështetjes për këtë komunitet. Gjatë aktivitetit u diskutua mbi sfidat dhe arritjet e personave me Sindromën Down, si dhe u promovua mesazhi për një shoqëri më të barabartë dhe më të ndjeshme ndaj diversitetit.

Organizatorët theksuan se përmes përkushtimit dhe bashkëpunimit mund të krijohen mundësi më të mira për përfshirjen e plotë të personave me Sindromën Down në jetën sociale dhe edukative. Kjo ngjarje është pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të ndërtuar një shoqëri që i pranon dhe i mbështet të gjithë pa dallim.

8 Prilli “Dita Ndërkombëtare e Romëve”

Në bashkëpunim me OSBE organizoj tryezë për manifestimin dhe shënimin e 8 Prillit “Dita Ndërkombëtare e Romëve”.

U diskutua për çështjet dhe problemet me të cilat ballafaqohet komuniteti rom, prezantim lidhur me historikun, traditat dhe kulturën romë si dhe gjendjen aktuale të tyre në shoqëri. U kërkua angazhim ma i madh i të gjithë akterve dhe vëmendje shtesë ndaj këtij komuniteti me qëllim të përmirësimit të pozitës së tyre në shoqëri, integritimit në rrjedha sociale dhe rritjen e tolerancës ndaj tyre, krijimin e kushteve që të ju lehtësohen problemet me të cilat ballafaqohen.

Në tryezën e diskutimit ishin prezentë 32 pjesëmarrës/pjesëmarrëse prej tyre, 21 F dhe 11 M.

12 Prill “Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve në Situatë Rruge”

Me rastin e shënimit të 12 – Prillit, “Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve në Situata Rruge” nga zyrtarja për Mbrojtje të Fëmijëve dhe Riintegrim, Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete në kuadër të Drejtorisë për Administratë Komunale në SHFMU “Martin Camaj” në Gurakoc, është mbajtur një ligjëratë informuese më nxënës të klasave VI dhe Qëllimi i ligjëratës ishte informimi i nxënësve për parandalimin e dukurisë negative të kërkim-lëmshës nga fëmijët si dhe shkaqet dhe pasojat që krijojnë dhënia e lëmshës, me theks të veçantë tek fëmijët në situata rruge.

Në ligjëratë informuese ishin prezentë **28** nxënës/e prej tyre **16 M** dhe **12 F**.

Fushatë vetëdijesuese lidhur me temën ” E drejta në pronë dhe trashëgimi” dhe “legalizimi i pronës”.

Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete bazuar në Planin Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore 2025-2027, në bashkëpunim me OSBE organizoi dhe mbajti dy takime më qëllim të diskutimit, informimit dhe vetëdijesimit të qytetarëve veçantë grave për të drejtën në trashëgimi dhe pronë, regjistrimin dhe legalizimin e pronës.

Këto takime u mbajtën në SH.F.M.U “Ismajl Qemajli” në Staradran, me datë 15.04.2025 (e Martë) dhe në SH.F.M.U “Ndre Mjeda” në Rakosh, me datë 16.04.2025 (e Mërkurë) .

Qëllimi i takimeve ishte informimi, vetëdijesimi i grave për të drejtën në trashëgimi dhe pronë si dhe legalizimi i pronës.

z.Ylber Veseli- Përfaqësues nga OSBE - Qasja në pronësi dhe trashëgimia, prezantoi materialin e përgatitur lidhur me temën “E drejta në trashëgimi dhe pronë”.

Si ekspert i kësaj fushe ju përgjigj pjesëmarrësve lidhur me pyetjet që kishin të bëjnë më të drejtën në trashëgimi dhe pronë. Gjithashtu i njoftoj edhe për çështjen dhe rëndësinë e legalizimit të pronës. U shpërndanë fletushka me të dhëna për të drejtën në trashëgimi dhe pronë po ashtu edhe për legalizimin e pronës.

Diskutime dhe pyetje lidhur më temën pati nga shumica e grave që ishin prezente.

Në këto dy takime ishin gjithsej 46 pjesëmarrës/pjesëmarrëse, prej tyre **28 F** dhe **18 M**.

Sesion informues për mbrojtjen nga Diskriminimi

Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete në bashkëpunim me **Organizatën Joqeveritare “Advancing Together”** dhe në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë-Zyra e Kryeministrit, organizuan sesion informues për mbrojtjen nga diskriminimi me pjesëmarrjen e zyrtareve nga komuna e Istogut. Ky aktivitet u mbështetet në kuadër të projektit të UNMIK-ut “**Bëhu Partner për Mirëqenien dhe Adresimin e Diskriminimit**”.

Qëllimi i këtyre takimeve ishte ngritja e vetëdijes lidhur me çështjen e diskriminimit dhe formave të diskriminimit, mekanizmat për mbrojtje nga diskriminimit dhe praktikrat e Gjykatës Evropiane dhe Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës lidhur me lëndët që kanë pas objekt shqyrtimi diskriminimin.

Në këto takime ishin gjithsej 20 pjesëmarrës/pjesëmarrëse, prej tyre 12 Mj dhe 8 F: drejtorë të drejtorive përkatëse dhe zyrtarë nga fusha të ndryshme sektoriale të komunës sonë.

15 Maji “Dita Ndërkombëtare e Familjes”

Me rastin e shënimit të 15 Majit “Dita Ndërkombëtare e Familjes” Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete në kuadër të Drejtorisë për Administratë Komunale ka organizuar një tryezë me familjet strehuese në Istog, me qëllim të diskutimit për përvojat e tyre, nevojat dhe sfidat që i hasin si familje strehuese gjatë strehimit të fëmijëve pa përkujdesje prindërore, të braktisur nga lindja, keqtrajtuar e të neglizhuar nga familja e tyre biologjike.

Tryeza e mbajtur ishte një mundësi që familjet strehuese të diskutojnë hapur mbi vështirësitë që hasin gjatë strehimit të fëmijëve dhe një mundësi për të dëgjuar njëri - tjetrin, për të mësuar për përvojat e ndryshme dhe për të gjetur zgjidhje të përbashkëta që e lehtësojnë këtë rrugëtim.

Shënimi i 1 Qershorit “Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve”

Takimi i dytë i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës është mbajtur me datë 02.06.2025, i cili ishte takimi i përbashkët ndërmjet përfaqësuesve të Asamblesë Komunale të Fëmijëve në Istog dhe anëtarëve të Ekipit për të Drejtat e Fëmijës, me rastin e shënimit të 1 Qershorit - Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve.

Qëllimi i këtij takimi të përbashkët ishte krijimi i mundësisë së tyre që si përfaqësues të Asamblesë Komunale të Fëmijëve të ngritin çështje të rëndësishme që prekin të drejtat dhe mirëqenien e të gjithë fëmijëve, duke përfaqësuar në këtë mënyrë me dinjitet shkollat komunitetin që përfaqësojnë.

Në takim ishin gjithsej 19 përfaqësues/e nga Asambleja prej tyre 6 M dhe 13 F.

12 Qershori “Dita Ndërkombëtare kundër Punës së Rëndë të Fëmijëve”

Në kuadër të Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete - Drejtoria për Administratë Komunale me rastin e shënimit të 12 Qershorit “Dita Ndërkombëtare kundër Punës së Rëndë të Fëmijëve” në FSHMU “Trepça” në Banjë, nga zyrtarja për Mbrojtje të Fëmijëve dhe Riintegrim janë mbajtur dy takime me nxënës dhe prindër më temën “Ndërgjegjësimi i prindërve dhe nxënësve për mbrojtjen e fëmijëve nga punët e rënda dhe shfrytëzimi”.

Takimet kishin si qëllim ndërgjegjësimin e prindërve, fëmijëve, institucioneve dhe qytetarëve në përgjithësi për mbrojtjen e fëmijëve nga punët e rënda, kuptimin e punës se lejuar dhe jo të lejuar të punës së fëmijëve, format më të rënda të punës së fëmijëve, shkaqet dhe pasojat e punës së fëmijëve, korniza ligjore dhe institucionale në Kosovë, të autorizuar për të vepruar dhe bashkëpunuar në identifikimin, tërheqjen, rehabilitimin dhe ri integrimin e fëmijëve të angazhuar, procesi i menaxhimit të rasteve dhe raportimi i rasteve të fëmijëve të cilët janë të përfshirë në punë të rënda.

Në këto takime ishin prezentë 38 nxënës/e prej tyre 9 M dhe 29 F, ndërsa prindër ishin prezentë 18 prej tyre 4 M dhe 14 F.

24 Qershori “Dita Ndërkombëtare e Komunitetit Egjiptian”

Në bashkëpunim me OJQ “Vision 02” me qëllim të shënimit të 24 Qershorit “Dita Ndërkombëtare e Komunitetit Egjiptian” u mbajtën aktivitetesh kulturore, edukative dhe argëtuese në Bjeshkët e Rugovës. Kjo ditë shërben si thirrje ndaj institucioneve dhe gjithë shoqërisë që të punojnë vazhdimisht për integrimin e plotë.

Në këto aktivitete gjithsej morën pjesë 20 pjesëmarrës/pjesëmarrëse.

Fushata kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore – 2025

Në kuadër të Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete-Drejtoria për Administratë Komunale, nga Zyrtarja për Mbrojtje të Fëmijëve dhe Riintegrim në bashkëpunim me përfaqësues nga Policia në Istog, ka mbajtur “Fushatën Vetëdijesuese kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore 2025” me nxënësit e klasave të VI, VII, VIII, IX.

Qëllimi i kësaj fushate ishte parandalimi i trafikimit me qenie njerëzore, si një nga format më të rënda të shkeljes së të drejtave të njeriut, si dhe rritja e vetëdijes së qytetarëve për:

- Rëndësinë e identifikimit të hershëm të viktimave potenciale të trafikimit,
- Njohjen e faktorëve dhe pasojave që çojnë në trafikim dhe,
- Inkurajimin për raportimin e rasteve pranë institucioneve përgjegjëse,

“Fushata Vetëdijesuese kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore - 2025” është mbajtur me nxënës/e të klasave VI - IX, në shkollat: FSHMU “Trepça” Banjë, FSHMU “Bajram Curri” Istog, FSHMU “Ndre Mjeda” Rakosh, FSHMU “Hysni Zajmi” Vrellë, FSHMU “Ismail Qemali” Saradran, FSHMU “Tre Dëshmorët e Shkollës Shqipe” Uçë, FSHMU “Zymer Zeka” Kaliqan, , FSHMU “Martin Camaj” Gurrakoc, SHFMU “Avni Rustemi” Zallq, dhe SHFMU “Mehmet Akif” Shushicë.

Numri i nxënësve pjesëmarrës/e gjithësej ishte **338** prej tyre **149 M** dhe **189 F**.

🔊 Mesazhi i fushatës: **“Trafikimi prek të gjithë! Ta mbrojmë veten dhe fëmijët tanë.”**

🗣️ Slogani: **“Mos hesht!”**

Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete në bashkëpunim me **Drejtorinë për Shëndetësi, OJQ “Vizion 02”** dhe **OSBE** gjatë muajt **Tetor** ”**Muaj Rozë**”, bazuar edhe në Planin e Punës së Sektorit dhe Planin e Veprimit Lokal për Barazi Gjinore 2024-2026 organizuam fushatën e ndërgjegjësimit kundër kancerit të gjirit dhe kancerit të qafës mitrës.

Takime informuese u mbajtën me gratë në Zallq dhe Istog. Për këtë temë me takime ligjëroi Dr.Egzona Hajrizaj Hoxhaj.

Në këto takime morën pjesë 102 pjesëmarrës/e, 95 F dhe 7 M që përfituan njohuri për zbulimin e hershem të kancerit të gjirit dhe kancerit të qafës mitrës.

15-Tetorit “Dita Ndërkombëtare e Shkopit të Bardhë”

Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete në bashkëpunim me **OJQ “Shoqata e të Verbërve”** me seli në Istog, organizoi një shëtitje një ditore dhe tryezë diskutimi në rastin e shënimit të **15-Tetorit “Dita Ndërkombëtare e Shkopit të Bardhë”**, me qëllim të mbështetjes për një zhvillim të një shoqërie

sa më të shëndetshme, në veçanti të personave të verbër. Tema kryesore e kësaj tryeze ishte: ‘‘Sfidat dhe të arriturat e personave të verbër si dhe realizimi i të drejtave të tyre’’.

Pjesëmarrës ishin gjithsej 21 persona, prej tyre 10 F dhe 11 M.

3 -Dhjetori ‘‘Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara’’

Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete në bashkëpunim me **OJQ’’HANDIKOS’’** me seli në Istog, organizoi një tryezë të rrumbullakët më rastin e shënimit të **3 - Dhjetorit ‘‘Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara’’**. Në këtë tryeze u diskutua për sfidat që kanë personat me aftësi të kufizuar, përgjegjësitë institucionale për krijimin e kushteve të barabarta, eliminimin e barrierave, fizike, sociale dhe institucionale si dhe përfshirjen e plotë të personave më aftësi të kufizuar në të gjitha sferat e jetës shoqërore.

Pjesëmarrës/pjesëmarrëse në këtë takim ishin gjithsej 45 persona, 26 F dhe 19 M.

Nga këto projekte i realizuar është vetëm “Renovimi i nyjeve sanitare në shf “Hysni Zajmi Vrellë dhe Trepça”-Banjë

Projekte tjera të realizuara :

- 26 kontrata për transport të nxënësve nga fshatrat në shkollë-linja të ndryshme.
- Të gjitha institucionet shkollore janë renovuar dhe të mirëmbajtura.
- Poashtu të gjitha institucionet arsimore janë furnizuar me lëndë djegëse-Dru
- Sherbime të internetit në çdo institucion shkollor nga KREN-Kosova-domen qeveritar dhe Elektra-me kontratë.
- Sigurimi aksidental për Praktikën profesionale të nxënësve IAAP”Mithat Frasheri”-Gurakoc Të gjitha institucionet shkollore janë renovuar dhe të mirëmbajtura.
- Kontratë për dizajnim,printim ,mirënjohje dhe pano.

Projektet e reja kapitale të cilat janë financuara nga MASHTI-i dhe BE-ja janë:

- -Përfundimi Palestrës sportive në shfmu Martin Camaj-Gurakoc
- Përfundimi i punimeve ne Palestren e shfmu”Hysni Zajmi”-Vrellë
- Rregullimi i infrastruktures se jashtme në shfmu”Fan Noli”-Ilukavc i Begut.
- Vazhdimi i punimeve në palestrën Sportive në Gjinnazin “Haxhi Zeka”-Istog,
- Fasadimi dhe infrastruktura e shkolles IAAP “Mithat Frashëri”
- Është duke vazhduar tenderi i renovimit të objektit me efijencë elektrike-IEA “Gëzimi Ynë “-Istog

Ndërsa nga Donacionet:

- Nga Holderlin-Gymnasion-Gjermani –laptop-4 copë-shfmu “Bajram Curri”-Istog
- Nga Landesklinikum HORN –Austri-dhuron shtepiza kompjuteri,monitor në sasi 120 copë-shkollat

- Nga Dogana e Kosovës-20 kompjuter “Hysni Zajmi” dhe “Martin Camaj”-Gurakoc
- Klubi i Debatit dhuron Gjimnazit Paisje per kabinetin e muzikes dhe Edukates fizike,
- Shoqata Bereqeti-dhuron paisje kuzhine për staf-“Zymer Zeka”-Kaliqan
- -12 Laptop për shfmu “Mehmet Akif”-Shushicë(KFOR-i Italian).
- Paisje :banka,tavolina,karrika dhe tabela –Kfori italian-shfmu”Ismail Qemali”
- Lions Club Peja @ Kfori Italian paisje sportive për shfmu”IsmailQemali”-Saradran
- Lions Club Abetone nga Italia dhe Lions Club Pejë dhuruan veshëmbathje dhe paisje tjera në shfmu”Zymer Zeka”-Kaliqan
- Shtypëshkronja Smart Point dhuron qanta shkollore së bashku me paisje për nxënësit me gjendje jo të mirë ekonomike në 3 shkolla “Ndre Mjeda”-Rakosh,”Tre Dëshmorët”-Uçë dhe “Mehmet Akif”-Shushicë.
- Donacion nga shtëpia botuese Dukagjini-220 libra per nxenes parashkollor ,nivelit fillor si dhe Librat e pushimeve për nxpnësit nga parafillora deri tek klasa e IV-të,si dhe një tabelë të mençur-SMART-“Bajram Curri”-Istog
- Donacion nga shtëpitë botuese Dukagjini dhe Albas me libra,”Bajram Curri”-Istog
- Organizata Nderkombetare për Migracion(IOM) –dhuron Paisje kabineti”Avni Rrustemi”-Zallq
- Humanity First Kosova-Dega në Gjermani dhuron 2 SMART TV,Vizioni dhe Misioni LED,tabela për ekspozita ,”Trepça”-Banjë
-

AKTIVITETET ME NXENËS-JASHTË KURIKULARE

- Aktivitet për 21 Mars Dita Ndërkombëtare e Sindromës Down,
- 2 Prill-Dita Botërore e Autizmit(ligjërata vetëdijesuese nga psikologjia e shkollës)
- Nga Kfori Italian janë mbajtur këto kurse për nxënësit e shkollave të mesme dhe disa fillore
- Vetëmbrojtja në raste të ndryshem,Siguria në përgjithësi dhe kursi i gjuhës italiane
- Vizitë me nxënësit e klasës së IX-të tek IAAP “Mithat Frashëri”-Gurakoc në aktivitetin “Ditët e Dyerve të hapura”
- Vizitë me nxënësit e klasës së IX-të tek IAAP “Mithat Frashëri”-Gurakoc në aktivitetin “Ditët e Dyerve të hapura”
- Sherbimi Policor i Kosovës -dega në Istog ka mbajtur takime me nxënës me temat luftimi i :
-Bullizmit në shkolla,
-Dukuritë negative (droga,alkoolietj),shkaqet dhe pasojat e përdorimit të tyre.
-Si dhe takime informuese :
 - Vetëdijësimi i nxënësve se si të sillen në komunikacion(është organizuar në të gjitha shkollat gjatë gjysmëvjetorit të dytë),si dhe Tema Ruajtja e trashëgimisë kulturore.

- Organizime për -Dita e Tokës, festa e 7 dhe 8 Marsit, 1 Qershori-dita e fëmijëve, Pavarësia e Kosovës, aktivitete për 28 Nëntori, dita e gjyshërve (2 tetori),
- Vizitë e fëmijëve të kopshteve në fabriken Mokna, Vita, Agro-Produkt, festa e Ditës së Mollës etj etj
-

Përmbledhje :

Drejtorja e Arsimit, në kuadër të kompetencave ,autorizimeve dhe përgjegjësive ligjore, udhëzimeve administrative të MASHT-it Statutit të Komunës ,dhe të politikave strategjike të Kryetarit të Komunës në fushën e veprimtarisë së saj, është kompetent dhe ka përgjegjësinë për menaxhimin dhe koordinimin e strukturës së arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm (0,1,2,3) në Komunën e Istogut.

Udhëheq, menaxhon dhe koordinon procesin e licencimit të çdo institucioni edukativo-arsimor publik para-universitar, në përputhje me ligjet në fuqi dhe strategjinë e MASHT-it dhe të Komunës;

Bashkëpunon me Sektorin e Burimeve Njerëzore në procesin e punësimit të mësimdhënësve dhe personelit tjetër (ndihmës dhe mbështetës), në pajtim me dispozitat e ligjeve në fuqi dhe me aktet nënligjore komunale dhe qendrore.

Bashkëpunon me Sektorin e Burimeve Njerëzore në procesin e përzgjedhjes së drejtorëve dhe zv,drejtorëve të institucioneve të arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm (0,1,2,3), në pajtim me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.

Në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe në bashkëpunim me Sektorin e Pagave menaxhon procesin e pagesave të stafit aktiv arsimor dhe stafit tjetër profesional dhe mbështetës në institucionet shkollore-arsimore të Komunës.

Në pajtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, planifikon dhe mbikëqyrë zbatimin e strategjive për arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm në Komunën e Istogut.

Mbikëqyrë institucionet arsimore dhe vlerëson performancën e të gjithë të punësuarit e drejtorisë dhe drejtuesve të institucioneve arsimore në nivel Komunal.

Regjistron dhe pranon nxënësit, në pajtim me parimin e mos-diskriminimit të të gjitha formave të tij.

Regjistron të gjitha të dhënat e nxënësve dhe evidenton, ruan dhe arkivon dosjet e personelit arsimor dhe trupit menaxherial, në përputhje me ligjet, procedurat dhe formularët e MASHTI.

Nxitë dhe promovon mundësitë për të ndjekur arsimin parashkollor, arsimin e obliguar fillor dhe atë të mesëm në kushte të barazisë së plotë për të gjithë;

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT
RAPORTI I PUNËS PËR PËRIUDHËN JANAR-DHJETOR 2025

Projektet kapitale në fushën e infrastrukturës

1. **Ndërtimi i Stadiumit të Qytetit “Demush Mavraj” – Faza V**
Mjetet e nevojshme për realizimin e kësaj faze janë marr nga përmbaruesi.
2. **Ndërtimi i Sallës së Sporteve në Vrellë**
Punimet kanë përfunduar me sukses.
3. **Ndërtimi i Fushës Ndihmëse të Futbollit në Istog**
Punimet kanë përfunduar me sukses.
4. **Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës dhe Parkut në Vrellë**
Projekti është në fazën tenderuese.
5. **Dekorimi i Qytetit për Festat e Fundvitit, Në implementin**
6. **Botimi i 4 Librave** është përfunduar me sukses.

Aktivitetet e realizuara nga Sektori i Kulturës

1. Koncert festiv për fëmijë “Kosova 17”, në nder të Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës.
2. Program kulturor-artistik me këngë dhe valle popullore, me rastin e **12 Prillit – Ditës së Dëshmorëve të Istogut**.
3. **Botimi i 4 Librave** nga Drejtoria
4. Promovimi i librit “**Istogu gjatë viteve 1968–2008**”.
5. Promovimi i librit “**Enigmë e Lumturisë**”.
6. Promovimi i përmbledhjes poetike me krijimet e nxënësve të shkollave të Komunës së Istogut “**Zjarri i Fjalës**”.
7. Promovimi i librit “**Dritë në Errësi**”.
8. Për nder të **Ditëve të Bashkatdhetarëve**, janë mbajtur aktivitete kulturore për tre net radhazi:
 - 8.1 Koncert për fëmijë
 - 8.2 Aktiviteti kreativ “Pikturojmë së bashku”
 - 8.3 Koncert për të rritur
9. Për nder të ditës të **28 Nëntorit – Ditës së Flamurit** është mbajtur koncert për fëmijë

Aktivitetet e realizuara nga Sektori i Rinisë dhe Sportit

1. Turniri tradicional në shah “**Tre Dëshmorët e Shkollës Shqipe**”.
2. Gara në hendboll për shkollat fillore, në nder të **Tre Dëshmorëve të Shkollës Shqipe**.
3. Shpallja e thirrjes publike për **Kategorizimin e Klubeve Sportive të Komunës së Istogut**.
4. 2 Prilli, dita ndërkombëtare e librit për fëmijë është shënuar edhe kësaj radhe në mënyrë simbolike. Fëmijët kanë shkruar dhe lexuar në bibliotekë dhe u është shpjeguar rëndësinë dhe historikun e saj.

5. Me rastin e **12 Prillit – Ditës së Dëshmorëve të Istogut**, u organizuan aktivitete sportive në pingpong, në Shtëpinë e Kulturës “Adem Jashari” – Istog.
6. Mbështetja e sportit shkollor për organizimin e garave ndërmjet shkollave të Komunës së Istogut.
7. Shpallja e fituesve të thirrjes publike për Klubet Sportive për katëgorizim dhe nënshkrimi I kontratave
8. Vizita sistematike Klubeve Sportive, përkrahja dhe përcjellja e aktiviteteve të tyre.
9. Për nder të **Ditëve të Bashkatdhetarëve**, u organizuan aktivitete sportive për dy net radhazi në Parkun e Qytetit.
10. Turnir festiv në volejboll, me rastin e **28 Nëntorit – Ditës së Flamurit**.
 - Totali i hapësirave sportive të shtuar gjat vitit 2025 - 800 m² Salla e Sporteve në Shkollën Filllore “Hysni Zajmi” Vrellë.
 - Totali i hapësirave sportive në shkolla: 19,548 m²
 - Totali i hapësirave për aktivitete sportive jashtë shkollave: 13,600 m²
 - Totali i hapësirave të menagjuara nga Komuna për aktivitete sportive 33.148 m²
 - Hapësira për aktivitete të sportit për numër të banorëve metra katror: 33.148 m²

BIBLIOTEKA E QYTETIT : “ BREZI I RI ” ,

- Për gjatë vitit 2025, që po e lëmë pas , duke u bazuar edhe në detyrat dhe punët që prasheh Ligji për biblioteka ,ne si staf kemi zbatuar planin që e kemi hartuar që nga fillimi I vitit e deri më tash Kemi qenë gjithnjë në bashkëpunim edhe me stafin kolegial, drejtorin e Shtëpisë së Kulturës “ Adem Jashari” si dhe më DKRS-në.
- Viti 2025 u përmyll me suksese të mira , falë bashkëpunimeve tona të vazhdueshme.
- Gjatë vitit 2025 në fondin e bibliotekës tonë i janë shtuar disa tituj të rinj.

22 libra nga vetë autorët

10 libra donacion

- Numri i librave në librin e inventarit në bibliotekë ka arritur në 20483 ekzemplarë.
- Gjatë vitit 2025 numri I lexuesve në bibliotekë ka qenë:

141 lexues pa pagesë

39 lexues me pagesë dhe

7 lexues me asistencë social dhe veteran.

- Pra gjithsej për vitin 2025 në bibliotekën tonë janë regjistruar 187 lexues.

BIBLIOTEKA: "BREZI I RI" DEGA NË GURRAKOC

- Gjatë vitit 2025 biblioteka ka kryer punën e saj në shërbim sa më të mirë të mundshëm për komunitetin, duke ofruar potencialin e fondit librarë dhe duke zhvilluar disa aktivitete për fëmijë. Në kuadër të këtyre aktiviteteve janë shënuar data të rëndësishme kombëtare, të tjera që kanë të bëjnë me librin dhe një numër datash që janë të shënuara në kalendarin tonë të bibliotekave.
- Kemi pranuar një numër fëmijësh që kanë vizituar bibliotekën në mënyrë të organizuar (nxënës të shkollave), lexim poezish në orët e organizuara letrare dhe punëtori me vizatime e skica që ndikojnë në përafrimin e fëmijëve me bibliotekën dhe librin.
- Në vitin 2025 është vërejtur një interesim i shtuar për librin, ku kemi regjistruar një numër lexuesish të rinj, e që pjesa më e madhe e tyre janë mjaft aktiv. Lexuesit tanë gjatë këtij viti kanë huazuar një numër të konsiderueshëm librash krahasuar me vitin e kaluar, por gjithmonë mbetet më shumë për tu bërë në këtë aspekt. Pjesa më e madhe e tyre janë nxënës të shkollave.
- Gjithashtu kemi shkëmbyer përvojat me bibliotekat tjera të Kosovës, bashkëpunime me mësues e arsimtarë shkollash, e veçanërisht me prind e shkrimtarë.
- Viti po mbyllet me rezultate pune, por edhe me plane e projekte që na presin për vitin 2026, e të cilat duhet realizuar me angazhim e përkushtim serioz ndaj punës, duke shikuar mundësi të reja në pasurimin e fondit librarë dhe përmirësimin e kushteve të punës e gjetjen e metodave të reja për arritjen e synimeve.

- Hartimi I planit te punës ,sektori Muze Arkeologji.
- Nxënës nga Komuna e Deqanit,shfmu Isniq dhe Carrabreg ,të prirë nga Artan Maksutaj dhe stafi arsimor, në vizitë Muzeut Komunal në Istog.
- Shkemb Manaj, me një delegacion,nga Prishtina e Istogu ,në vizitë Muzeut Komunal.”Ne këtë vend,e kaluara jeton për te frymëzuar të ardhmen “ thot prof,Dr. Sebeze Kabashi- Muqaj.
- Gani Hysenaj ,me te birin vizituan Muzeun komunal.
- Në Muzeun Komunal,prita nxënësit,bashkë më stafin arsimor,të shkolles fillore”Mehmet Akif Errsoit” nga Shushica e Poshtme .
- .Afrim Peci-Boletini , bashk ,më shokun e tij anglez Tomy Mullen,Londer, vizituan Muzeun Komunal.
- Valon Shkodranga Instituti Albanologjik, Prishtinë,në vizitë Muzeut Komunal.Me respekt flet për koleksionin e eksponateve, po edhe per ligjerimin profesional
- Dy profesor të artit:Bajram Lajqi e Besnik Hasanaj, të gjimnazit “Haxhi Zeka” , vizituan Muzeun.
- Nxënësit e ShFMU,”Ismail Qemajli ”, SARADRAN,te prirë ,nga drejtori Skender Berisha , dhe stafi arsimor,vizituan Muzeun Komunal.
- Ramë Ukaj,aktualisht restaurator I veprave të artitnë Bërlin,më bashkevendasin e tij nga Kaligani vizituan Muzeun Komunal.
- Pjesmarrje ,në Muzeun Etnologjik të Pejës ,në inaugurimine pranim-dorezimit ,të Xhubletës Iliro - shqiptare,qe familja e Gjergj Dedvukaj, nga Bardhaj I Hotit , me banim ,në Michigan të SHBA , ia dhuroi ,Muzeut Etnologjik të Pejës .Tashmë e pranuar ,ne UNESCO,si trashegimi e kulturës botërore .
- Rifat Gjoci, Tomoc, arsimtar I Historisë ,vizitë ,në Muzeun Komunal ,duke premtuar për dhurimin e eksponateve .
- Kimete Arifaj,Rakosh, anëtare e Bordit të ACK , Departamenti për Rini I OKB -Prishtinë ,vizitë në Muzeun Komunal.

- Mysafir I veçant,në Muze, Pashk Mhill Alia , historian nga Puka ,Shqipëri ,vizitoi Muzeun Komunal ,duke shkrojtur në mbresën e Tij:”një punë shkencore e nivelit të lartë” . Ai kishte ardhë ,për të mbledhur të dhëna për fiset : Berishë ,Bytyq, e Kabash,më gjenezë ,nga rrethi I Pukës, rezidente ,në Podgurin e Istogut.E shoqerova ne teren.
- Emision promovues: RTV Dukagjini në Muzeun Komunal , gazetare Drenushë Zogaj.Ekspoze ekskluzive ,për trashëgiminë e Podgurit
- Cifti bashkëshortor,Ali Arifaj,më bashkëshorten dhe djalin ,rezident në Gjermani, vizituan Muzeun Komunal.
- Bedri Berisha ,së bashku më mikun tim Gani Dreshaj ,te migruar ne Finlande, njohës te trashëgimisë kulturore ,në vizitë Muzeut. Ai la mbresën e Tij:”Jam I impresionuar më pasurinë arkeologjike ,qe ka Istogu “.
- Ilir Alushaj dhe Murat Ademaj , Shushicë e Ulët,njohës te trashëgimisë,vizitun Muzeun Komunal të Istogut.Vlersojnë eksponatet e Antikitetit dhe deshmorve te komunës se Istogu
- Rifat Gjoci , Tomoc,arsimtar I lëndës se Historisë ,në SHFMU , Gurrakoc , I dhuroi Muzeut komunal 4 eksponate , më vlerë historike , te cilat do e pasuroin koleksionin e Muzeut.
- Grup I nxëseve, nga gjimnazi “Haxhi Zeka “ ,Istog :Erza, Erona , Eliana Blerta ,Vanesa , Auguriana , vizituan Muzeun ,duke bashkebiseduar ,për vlerat e trashëgimisë .
- Dr. Xhavit Bytyqi më Hafizin e Tetovës Ramadan Ramadani ,vizituan Muzeun Komunal , Ekspoze mbi vlerat e trashëgimisë ,me një komunikim interaktiv.
- Me sternipat e Lash Ukës , Kaliqan ,në Muzeun komunal: Muhamet e Fahri Uka , të cilët kishin nostalgji ,për bustin e Nënës Fatime,në veshë të Podgurit...
- Cifti i ri,Petrit Llapi e Vera Osmanaj , Istog i Poshtëm
- ,vizituan Muzeun ,duke pozuar në pika të vecanta të tij,për ti patur si kujtim ,në Nyrrenberg të Gjermanisë.
- Hartimi I kumteses per Historine e Plisit.
- Nxenes te SHFMU “Bajram Curri” ,ne Istog , vella e moter:Bleart e Bleona Llullaku ,vizituan Muzeun Komunal.

SEKTORI I MUZIKËS

- Puna më korit të fëmijëve – mbi -40.Fëmijë.më këngëtarët e vegjel,dhe puna më valltrë,ku kemi 2 grupe,sipas moshës-gr.parë nga kl.1 deri 5-grupi dytë nga kl.6-deri në kl.9.t pran pallatit të kulturës,,A.Jashari" në Istog –PREGADITJE PËR KONCERTIN e 17.shkurtit.2025. Ku do të shfaq një program më këngë ,valle, dhe recitime,
- KONCERTI I 17.shkurtit.2025.nga ora 15.në pallatin e kulturës,,Adem Jashari” për nder të ditës së pavarësisë së Kosovës,
- Ushtrime aktive ditore dhe javore për aktivitetet e marsit dhe të prillit. më korin e fëmijëve,dhe grupet tjera.
- Ushtrime javore më grupin AKTIVE,për pjesmarrjen në manifestimin –Dita e dëshmorëve të Istogut,që u mbajt më 12.04.2025.në ora 11:00
- Puna me korin e fëmijëve – mbi -40.Fëmijë. pran pallatit të kulturës,,”A.Jashari” në Istog
- Pjesmarrja me femijet e sektorit te muzikes ne ditën e deshmoreve koncert qe u mbajt te permendorja e deshmoreve ne qender.
- Ushtrime ditore më grupin e fëmijëve të sektorit të muzikës pran pallatit të kulturës në Istog, sipas orarit: **-grupi i parë para** dite nga ora :10 deri në 11 e 30.h dhe **-grupi I dytë** pas dite nga ora: 13 e 30 deri në 15 e 30.h
- 12.Prill.pjesmarrja e grupit të rapsodëve të sektorit të muzikës,në manifestimin –përkujtimin e martirëve në stupe.
- Provat gjenerale per koncertin e 1 qershorit,
- Mbajtja e koncertit per ditën e femijeve 1 qershori
- aktivitete javore më: korin e fëmijëve të pallatit të kulturës,,Adem Jashari" në Istog
- Ushtrime ditore më grupin e fëmijëve të sektorit të muzikës pran pallatit të kulturës në Istog, sipas orarit: **-grupi i parë para** dite nga ora :10 deri në 11 e 30.h dhe **-grupi I dytë** pas dite nga ora: 13 e 30 deri në 15 e 30.h
- Aktivitete ditore dhe javore më fëmijët e pallatit të kulturës në Istog:

1x-në javë kori I fëmijëve

1x-në javë 2 grupet e valltarëve,

- -Puna ditore më këngëtar,17.këngëtar-fëmijë
- Pregaditje AKTIVE për ditët e diasporës
- Koncerti „DITËT E DIASPORËS”2025,u mbajt më 28.korrik në parkun e qytetit,ku pati më qindra qytetar nga vendi e diaspora që ndjekën koncertin për diasporën
- -Puna javore më korin e fëmijëve të pallatit të kulturës-qdo të martë.
- -Puna javore më 2 grupët e vallzimit më fëmijët e pallatit të kulturës,qdo të premte.
- -Puna ditore më fëmijët e pallatit të kulturës,në këndimin solo dhe grupor.

- Pregaditje aktive për koncertin e 28.nëntorit. 2025.më fëmijët e sektorit të muzikës pran pallatit të kulturës në Istog.
- aktivitete javore më:
korin e fëmijëve të pallatit të kulturës,,Adem Jashari" në Istog
- Ushtrime ditore më grupin e fëmijëve të sektorit të muzikës pran pallatit të kulturës në Istog, sipas orarit: **-grupi i parë para** dite nga ora :10 deri në 11 e 30.h dhe **- grupi I dytë** pas dite nga ora: 13 e 30 deri në 15 e 30.h
- Aktivitete ditore dhe javore më fëmijët e pallatit të kulturës në Istog:
-1x-në javë kori I fëmijëve
-1x-në javë 2 grupet e valltarëve,
- -Puna ditore më këngëtar,17.këngëtar-fëmijë
- -Puna javore më korin e fëmijëve të pallatit të kulturës-qdo të martë.
- -Puna javore më 2 grupët e vallzimit më fëmijët e pallatit të kulturës,qdo të premte.
- -Puna ditore më fëmijët e pallatit të kulturës,më këngëtarët solo.
- Koncerti I 28.nëntorit.2025.për nder të pavarsisë së shqipërisë,mbajtur në sallën e koncertëve në pallatin e kulturës,,Adem Jashari”në Istog,nga ora 15.ku salla ishte e stermbushur më shikues.
- Korin e fëmijëve të pallatit të kulturës,,Adem Jashari" në Istog.
- Ushtrime ditore më grupin e fëmijëve të sektorit të muzikës pran pallatit të kulturës në Istog, sipas orarit: **-grupi i parë para** dite nga ora :10 deri në 11 e 30.h dhe **- grupi I dytë** pas dite nga ora: 13 e 30 deri në 15 e 30.h

Departamenti	Numri
Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport	83
Totali	83

Statusi	Numri	%	Diagrami
---------	-------	---	----------

Departamenti			Numri
Miratuar	59	71.1	
Refuzuar	15	18.1	
Anuluar	9	10.8	
Totali	83		

DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL
RAPORTI I PUNËS PËR PERIUdhËN JANAR-DHJETOR 2025

1. Sektori i Bujqësisë

Gjatë periudhës raportuese, dhe në përputhje me Programin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2025, Drejtoria ka realizuar një sërë aktivitete të rëndësishme koordinuese dhe operative me qëllim sigurimin e bazës së nevojshme për zbatimin efikas të projekteve bujqësore në vitin e ardhshëm. Në këtë drejtim, janë zhvilluar takime të rregullta dhe pune me organizatat partnere që operojnë në sektorin e bujqësisë, përfshirë Organizatën e Ushqimit dhe Bujqësisë (FAO), organizatën Syri i Vizionit dhe Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR). Qëllimi kryesor i këtyre takimeve ka qenë harmonizimi i planifikimeve, koordinimi i aktiviteteve të parapara, si dhe identifikimi i mundësive për mbështetje të sektorit bujqësor në nivel komunal.

Po ashtu, Drejtoria ka realizuar një numër të konsiderueshëm takimesh konsultative me palë të tjera relevante, përfshirë fermerë, përfaqësues të bizneseve bujqësore dhe institucione të ndryshme. Këto takime kanë shërbyer për identifikimin e nevojave dhe sfidave në terren, për orientimin e palëve drejt programeve mbështetëse dhe për përmirësimin e bashkëpunimit ndërinstitucional.

Në kuadër të programit të punës janë zhvilluar të gjitha aktivitetet e planifikuara për sektorin e bujqësisë, duke përfshirë ofrimin e shërbimeve administrative dhe profesionale, procesimin e kërkesave të palëve, ofrimin e këshillave teknike për fermerët, si dhe veprimet përgatitore për zbatimin e projekteve të planifikuara për vitin 2025. Të gjitha aktivitetet janë realizuar në përputhje me kornizën strategjike të Drejtorisë dhe në funksion të përmbushjes së objektivave institucionale për zhvillimin e sektorit bujqësor në Komunën e Istogut.

I. Aktivitetet në periudhën, janar- dhjetor 2025

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2025, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (DBZHR) ka realizuar një sërë aktivitete të rëndësishme me qëllim funksionalizimin e shërbimeve komunale, përmirësimin e mbështetjes ndaj fermerëve dhe përgatitjen për zbatimin e projekteve kapitale. Aktivitetet kryesore janë si më poshtë:

1. Arkivimi dhe administrimi i dokumentacionit:
 - Janar 2025: Janë përgatitur dhe dorëzuar për arkivim të gjitha kërkesat dhe lëndët e vitit paraprak pranë arkivës komunale, duke siguruar ruajtjen dhe qasjen e duhur në dokumentacion.
2. Rekrutimi dhe trajnimi i stafit për pagesa direkte:
 - Janë përfunduar procedurat për rritjen e stafit të Drejtorisë, duke pranuar katër zyrtarë të rinj me kontrata për shërbime të veçanta sipas ligjit të prokurimit.
 - Zyrtarët e rinj janë trajnuar për procedurat e aplikimit dhe digjitalizimit të parcelave, si dhe kanë punuar në përgatitjen dhe procesimin e aplikimeve të fermerëve për pagesa direkte.
3. Përgatitjet logjistike dhe teknologjike:
 - Janë siguruar të gjitha materialet shpenzuese dhe pajisjet teknologjike të nevojshme për mbarëvajtjen e procesit të aplikimeve për pagesa direkte.

4. Projektet kapitale dhe prokurimet:
 - Janë inicuar procedurat për zotimin e mjeteve financiare për projektet kapitale.
 - Janë përgatitur dhe shpallur kërkesat për tenderë dhe procedurat për prokurime në përputhje me buxhetin e miratuar të komunës.
 - Janë organizuar aktivitete tradicionale ne promovim te vlerave bujqësore “Të Qethat 2025 “ dhe “Dita e Mollës 2025 “.
5. Pranim dhe përgjigje në kërkesat e palëve:
 - Drejtoria ka trajtuar dhe dhënë përgjigje për kërkesat e fermerëve dhe palëve të tjera të interesit.
 - Janë ofruar shërbime këshillimore, ekspertiza dhe vërtetime për fermerët dhe subjekte të tjera bujqësore.
6. Vlerësimi i dëmeve nga fatkeqësitë natyrore:
 - Janë realizuar vlerësime për dëmet e shkaktuara nga ngjarje të ndryshme natyrore, përfshirë ngricat pranverore, zjarret dhe fatkeqësitë e tjera.
7. Raportimi dhe koordinimi me nivelin qendror:
 - Janë përgatitur dhe dërguar raporte pranë institucioneve qendrore mbi aktivitetet e drejtorisë dhe rezultatet e sektorit të bujqësisë gjatë periudhës raportuese.

Të gjitha aktivitetet e realizuara janë në përputhje me planin e punës së Drejtorisë, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj fermerëve në komunë.

II. Kërkesat drejtuar drejtorisë se bujqësisë

- Gjatë kësaj periudhe raportuese janë, pranuar dhe shqyrtuar 1638 kërkesa te ndryshme të palëve, drejtuar në sektorin e bujqësisë te specifikua si me poshtë.

Pranuar	Ne proc es	Mira tuara	Refu zuar	Pezu uar	Anul uar
Kërkesa te rregullta	2	3			4
Kërkesa për vlerësim te dëmeve nga ngricat pranverore		5			
Kërkesa për vlerësim te dëmeve nga zjarret fushore		2			
Aplikime për pagesa direkte-subvencione		1			0
		2			0
		7			
		8			
Aplikime për pagesa për kilogram te grurit		8			
		5			

Aplikimi qumësht, majmëri, akuakultur, therje te kafshëve			1		
			2		
			2		
Totali i lendeve te trajtuara	2		1		4
			6		
			0		
			0		
Totali i lendeve te shqyrtuara	1638.00				

- Gjatë fazës se aplikimit te fermerëve për pagesa direkte janë pranuar dhe procedura 1485 kërkesa te fermerëve për aplikim ne pagesat direkte te specifikuara si me poshtë:

	Spektori		Viti 2025	Sipërfaqja/ha	Nr. i aplikacioneve
	Lavërtari	Grurë sipërfaqe		2,795.58 ha	605
		Grurë kg		5,455,194.5	185
		Grurë për farë		95.96 ha	3
		Misër		1,707.62 ha	521
		Thekër		10.97 ha	4
		Elb		61.07 ha	32
		Tërshërë		48.62 ha	27
		Lule dielli		2.14 ha	1
	Perimtari	Perime në fushë		115.05 ha	28
		Perime në sera		2.25	12
		Asparagu		1.29 ha	1
		Fasule monokulturë		4.54 ha	3
		Kunguj		7.22 ha	13

		Vreshta		14.39 ha	1
	Pemëtari	Pemë		350.13 ha	272
		Pemë të imëta		7.28 ha	10
		Material fidanor		35.500 cop	1
	Blegtori	Lopë qumështore	20 muaj – 12 vjet	4,691 krerë	415
		Mëshjtjerra	14 – 20 muaj	435 krerë	173
		Qumësht litra	Gjashtëm ujori I	2,783,5 97.39 L	91
			Gjashtëm ujori II	/	
		Bletë		5.911 koshere	104
		Dele		7.430 krerë	82
		Dhi		951 krerë	18
		Viça për majmëri	Gjashtëm ujori I	432	26
			Gjashtëm ujori II		
		Dosa		11	2
	Therje të raportuara	Gjedhe-	Gjashtëm ujori I	425	2
			Gjashtëm ujori II		
	Shpeztari	Pula		28.800	3
	Akuakulturë	Peshk	Gjashtëm ujori I	256,92 9.28 kg	3
			Gjashtëm ujori II	/	
	Bimë mjekësore dhe	Konvencionale		49.32 ha	13

	aromatike				
		Konvertim		0.18 ha	1
	Bujqësi organike	Organike		190.22 ha	10
Totali:	Ara			5,463.83 ha .	
	Qumësht (litra) I			2,783,597.39 liter	
	Akuakulturë (Peshk) I			256,929.28 kg	
	Viça për majmëri I+II			432 copë	
	Therje të raportuara (gjedhe) I+II			425 copë	

III. Projektet kapitale

Janë zotuar mjetet për projekte kapitale sipas listës së projekteve dhe kanë filluar procedurat e prokurimit për një pjesë të projekteve;

Janë shpallur tenderi për projektet:

- Mirëmbajtja e rrugëve malore Lot 1 Radusha dhe Lot 2 Lugu i Butë ,
- Rehabilitimi i kanalit të Gogës nga trofta deri në Tomoc
- Dhe në vazhdim të sipër projekti dy vjeçar segmenti 4 i kanalit të Gogës në Gjurakoc

Në ndërkohë për projektet kapitale ka pasur ngecje në realizim për shkak të marrjes së mjeteve nga përmbartësit sipas vendimeve të gjykatave kompetente.

IV. Aktivitetet Promovuese dhe Kulturore

Në funksion të ruajtjes së traditave bujqësore dhe promovimit të vlerave kulturore të komunitetit, Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka organizuar dy aktivitete të rëndësishme gjatë vitit 2025: “Të Qethat 2025” dhe “Dita e Mollës 2025”. Këto aktivitete kanë synuar nxitjen e bashkëpunimit me fermerët, krijimin e një hapësire sociale për promovimin e produkteve vendore dhe forcimin e identitetit lokal.

1. Aktiviteti “Të Qethat 2025”

Ky aktivitet tradicional, i cili ka për qëllim promovimin e traditave të blegtorisë, qethjes së deleve, ka përfshirë prezantime kulturore, gara tradicionale dhe ekspozim të produkteve vendore. Ngjarja ka shërbyer si platformë e rëndësishme për ndërveprim ndërmjet fermerëve, institucioneve dhe qytetarëve, ku kanë marr pjesë rreth 400 pjesëmarrës të moshave dhe gjinive të ndryshme.

2. Aktiviteti “Dita e Mollës 2025”

Ky aktivitet ka qenë i fokusuar në promovimin e pemëtarisë, veçanërisht kultivimit të mollës si një kulturë strategjike për komunën. Gjatë aktivitetit:

- janë prezantuar produkte vendore dhe nënprodukte frutore;
- është shënuar në mënyrë simbolike hapja e sezonit të vjeljes së mollëve, me pjesëmarrjen e fermerëve, përfaqësuesve institucionalë dhe komunitetit lokal.

Ky aktivitet ka kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e pemëtarisë, promovimin e praktikave të mira bujqësore dhe forcimin e lidhjes ndërmjet fermerëve dhe konsumatorëve, ku numri i pjesëmarrësve ka qenë rreth 300 pjesëmarrës të grup moshave të ndryshme.

V. Trajnime me fermer

Gjatë kësaj periudhe raportuese në bashkëpunim me Departamentin e Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike të MBPZHR është implementuar projekti " Zhvillimi i Zonave Rurale përmes Avancimit të Shërbimeve Këshillimore". Ku janë ofruar trajnime profesionale për fermer, nga ekspert të ndryshëm bujqësor . Janë mbajtur 6 trajnime, me grupe të fermerëve me tema të ndryshme nga prodhimi bujqësor dhe blegtorale dhe tri aktivitete dite fushore, ku kanë marrë pjesë në këto trajnime rreth 95 fermer

VI. Sfidat

Gjatë vitit raportues, Drejtoria e Bujqësisë është përballur me një sërë sfidash që kanë ndikuar në ritmin dhe efikasitetin e realizimit të aktiviteteve. Sfidat kryesore për periudhën raportuese janë:

- Mungesa e trajnimeve profesionale për stafin, veçanërisht në menaxhimin e kontratave, vlerësimin e tenderëve, mbikëqyrjen e punimeve dhe fusha të tjera teknike të domosdoshme për realizimin e projekteve kapitale.
- Numër i madh i kërkesave të fermerëve për kompensim financiar si rezultat i dëmeve të shkaktuara nga kafshët e egra, ngordhjet natyrore të kafshëve shtëpiake dhe dëmtimet e ndryshme të objekteve bujqësore.
- Mungesa e mjeteve të mjaftueshme financiare për mbështetjen e projekteve të fermerëve, iniciativave zhvillimore në sektorin e bujqësisë dhe kompensim të dëmeve .
- Mos kompensimi i dëmeve nga fatkeqësitë natyrore në kultura bujqësore , kafshë shtëpiake, infrastrukturës bujqësore dhe bazës ushqimore të blegtorisë

VIII. Rekomandime

Për adresimin e sfidave të evidentuara dhe për rritjen e kapaciteteve funksionale të Drejtorisë, rekomandohen këto masa:

- Rekrutimi i stafit profesional të rregullt, në përputhje me nevojat operative dhe obligimet ligjore të drejtorisë.
- Organizimi i trajnimeve të specializuara për stafin në fushat e menaxhimit të kontratave, vlerësimit të tenderëve, mbikëqyrjes së punimeve dhe fusha të tjera profesionale të ndërlidhura me realizimin efikas të projekteve.
- Hartimi i dokumenteve strategjike, përfshirë Planin Strategjik për Bujqësi dhe Zhvillim Rural si dhe Planin për Mbrojtjen e Tokës Bujqësore, me fokus në zhvillimin afatgjatë dhe të qëndrueshëm të sektorit.

IX. Përfundim

Pavarësisht sfidave të evidentuara, stafi i Drejtorisë ka treguar angazhim dhe përkushtim në përmbushjen e detyrave dhe realizimin e projekteve të planifikuara për periudhën raportuese. Gjatë këtij viti është ruajtur komunikim dhe koordinim i rregullt me institucionet e nivelit qendror, organizatat partnere, shoqatat dhe aktorë të tjerë për të mbështetur fermerët dhe për të kontribuar në zhvillimin e mëtejshëm të sektorit të bujqësisë.

Zbatimi i rekomandimeve të sipërpërmendura do të mundësojë funksionalizim më efikas të drejtorisë dhe përmbushje të plotë të kompetencave ligjore. Mungesa e stafit të rregullt mbetet një pengesë e rëndësishme në themelimin dhe funksionimin e komisioneve profesionale shumëvjeçare të parapara me aktet ligjore në fuqi.

DREJTORIA E SHËNDETËSISË ***RAPORTI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2025***

Gjat të vitit 2025 e terë puna dhe aktiviteti i Drejtoratit për Shëndetësi ka qenë e drejtuar në përmirësimin dhe në ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore për qytetarët e komunës së Istogut. Rëndësi e veçantë i është kushtuar sidomos zbatimit të reformave në lëmin e Mjekësisë Familjare, përmirësimit të kushteve të punës dhe të infrastrukturës në objektet shëndetësore. Për kundër faktit se jemi duke punuar në hapësira të zvogëluara në QKMF për shkak se objekti i parë i QKMF është rrenuar i tëri dhe ka filluar ndërtimi i objektit të ri të QKMF, dhe shumica e shërbimeve janë bartur në objektin e dytë të QKMF, të gjitha shërbimet janë duke punur normalisht pa ndërpre duke ofruar shërbime sa më të mira në dobi të qytetarëve. Gjatë kësaj periudhe të raportimit, në bashkpunim me menaxhmentin e QKMF kemi bërë vizita të vazhdueshme në QKMF dhe të gjitha qendrat tjera shëndetësore (QMF dhe AMF), ku jemi njoftuar për së afërmi me kushtet dhe kemi identifikuar problemet dhe nevojat e këtyre njësive. Problemet e identifikuar janë kryesisht të natyrës teknike të mirëmbajtjes së hapsirave dhe parqeve. Pastaj vëmendje i kemi kushtuar edhe shërbimit të diagnostikës (Rentëgenit dhe shërbimit të Laboratorit), kemi bërë furnizime të pa ndërprera me reagenca për nevoja të shërbimit të Laboratorit dhe filma për shërbimin e Rentgenit. Në shërbimin e radiologjisë kemi angazhuar Radiologun si konsulent i jashtëm, i cili bënë leximin dhe punimin e raportëve për të gjith ata të cilët i nënshtrohen egzaminimit me Mamografi. Furnizimi me barna dhe material tjetër shpenzues nga lista esenciale i cili realizohet nga Ministria e Shëndetësisë, nuk ka qenë gjithmonë i mjaftueshëm ashtu siq ka qenë planifikimi, prandaj Drejtorati për Shëndetësi për mbulimin e mungesës nga lista esenciale dhe për furnizime me barna jashtë listës esenciale të cilat janë të domosdoshme, ka planifikuar një buxhet prej rreth 130,000.00€. Nga kjo shumë deri me tani janë shpenzuar rreth **67,000.00€**

Sa i përket realizimit të projekteve, në këtë vit kan qenë të planifikuara dy projekte, **Paisje Mjekësore** për nevoja të shërbimit të Mjekësisë Familjare dhe Shërbimit të Laboratorit në shumë prej 30.000.00€ dhe **Blerja e një automjeti për vizita shtëpiake** në shumë prej 35.000.00€. Mirëpo që të dy projekte kan dështu për t'u realizuar për shkak se mjetët e planifikuara për këto dy aktivtete janë marrë nga përmbaruesit privat për realizimin e kërkesave qe dalin nga Kontrata Kolektive për punëtorët Arsimore.

Gjatë kësaj periudhe, kemi përcjellë për së afërmi punimet të cilat janë duke vazhduar në ndërtimin e QKMF së re, punimet janë duke shkuar mirë dhe nëse vazhdohet të punohet sipas dinamikës së paraparë, atëheret faza e parë e ndërtimin do të përfundoj deri ka fundi i vitit.

Në këtë vit, kemi qenë përfitues të një donacioni nga shteti i Katarit dhe me ndërmjetësimin të BIK-ut, për ndërtimin e QMF në Gjurakoc. Punimet kanë përfunduar dhe së shpejti pritet përfurimi.

Shqyrtimi i kërkesave - Gjatë kësajë periudhe, këtij drejtorati i janë parashtruar një numër i madh i kërkesave të cilat kanë të bëjnë me kërkesa për ndihmë financiare për shërim dhe blerje të medikamentëve, këto kërkesa janë në fazën e shqyrtimit dhe për këtë qëllim nga Kategoria Ekonomike Transfere dhe Subvencione kemi planifikuar rreth **30,000.00€**. Po ashtu gjatë kësajë periudhe janë paraqitur edhe një numër të madhë të kërkesave për kompenzimin e shpenzimeve të karburantëve për personat të cilët janë në Hemo-dializë dhe janë duke u trajtuar në repartin Hemodilektik në Spitalin Regjional në Pejë, të cilët janë në gjendje të rëndë shëndetësore dhe si mjet transporti përdorin automjetet private, pastaj për personat të cilët trajtohen me kemio-terapi dhe rrezatim në institutin Onkologjik pranë SHSKUK. Për grupin e parë kemi ndarë nga 57 lit. karburant në muaj ndërsa për grupin e dytë nga 10 lit. karburant për një relacion Istog-Prishtinë dhe anasjelltas. Për këto dy qëllime për periudhën janar-nëntor janë dhënë rreth **19298 litra** karburantë në vlerë prej **19,973.53€**.

Edhe në këtë vit kemi vazhduar me aktivitetin “**Përkujdesja Shëndetësore Shtëpiake dhe Ambulator – Home Care 2025**” i cili realizohet me vizita sistematike në shtëpi për personat dhe familjet me nevojë. Implementues i këtij projekti është Operatori i Ekonomik **Kosova Med**. Përmes këtij projekti kemi realizuar punësimin e 60 punëtorëve kryesisht staf shëndetësorë dhe social. Përmes këtij projekti gjatë kësajë periudhe janë realizuar **587** vizita shtëpiake dhe **3931** shërbime duke ju ofruar shërbime të ndryshme mjekësore për njerëzit me nevojë.

Home-Care në Istog ka pasur mbështetje të vazhdueshme nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, janë siguruar vizitat në teren nga mjekët, për përfituesit e projektit, është bërë sigurimi i medikamentëve esenciale nga barnatoria qendrore e QKMF-së në Istog, sigurimi i gazave, instrumentëve sterile, sigurimi i katetrave, qesëve për stomë etj.

Kujdesi Primarë Shëndetësorë QKMF

Raporti vjetor i punës së Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) paraqet një pasqyrë të përgjithshme të veprimtarisë, organizimit dhe performancës së kësaj qendre gjatë periudhës janar-dhjetor 2025. Ky raport është hartuar në përputhje me obligimet institucionale dhe kërkesat e Drejtorisë së Shëndetësisë, me qëllim të dokumentimit të punës së realizuar, vlerësimit të shërbimeve të ofruara dhe identifikimit të fushave që kërkojnë përmirësim.

Gjatë vitit 2025, QKMF ka luajtur një rol kyç në ofrimin e kujdesit shëndetësor parësor për popullatën, duke siguruar shërbime shëndetësore cilësore, të qasshme dhe gjithëpërfshirëse. Aktivitetet e QKMF-së janë përqendruar në diagnostikimin dhe trajtimin e sëmundjeve akute dhe kronike, ofrimin e shërbimeve preventive, realizimin e vaksinimeve, kujdesin shëndetësor për grupet e ndjeshme, si dhe në reagimin ndaj rasteve emergjente shëndetësore.

Në realizimin e këtyre shërbimeve, stafi shëndetësor dhe administrativ i QKMF-së ka treguar përkushtim dhe profesionalizëm të vazhdueshëm, pavarësisht sfidave të ndryshme, si rritja e kërkesës për shërbime, kufizimet infrastrukturore dhe nevoja për burime shtesë njerëzore dhe materiale. Përmes bashkëpunimit me institucionet relevante shëndetësore dhe partnerë të tjerë, QKMF ka kontribuar në përmirësimin e shëndetit publik dhe rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit.

Ky raport synon të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe të argumentuar mbi gjendjen aktuale të QKMF-së, duke u mbështetur në të dhëna statistikore, analiza të aktiviteteve dhe vlerësime profesionale, si bazë për planifikimin strategjik dhe përmirësimin e mëtejshëm të shërbimeve shëndetësore në vitet në vijim.

Reparti/Njësia	Nr. i pacientëve	Nr.vizitave	Nr. i shërbimeve
Emergjencë	45184	45184	61123
Gjinekologji	1054	1054	1662
Interno	6007	6007	8336
Këshillimore	2506	2506	3937
Kujdesi shtëpiak	1802	1802	7743
Laborator	8372		249188
Mamografi	208		840
Mjekësi familjare	30664	30664	66666
Pediatri	4471	4471	9052
Rentgen	4362		8451
Stomatologji	4216	4216	7750

Për periudhën kohore Janar-Dhjetor 2025, në QKMF-Istog janë ofruar këto vizita dhe shërbime shëndetësore:

Institucionet përbërëse të QKMF-së:

Institucionet përbërëse të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) janë njësi të kujdesit shëndetësor parësor që veprojnë në kuadër të QKMF-së dhe shtrihen në territorin e komunës. Ato

Reparti/Njësia	Nr. i pacientëve	Nr. vizitave	Nr. i shërbimeve
Emergjencë	45184	45184	61123
Gjinekologji	1054	1054	1662
Interno	6007	6007	8336
Këshillimore	2506	2506	3937
Kujdesi shtëpiak	1802	1802	7743
Laborator	8372		249188
Mamografi	208		840
Mjekësi familjare	30664	30664	66666
Pediatri	4471	4471	9052
Rentgen	4362		8451
Stomatologji	4216	4216	7750

funksi
onojnë
si
pjesë e
integru
ar e
sistemi
t të
ofrimit
të
shërbi
meve
shënde

tësore në nivel lokal.

1. Qendra e Mjekësisë Familjare (QMF)

Këto janë njësi më të vogla shëndetësore që veprojnë në fshatra dhe ofrojnë këto shërbime: të mjekësisë familjare, shërbime stomatologjike, vaksinimi dhe imunizimi dhe barnatorja. Në Komunën tonë janë 4 QMF dhe janë të shtrira në këto fshatra:

QMF: Vrellë, Banjë, Gurrakoc dhe Rakosh

2. Ambulancat e Mjekësisë Familjare (AMF)

Ambulanca zakonisht janë njësi edhe më të vogla, që veprojnë në vendbanime rurale apo zona të largëta dhe ofrojnë shërbime bazë të mjekësisë familjare, AMF-të janë të shtrira në këto fshatra

AMF: Shushicë, Uçë, Cërkolez, Veriq, Zallq, Dobrushë, Saradran, Kaliqan, Dubravë

Qendra e Mjekësisë Familjare-BANJË

Reparti/Njësia	Nr. vizitave	Nr. i shërbimeve
Mjekësi familjare	4341	14713
Stomatologji	529	1491

Qendra e Mjekësisë Familjare-VRELLË

Reparti/Njësia	Nr. vizitave	Nr. i shërbimeve
----------------	--------------	------------------

Mjekësi familjare	2546	5632
Stomatologji	453	1411

Qendra e Mjekësisë Familjare-GURRAKOC

Reparti/Njësia	Nr.vizitave	Nr. i shërbimeve
Mjekësi familjare	3411	7329
Stomatologji	284	499

Qendra e Mjekësisë Familjare-RAKOSH

Reparti/Njësia	Nr.vizitave	Nr. i shërbimeve
Mjekësi familjare	2847	4131
Stomatologji	178	517

Ambullantat e Mjekësisë Familjare

	Nr.vizitave	Nr. i shërbimeve
AMF-CËRKOLEZ	0	0
AMF-DOBRUSHË	0	644
AMF-DUBRAVË	0	465
AMF-KALIQAN	0	1595
AMF-SARADRAN	0	3042
AMF-SHUSHICË	0	316
AMF-UÇË	0	11
AMF-VERIQ	0	0
AMF-ZALLQ	0	2231

KUJDESI PALIATIV

Në kuadër të zhvillimit të kujdesit paliativ në Komunën e Istogut, ekipet tona të kujdesit shtëpiak të përbëra nga mjekë dhe infermierë të kualifikuar – ofrojnë shërbime shëndetësore dhe mbështetëse për të gjithë territorin e komunës, duke përfshirë edhe të gjitha fshatrat përreth. Ekipi është funksional 12 orë në ditë dhe synon ofrimin e një kujdesi të vazhdueshëm dhe cilësor në shtëpi, veçanërisht për pacientët që nuk mund të marrin trajtim në institucionet shëndetësore.

QKMF-ja tashmë ka 2 ekipe mobile të kujdesit shtëpiak, duke siguruar fokus të veçantë tek **kujdesi geriatrik**, pasi një pjesë e madhe e pacientëve tanë janë të moshuar dhe jetojnë të vetëm pa përkujdesje familjare, përveç trajtimit mjekësor kanë nevojë të shtuar për **mbështetje psikosociale**.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar identifikimit të hershëm të pacientëve që përfitojnë nga kujdesi paliativ, si dhe angazhimi i komunës së Istogut në rritjen e kapaciteteve të stafit përmes trajnimeve të vazhdueshme në këtë fushë.

Shërbimet e ofruara në terren përfshijnë:

- **Vizita të rregullta mjekësore dhe infermierike në shtëpi;**
- **Vlerësim dhe menaxhim i simptomave** (dhimbje, ankth, marramendje, të përziera, vështirësi në frymëmarrje, etj.);
- **Administrim i terapisë parenterale** (injeksione intramuskulare, subkutane dhe intravenoze sipas nevojës dhe përshkrimit mjekësor);
- **Pastrim dhe mjekim i plagëve**, përfshirë plagë kirurgjikale, dekubitale dhe infeksione të lëkurës;
- **Vendosje dhe ndërrim i kateterit urinar**, si dhe monitorim i funksionit urinar;
- **Heqje e penjeve pas ndërhyrjeve kirurgjikale**, në përputhje me protokollet mjekësore;
- **Mbështetje emocionale dhe këshillim për pacientin dhe familjen**, me theks në ruajtjen e dinjitetit dhe cilësisë së jetës;
- **Edukimi i familjarëve** për menaxhimin e simptomave, administrimin e ilaçeve dhe kujdesin e përditshëm të pacientit;
- **Ofrimin e ndihmës për pajisje ndihmëse** (si shtretër ortopedikë, dyshek antidekubitus, etj.), në varësi të mundësive dhe nevojës.
- **Koordinim me mjekun familjar dhe institucione të tjera për një qasje të integruar dhe të vazhdueshme të kujdesit.**

Gjatë periudhës për të cilën po raportojmë, nga ekipet e kujdesit shtëpiak janë ofruar këto shërbime:

Janë vizituar gjithsej 1802 pacientë dhe janë ofruar 7743 shërbime për këta pacientë

SHËRBIMI GJINEKOLOGJIK

Gjatë periudhës raportuese, shërbimi gjinekologjik ka vazhduar të ofrojë kujdes për gratë dhe vajzat në të gjitha grupmoshat, me fokus në diagnostikimin, trajtimin dhe parandalimin e sëmundjeve gjinekologjike.

Ky shërbim është realizuar përmes vizitave të rregullta gjinekologjike, ekzaminimeve klinike dhe procedurave diagnostikuese, duke përfshirë:

- **Kontrolla rutinë gjinekologjike;**
- **Evidentimi dhe ndjekja e rasteve me çrregullime menstruale, infeksione të traktit riprodhues, dhe patologji të tjera gjinekologjike;**
- **Monitorimi i shtatzënive në fazat e hershme dhe referimi i rasteve me rrezik të lartë;**
- **Këshillimi për planifikim familjar dhe kontraktivë;**
- **Këshillimi për shëndetin riprodhues dhe edukim seksual;**
- **Kryerja e ekzaminimeve PAP test**, si shërbim i ri i integruar për herë të parë në kuadër të shërbimit gjinekologjik, me qëllim zbulimin e hershëm të ndryshimeve cervikale dhe parandalimin e kancerit të qafës së mitrës.

Ky shërbim është mundësuar **falë bashkëpunimit të ngushtë të Komunës së Istogut me Spitalin e Përgjithshëm në Pejë**, i cili ka ofruar mbështetjen profesionale dhe teknike të nevojshme për realizimin e këtij procesi.

Ofrimi i PAP testit është integruar në kuadër të shërbimeve gjinekologjike dhe ka filluar që nga muaji Prill I vitit 2025, duke synuar rritjen e ndërgjegjësimit për parandalimin e kancerit të qafës së mitrës dhe përfshirjen aktive të grave në programe të rregullta të skringut.

Ky shërbim do të vazhdojë të zhvillohet më tej, me qëllim që të mbulojë një numër sa më të madh të grave në komunë.

Gjatë periudhës raportuese në QMF-Gurakoc, në Shërbimin Gjinekologjik në kuadër të vizitave gjinekologjike, janë realizuar këto PAP Test ekzaminime, të ndara sipas grupmoshave dhe muajve.

VITI I LINDJES	MOSHA	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NËNTOR	DHJETOR
Të lindura pas vitit 2000	< 24 vjeç				1		1	1		
Të lindura në vitet 1996-2000	25-29 vjeç		1			1			1	
Të lindura në vitet 1991-1995	30-34 vjeç	3	3	3	2		1		2	2
Të lindura në vitet 1986-1990	35-39 vjeç	6	5	6	2	1	2		2	3
Të lindura në vitet 1981-1985	40-44 vjeç	3	4	2	2	2	4	5	4	1
Të lindura në vitet 1976-1980	45-49 vjeç	3	7	6	2	5	2	9	9	2
Të lindura në vitet 1971-1975	50-54 vjeç	7	5	2	4	1		8	6	2
Të lindura në vitet 1970	55+ vjeç	10	12	5	3	2	4	3	1	3
TOTAL		32	37	24	16	12	14	26	25	13

VIZITAT PËR NËNA DHE FËMIJË (0-3 VJEÇ)

Në kuadër të kujdesit parësor dhe parandalues, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare ka vazhduar zbatimin e **programit të vizitave në shtëpi për nënat dhe fëmijët e moshës 0–3 vjeç**, me qëllim të ndjekjes së zhvillimit të hershëm të fëmijëve dhe përkrahjes së nënave në periudhën pas lindjes.

Vizitat realizohen nga **ekipet e kujdesit për Nëna dhe Fëmijë**, të cilat ofrojnë:

- **Vlerësim të përgjithshëm të gjendjes shëndetësore të nënës dhe fëmijës** pas lindjes;
- **Mbështetje dhe këshillim për ushqyerjen me gji**, higjienën, dhe kujdesin e përditshëm për foshnjat;
- **Ndjekjen e rritjes dhe zhvillimit psikomotor të fëmijëve** në mënyrë të strukturuar sipas protokolleve të kujdesit parësor;
- **Identifikimin e hershëm të faktorëve të rrezikut** për shëndetin fizik dhe mendor të nënës apo fëmijës;
- **Edukimin shëndetësor** në lidhje me vaksinimet, profilaksinë dhe shëndetin riprodhues;
- **Referimin e rasteve me nevoja specifike** drejt niveleve më të specializuara të kujdesit shëndetësor.

Programi përfshin vizita të rregullta në javët dhe muajt e parë pas lindjes, si dhe ndjekje periodike deri në moshën 3-vjeçare, sipas nevojës. Kjo qasje synon të promovojë shëndet të qëndrueshëm dhe të forcojë lidhjen ndërmjet familjes dhe shërbimeve shëndetësore.

Më poshtë gjeni edhe raportin e detajuar të vizitave të realizuara në teren, të ndarë sipas muajve.

REGJISTRIMI I VIZITAVE NË SHTËPI PËR GRA SHTATZËNA DHE FËMIJË 0-3 VJEÇ / 2025

Nr.	Komuna e Istogut	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Total
1	Numri i vizitave në shtëpi për fëmijët 0-3 vjeç	54	39	33	35	93	98	48	34	79	91	115		719
2	Numri i vizitave në shtëpi për shtatzëna	7	5	1	2	6	10	3	4	8	13	9		68
3	Numri total i vizitave në shtëpi të kryera	61	44	34	37	99	108	51	38	87	104	124	0	787
4	Nr. i fëmijëve vajza 0-3 vjeç të cilat janë vizituar për herë të parë	16	5	3	8	26	15	10	6	14	15	26		144
5	Nr. i fëmijëve djem 0-3 vjeç të cilët janë vizituar për herë të parë	16	6	7	5	14	19	8	7	12	16	21		51
6	Nr. total i fëmijëve 0-3 vjeç të cilët janë vizituar për herë të parë	32	11	10	13	40	34	18	13	26	31	47	0	275
7	Numri i vizitave të dyta për fëmijët 0-3 vjeç	12	7	6	8	21	18	14	5	19	23	21		154
8	Numri i vizitave të treta për fëmijët 0-3 vjeç	7	6	9	7	8	14	7	8	13	19	16		114
9	Numri i vizitave të katërta për fëmijët 0-3 vjeç	3	9	4	3	2	11	5	5	10	9	22		83
10	Numri i vizitave të pesta për fëmijët 0-3 vjeç	0	6	4	4	22	21	4	3	19	9	9		101
11	Nr. i fëmijëve të cilët kanë pranuar një vizitë shtëpiake brenda 3 ditëve të para pas lindjes	10	5	6	6	13	10	11	9	23	17	13		123
12	Numri i shtatzënave që janë vizituar për herë të parë	4	3	1	1	4	6	3	3	5	9	8		47
13	Numri i shtatzënave që kanë pranuar vizitën e dytë	3	2	0	2	2	4	0	1	3	4	1		22
14	Numri i fëmijëve 0-3 vjeç nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian që janë vizituar për herë të parë	2	0	2	1	6	8	0	3	8	5	4		39
15	Numri i grave shtatzëna nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian që janë vizituar për herë të parë	1	3	1	1	3	4	0	1	4	6	2		26
16	Numri i fëmijëve të referuar tek specialistët mjekësor nga ekipi i mjekësisë familjare	0	1	1	1	0	0	0	2	0	0	0		5
17	Numri i vizitave shitesë për fëmijë dhe shtatzëna (jashtë standardit të programit të vizitave në shtëpi)	0	0	1	1	1	2	0	0	0	0	0		5
18	Numri i baballarëve të përfshirë gjatë vizitave në shtëpi	12	7	3	9	28	13	9	9	25	16	27		158
19	Numri i rasteve sociale të identifikuar dhe të referuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0		0
20	Numri i rasteve të dhunës të identifikuar (nga observimi gjatë vizitës në shtëpi)	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0		0
21	Numri i fëmijëve të identifikuar me ngecje në zhvillim dhe të referuar (nga observimi gjatë vizitës në shtëpi)	0	0	0	1	0	2	0	0	0	0	1		4
22	Numri i infermierëve që janë angazhuar në zbatimin e vizitave në shtëpi	5	4	3	4	7	7	3	4	9	7	8		61

HEMODIALIZA

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) ofron **shërbim të rregullt të transportit për qytetarët që marrin trajtim me hemodializë** në Spitalin e Përgjithshëm të Pejës. Ky shërbim është organizuar me qëllim lehtësimin e qasjes në trajtim për pacientët me insuficiencë renale kronike dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre.

Transporti ofrohet **tri herë në javë**, konkretisht në ditët:

- **E martë,**
- **E enjte,**
- **E shtunë,**

dhe realizohet në **tri orare të ndryshme të nisjes**, sipas nevojave të pacientëve që ndjekin seancat e hemodializës:

- **Ora 06:00,**
- **Ora 11:30,**
- **Ora 16:00.**

Ky shërbim organizohet në bashkëpunim me ekipin përkatës të transportit të QKMF-së dhe në koordinim me Spitalin e Pejës, duke siguruar një qasje të sigurt, të rregullt dhe të përshtatur me oraret e terapive për pacientët.

Aktualisht janë 4 pacientë, të cilëve iu sigurohet transporti për në Repartin e Hemodializës.

BARNATORJA QËNDRORE E QKMF-së

Barnatorja qendrore e QKMF-së luan një rol kyç në funksionimin e shërbimeve shëndetësore, duke siguruar **furnizimin e të gjitha njësive përbërëse** (ambulancave, shërbimeve të mjekësisë familjare, urgjencës dhe patronazhës) me **terapi medikamentoze** dhe **material shpenzues mjekësor** të nevojshëm për ofrimin e kujdesit cilësor.

Përveç furnizimit të brendshëm, barnatorja ofron edhe:

- **Terapi për pacientët që paraqiten në QKMF**, sipas përshkrimeve mjekësore;
- **Shpërndarje të insulinës për qytetarët me diabet**, duke u siguruar që pacientët të kenë qasje të rregullt dhe të sigurt në këtë terapi jetike.

Furnizimi dhe shpërndarja kryhen në mënyrë të kontrolluar dhe të dokumentuar, në përputhje me protokollet standarde dhe udhëzimet e Ministrisë së Shëndetësisë, duke kontribuar në ruajtjen e vazhdimësisë së kujdesit dhe përdorimin racional të barnave.

RAPORTI I INSULINAVE

Nr.	Muajt	PACIENTAT	ANALOG INSULINE ME VEPRIM TE SHPEJTE (Novorapid)	ANALOG INSULINE ME VEPRIM TE ZGJATUR (Levemir)	ANALOG INSULINE BIFAZIKE ME VEPRIM TE MESEM DHE TE SHPEJTE (Novomix)	INSULINE ME VEPRIM TE SHKURTER insuline e tretshme (Gensulin R)	INSULINE BIFAZIKE ISOPHANE 25-30/70-75 (insuline e tretshme 25%- 30% + insuline isophane 70%-75%) (Gensulin M)	INSULINE ME VEPRIM TE NDERMJETEM insuline isophane (Bazal)
1	Janar	240	276	141	1001			
2	Shkurt	217	260	134	848			
3	Mars	229	271	151	895			
4	Prill	230	274	140	885			
5	Maj	241	263	152	961			
6	Qershor	223	241	138	886			
7	Korrik	231	273	147	919			
8	Gusht	213	257	153	808			
9	Shtator	226	247	135	879			
10	Tetor	236	263	165	890			
11	Nëntor	230	256	154	878			
12	Dhjetor							

VAKSINIMI DHE IMUNIZIMI

Shërbimi i vaksinimit dhe imunizimit ka funksionuar në mënyrë të vazhdueshme gjatë periudhës raportuese, në përputhje me kalendarin kombëtar të vaksinimit të aprovuar nga Ministria e Shëndetësisë. Ky shërbim është realizuar në kuadër të QKMF-së dhe ka përfshirë:

- **Vaksinimin e fëmijëve sipas skemës së paraparë të imunizimit (0–18 vjeç)**, duke përfshirë vaksinat kundër sëmundjeve ngjitëse si tuberkulozi, poliomieliti, difteria, tetanusi, hepatiti B, fruthi, parotiti, rubeola, etj.;
- **Vaksinimin e të rriturve në raste të veçanta**, përfshirë gratë shtatzëna, të moshuarit, dhe persona me sëmundje kronike, në përputhje me udhëzimet përkatëse;
- **Menaxhimin dhe ruajtjen e zinxhirit të ftohjes** për të garantuar cilësinë dhe efikasitetin e vaksinave;
- **Regjistrimin elektronik të vaksinimeve** në sistemin e informacionit shëndetësor, si dhe ndjekjen e fëmijëve me vakcina të vonuara ose të paplotësuara.

Vaksinimi dhe imunizimi ofrohet në QKMF-Istog dhe në katër QMF-të.

	Numri i vaksinave	Numri i shërbimeve
QKMF-Istog	6935	14067
QMF-Banjë	964	1886
QMF-Vrellë	1047	2085
QMF-Gurraç	1311	2687
QMF-Rakosh	627	1243
GJITHSEJ	10884	21968

Gjatë kësaj për të cilën po raportojmë, janë aplikuar gjithsej:

182- Serum AntiTetanic -për parandalimin e tetanosit

4- Serume AntiViperik-aplikohet pas kafshimit nga gjarpinjët

27-Vaksina AntiRabike- për **parandalimin e tërbimit (rabies)**, pas **kafshimit nga kafshë të dyshuara** për të qenë të infektuara

SHËNDETI MENDOR Në kuadër të QKMF-së, është funksional edhe shërbimi për **shëndetin mendor**, me qëllim të ofrimit të kujdesit psiko-social dhe profesional për individët me çrregullime mendore, emocionale apo vështirësi të tjera psikologjike.

Në këtë kuadër, **çdo të dytën javë viziton QKMF-në mjeku specialist neuropsikiatër**, i cili ofron:

- **Vlerësim dhe diagnozë të çrregullimeve mendore;**
- **Këshilla shëndetësore dhe psiko-edukative për pacientët dhe familjarët;**
- **Aplikim të psikoterapisë individuale**, në varësi të gjendjes dhe nevojës së pacientit;
- **Përshkrim të terapisë medikamentoze**, si dhe përcjellje të rregullt të gjendjes së pacientëve.

Ky shërbim synon të rrisë qasjen e qytetarëve në kujdesin për shëndetin mendor, të ulë stigmatizimin dhe të mundësojë trajtim të hershëm dhe të vazhdueshëm për ata që kanë nevojë.

Përmes buxhetit komunal është bërë furnizimi me ampulla **Halldol (Haloperidol)** dhe **Moditen (Fluphenazine)**, të cilat përdoren në trajtimin e çrregullimeve të shëndetit mendor. Këto barna antipsikotike ndihmojnë në stabilizimin e gjendjes psikike të pacientëve, duke ulur simptomat si agjitacioni, halucinacionet, deluzionet dhe sjelljet e pakontrolluara. Përdorimi i tyre kontribuon në

përmirësimin e funksionimit ditor të pacientëve, parandalimin e përkeqësimit të gjendjes shëndetësore dhe uljen e nevojës për hospitalizime të shpeshta.

I. AKTIVITETET E SHËNUARA PËR PROMOVIM SHËNDETËSORJ

anar, 2025 -Java e Ndërgjegjësimit të kancerit të qafës së mitrës, kemi shenuar me aktivitete dhe ligjerata me stafin dhe grupe të ndryshme të shoqërisë, me qëllim të vetëdijësimit për rëndësinë e prevenimit të hershëm të sëmundjes dhe rëndësinë e vaksinës HPV.

Prill, 2025-Java Botërore e Shëndetit, me aktivitete me fëmijet e Kopështit “Gëzimi Ynë” në Istog, ata realizuan vizitë në repartin pediatrik, ku morën këshilla për ruajtjen e shëndetit.

Maj, 2025-Java Evropiane e Imunizimit, e shënuar këtë javë me promovimin e vaksinimit si masë preventive e shumë sëmundjeve dhe vaksinimin e fëmijëve sipas vaksinave të kalendarit të rregullt.

12 Maj, 2025-Dita Botërore e Infermierisë, në qendrën e qytetit ishin ekipi me infermier nga QKMF, të cilët ofruan këshilla shëndetësore, matjen e glikemisë dhe tensionit arterial

17 Maj, 2025-Dita Botërore e Hipërtensionit, kemi organizuar aktivitet në qendrën e qytetit, matjen e tensionit arterial, ofrimin e këshillave rreth ushqyerjes dhe aktivitetit fizik për menaxhim të tensionit arterial.

31 Maj, 2025-Dita Botërore Pa Duhan, kemi shënuar fushatë vetëdijësuese me nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme, shpërndarjen e broshurave informative.

1-9 Gusht, 2025-Java Botërore e Gjdhënjes, me aktivitete me nëna gjdhënese dhe infermiere që punojnë me ekipet e kujdesit për Nëna dhe Fëmijë organizuam takim dhe fushatë vetëdijësuese për rëndësinë e ushqyerjes me qumësht gjiri.

12 Shtator, 2025- Dita Botërore e Ndhmës së Shpejtë: ekipi i shërbimit të urgjencës së QKMF-Istog në Gjimnazin “Haxhi Zeka” në Istog, ka mbajtur një aktivitet vetëdijësues për reagimin në rastet urgjente

24-30 Shtator, 2025-Java e ndërgjegjësimit për sëmundjet e zemrës: Në dy shkollat fillore në Istog dhe Vrellë janë mbajtur ligjerata vetëdijësuese me prindër për menaxhimin e hipërtensionit arterial dhe sëmundjet e zemrës.

Tetor, 2025- Java Botërore e Ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit: Janë mbajtur aktivitete dhe ligjerata vetëdijësuese me mësuesin e shkollave të Istogut, mbi parandalimin e kancerit të gjirit.

12 Nëntor, 2025-Dita Botërore e Diabetit: Është shënuar aktivitet në qendër të qytetit për ditën botërore të diabetit, qytetarëve iu është bërë matja e glikemisë dhe tensionit arterial, si dhe iu janë ofruar këshilla për ushqyeshmërinë, aktivitetin fizik dhe përdorimin e terapisë.

VIZITAT SISTEMATIKE NË SHKOLLAT

Qëllimi i vizitave sistematike në shkolla është të monitorohet dhe përmirësohet mirëqenia fizike dhe mendore e nxënësve, duke kontribuar në zhvillimin e tyre të shëndetshëm. Më konkretisht, vizitat sistematike kanë për qëllim:

1. **Zbulimin e hershëm të problemeve shëndetësore** – identifikohen çrregullime fizike, shqisore (si dëgjimi dhe shikimi), rritja jonormale apo sëmundje kronike.
2. **Monitorimin e rritjes dhe zhvillimit** – mjekët dhe infermierët shikojnë parametrat si pesha, gjatësia, dhe zhvillimi pubertal për të siguruar që fëmijët po rriten normalisht.

3. **Promovimin e shëndetit** – fëmijët dhe prindërit marrin këshilla për ushqyerjen e shëndetshme, higjienën, aktivitetin fizik dhe mënyrën e jetesës pa rreziqe (si duhani, droga, etj.).
4. Edukimi dhe promovimi i shëndetit oral

Gjatë muajit Maj të vitit 2025 kemi realizuar programin e vizitave sistematike në institucionet shkollore parafillore dhe fillore të mesme të ulët.

Në këtë program këtë vit janë angazhuar 7 specialist të mjekësisë familjare, 3 doktor të mjekësisë, 16 infermierë, 5 stomatolog dhe 6 asistentë të stomatologjisë. Ky program është realizuar në koordinim të plotë të drejtoratit për arsim në Komunën e Istogut.

PARTICIPIMI

Në kuadër të participimit të pacientëve përmes pagesave të vizitës dhe shërbimeve, deri në këtë periudhë është realizuar një shumë tota prej **53,733 €**.

DREJTORIA PËR EMERGJENCA, MBROJTJE DHE SHPËTIM
RAPORTI I PUNËS PËR PERIU DHËN JANAR-DHJETOR 2025

Lënda: Raport vjetor 2025

Në hartimin e këtij Raporti Vjetor, të drejtoratit për Emergjencë, Mbrojtje dhe Shpëtim jemi bazuar në punën tonë gjatë vitit 2025 të parapara nga detyrat dhe përgjegjësitë që na takojnë si dhe punë tjera shtesë nga fushëveprimtaria e Drejtorit të Emergjencave, Udhëheqësit të sektorit për Mbrojtje dhe Shpëtim, NJPZSH si dhe nga ana e Kryetarit të Komunës.

Ne si sektor bazuar edhe në përshkrimin e detyrave të punëve kemi qenë të angazhuar në kryerjen e detyrave dhe kërkesave të qytetarëve, ndaj stacionit të Policisë, ndaj institucioneve arsimore dhe institucionit shëndetësor, si dhe kemi intervenuar disa herë në fshatrat Osojan dhe Lubozhdë në kamerat e sigurisë që ndodhen në këto lokalitete. Gjatë këtij viti kemi filluar me projektin e kamerave të sigurisë në qytetën e Bajës dhe projekti do të vazhdojë edhe në vitin 2026.

Kontribut të veçantë kemi dhënë në hartimin e projekteve të sigurisë në Qytetin e Istogut.

Monitorimi dhe kontrolli i këtyre institucioneve është kryer nga monitoruesi i kamerave me qëllim të evidentimit të shkaqeve dhe prishjet eventuale në sistemin e kamerave ku janë realizuar edhe me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë, të organeve kompetente të institucioneve përkatëse të komunës. Mos percaktimi i mjeteve të parapara për mirëmbajtje të kamerave nga institucionet arsimore ka krijuar veshtësi në mirëmbajtjen e kamerave të Institucioneve arsimore me që është permbushur kontrata si vlerë edhe pse në kohë ka qenë ende valide.

Në kuadër të kompetencave mbikëqyrëse, kam bërë monitorimin e punës së organeve të projekteve të komunës. Nga ky aspekt së bashku me drejtorin, udhëheqësin e sektorit është realizuar projekti, paramasa dhe parallogaria, për tenderin:

- „Mirëmbajtja dhe zgjerimi i rrjetit të kamerave të sigurisë në komunën e Istogut” në vlerë prej 50.000.00€ për periudhën 2024-2025 .Gjatë vitit në qytetin e Istogut, në mirëmbajtje dhe zgjerim janë realizuar punimet në vlerë prej 20000€ nga operatori ekonomik „CimiElectronic” të monitoruar nga organi mbikëqyrës komunal, për të cilat janë hartuar raportet përkatëse dhe pagesa sipas faturës.
- Furnizimi me material ndërtimor për raste Emergjente në komunën e Istogut, në vlerë prej 17.000.00€ mbetja nga pjesa e realizuar për vitin 2024, nuk është realizuar si pasojë e neglizhencës të OE, andaj Drejtorati është detyruar ta shkëpus kontratën dhe të hapë tender të ri në vlerë prej 100.000,00€ për periudhën 2025/26 i cili për shkak të ankesës nga OE I ranguar si I dyti dhe mos shqyrtimi në kohë nga OSHP është anuluar , andaj kërkesat për material ndërtimor janë refuzuar.
- Servisimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve për zjarrfiksit vlera 10,000.00€
- Trajtimi, kastrimi dhe sterilizimi i qenëve endacak në vlerë prej 20.000.00€. Për periudhën 2025\27. Për vitin 2025 janë shpenzuar 1.000,00€ ndërsa vlera rreth 13.000,00€ është bartur të paguhet gjatë vitit 2026.
- Komision -Shqyrtimi i kërkesave të shumta për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera në komunën e Istogut. Dëmet nga Ngricat datë 07.04.2025 në bujqësi gjegjësisht në

pentari në vler prej 1.113.319,15€. Dëmet nga zjarret të muajit gusht 2025 në bujqësi në 24 prona kryesisht me grunaja janë të vlersuara 211.082,22€ dhe në gjashtë shtepi në vlerë 48.780,00€.
Dokumentacioni i dëmit nuk është procesuar në Komisionin qendror të dëmeve për shkak të mos votimit të Qeveris së Kosovës.

• Sektori i Emergjencave ka bashkëpunuar me Drejtorate në fazën e planifikimit buxhetor për vitin 2025 dhe ka kontribuar në planifikimin e projekteve që ndikojn në fatkeqsi natyrore me Drejtoratin e Bujqësis dhe Drejtoratin e SHP.

• Nga Drejtorati i Sherbimeve Publike është planifikuar dhe realizuar një projekte

1. Riparimi i rrugëve lokale te rendit të IV-të dhe sanimi i gjendjes nga vërshimet, në vlerë prej 98,000.00€,
2. Ndertimi i murit mbrojtës te Mulliri në Vrellë në vlerë prej 25,000.00€
3. Ndertimi i murit mbrojtës në Shushicë në vlerë prej 10,000.00€
4. Ndertimi I urave në Komunën e Istogut në vlerë prej 23,000.00€

• Nga Drejtorati i Bujqësis është planifikuar një projekt:

1. Mirëmbajtja i rruges malore

• Hapja dhe mirëmbajtja e këtyre rrugëve mundëson intervenimin më të shpejtë të NJPZSH më të shpejt në zjarret malore, por nuk është kryer, me që mjetet buxhetore të paraara janë terhjek nga permbaruesi per arsye të kontrates kolektive tëmësimdhënësve.

• Sipas Vendimit Nr.01-740/2024 për formimin e grupit punes për Plotsim ndryshimin e Vlersimit të Rrezikut që është baz për hartimin e Planit Operativ Emergjent, Drejtorati në bashkëpunim me Drejtorit-Sektoret ka punuar në në perpunimin e të dhënave të nevojshme që I posedon Administrata komunale, por kemi has në veshtersi në mbledhjen e të dhënave nga sector jashta Administrates komunale e që janë bazë e dokumentit, andaj jemi të obliguar që gjatë vitt 2026 të vazhdojm me hartimin e këti Plani.

• Plani në rast tërmeti është bërë vlersimi I objekteve kolektive dhe grumbullimi i shënimeve të familjeve që banojnë në ndërtesa shumë katshe, por që nuk është i plot sepse ka shumë bashkatdhetar që punojn dhe veprojn në Shtetet perendimore dhe na mungojn të dhënat e tyre. Megjithatë jemi në fazen e hartimit të planit për strehim dhe evakuim në rast rreziku. Janë evidentuar bodrumet e objekteve kolektive të cilat mund të modifikohen për strehim në raste të fatkeqsive natyrore gjegjësisht termetit.

• Po ashtu lidhur me hartimin e këtij plani problem në vazhdim paraqet mungesa e akteve normative dhe mungesa e hapësirave adekuate për strehim.

• Shefi i Sektorit për mbrojtje dhe shpëtim përpos detyrave në kuadër të sektorit është i angazhuar edhe në kuadër të Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi (EVSb-së), në organizimin e mbledhjeve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, komisioni për të zhdukur, Sherbimin Sprovues të Kosovës për monitorimin e të denuarve me punë në dobi të pergjithëshme për komunitetin.

• Zyrtarët e sektorit të Emergjencave, Mbrojtje dhe Shpëtim kanë qenë të angazhuar edhe pranë komisionit për vlerësimin e tenderëve, Verifikimin e punimeve etj.

Shqyrtimi i lëndëve të pranuar në terren për raste të ndryshme Emergjente: 247 kërkesa

86 të miratuara

149 të refuzuara

12 të anuluar

Kerkesat e anuluarat janë të qytetarve që kanë perserit kërkesen Brenda afatit ligjor për ti dhënë përgjigje, apo kur procedurat tenderuese kanë zgjatur dhe pala ka paraqit të njëjtën kërkesë për heren e dytë.

Në vijim bashkangjitur është edhe raporti i NjPZSH-së

Me gjithë numrin e vogël të personelit Shërbimi i Zjarrfikësve arrin, por me vështirësi ti mbuloi detyrat, megjithatë me këtë kapacitet efikasiteti nuk mund të kërkohej. Kur kësaj i shtohet edhe mosha e zjarrfikësve profesional atëherë nevoja për rritjen e stafit është primare sidomos edhe për 10 zjarrfikës për tu afuar norms Ligjore për numrin e banorve të Komunës. Në kapacitetet e reagimit gjithashtu ka ndikim edhe teknika e vjetërsuar që shpesh herë janë në defekte pikrisht në raste emergjente që ndikon në shpejtësinë dhe efikasitetin e intervenimit, gjithashtu kostoja e mirëmbajtjes së kesaj teknike është e lartë. Bazuar në këtë fakt ngritja e kapaciteteve si në burime njerzore poashtu edhe në teknik është e domosdoshme gjatë vitit 2026.

Gjatë këtij viti Shërbimi i Zjarrfikësve ka pasur 410 dalje (intervenime). Intervenimet më së miri paraqiten si në tabelën e mëposhtme.

PASQYTRA E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË ZJARREVE: JANAR - DHJETOR 2025

Realizimi I numrit te pergjithshem te daljeve ,struktura e zjarreve dhe int. tjera Janar-Dhjetor 2024												
2025	Nr.i përgj. i daljeve	Nr.i zjarreve	Nr. i Teknike	Nr.i shërbimeve	Aksidente rrugore	Vërshime	Të rrejsh	Të lënduar			Të vdek	
								zj.	qyt.	tot	zj.	qyt.
Janar	9	5	2	0	2	0	0	1	6	7	0	1
Shkurt	13	12	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0
Mars	31	27	1	3	0	0	0	0	0	0	0	0
Prill	11	8	1	2	0	0	0	0	0	0	0	0
Maj	11	8	0	2	1	0	0	0	0	0	0	0
Qershor	38	23	2	9	2	2	0	0	4	4	0	0
Korrik	87	73	1	13	0	0	0	0	0	0	0	0
Gusht	93	56	3	34	0	0	0	0	0	0	0	0
Shtator	68	29	3	36	0	0	0	0	0	0	0	0
Tetor	35	13	6	16	0	0	0	0	0	0	0	0
Nëntor	14	4	0	9	1	0	0	0	1	1	0	0
Dhjetor	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsejtë	410	258	19	125	6	2		1	11	12	0	1

Kjo Tabelë paraqet Strukturën e zjarreve

2024	Zjarrë në Objekte ndërtimore						Zjarrë në Objekte ekonomike				Zjarrë në Pajisje elektrike				Zjarrë në Sipërfaqe të hapura			
	Banesa / shtëpi	Objekte ndimse	Plevica - Shtalla	Objekte kolektive	Oxhaqe	Të tjera	Publike	Objekte Biznesi	Objekte Industriale	Të tjera	Pajisje elektrike	Pajisjet shpërndarëse	Gjeneratora	Të tjera	Mal	Bari i that	Sipërfaqe bujqësore	Të tjera
Janar	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	2	0	0	0	0	0	0	2
Shkurt	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0	2	6	0	2	
Mars	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0	6	10	0	7	
Prill	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3	0	0	0	2	0	2	
Maj	0	1	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0	0	1	2	0	3	
Qershor	0	1	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0	0	2	8	3	7	
Korrik	6	2	0	0	0	0	0	0	0	1	6	0	0	6	36	7	10	
Gusht	2	2	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	7	32	1	11	
Shtator	1	2	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0	12	9	0	4	
Tetor	1	0	0	0	0	0	0	1	0	0	1	0	0	0	7	0	2	
Nëntor	0	0	0	0	1	0	0	0	0	2	1	0	0	0	0	0	0	
Dhjetor																		
Gjithsejtë	13	8	1	0	2	0	0	1	0	0	5	16	0	0	36	112	11	50

Gjendja e autoteknikës është funksionale deri me tani, duhet kryer servisimi periodike i tyre si dhe pajisjeve perçjellese. Sherbimi i zjarrfikësve ka nevojë për momentin për blerjen e pompave të shpinës për sezonin e verës. Ka nevojë që një pjesë e tubacionit sintetik të ndrohet për shkak të vjetërsisë.

Nga rastet e zjarreve të cekura më lartë 5 raste janë objekte banimi.

Forma tabelare e rasteve t zjarreve për te cilat janë punuar raportet përkatëse dhe është bërë vendshikimi e rastit, 2025, gjithsejt jan punuar 58 raporte.

Nr, data.	Pronari , adresa	Shtëpi / biznes	Obj. percjellëse	Te tjera (ushqim bagëtije dru prod.bujq. vetura), etj.	Shkak i zjarrit.	Dëmet
Date : 24.01. 2025 Nr: 001/ '25	Afrim Ramush Abazaj nga fshati Mojstir dhe Sali Osman Shoshi nga fshati Kashicë		Stane ne bjeshken e Radushes, 2 stane	/	Zjarrvënije	
Date : 04.02. 2025 Nr: 002/ '25	Enver Halil Dreshaj. rruga; „Naim Dreshaj”, nr: 18, Vrellë		Aneks shtepije, dhomë verore		Oxhaku i improvizuar,	Orendi ne dhomë e kapluar nga zjarri
Date : 10.02. 2025 Nr: 003/ '25	Mirsad (Feriz) Kelmendit, rruga Hajriz Metaj Rakosh			Pemishte, fidane kumbullash	Zjarrvënije	Fidane, sisteme pikë-pikë I
Date : 02.03. 2025 Nr: 004/ '25	Diamant Begjamine Shatri,rruga Deshmorët e Kombit, Tomoc			Livadh I papunuar, dhe pemishte molle	Zjarrë I shkaktuar nga djegëja e mbetjeve; neglizhimi I zjarrit	Fidane per
Date : 11.03. 2025 Nr: 005/ '25	Polanë, malor-fushorë, pronë e perzier			Fushorë - Malorë	Faktori njeri, Me qellim te pastrimit te livadheve te pakosituar nga viti paraprak	Dëme ne floka dhe faunen
Date : 11.03.	Branisllav Simonoviq			Pemishte	Faktori njeri,	Fidane per

2025 Nr: 006/ '25	Llukafc i Thatë			Fushorë malorë		
Date : 11.03. 2025 Nr: 007/ '25	Mehdi Osman Brahimaj, fshati Kashicë			Mexhë me masë drunore	Faktori njeri,	Nexhë dhe d
Date : 11.03. 2025 Nr: 008/ '25	Nadire Loxhaj Baicë, rruga „Lidhja e Pejës”			Pemishte Zjarrë fushorë	Faktori njeri, ndezje e livadheve te pakositura.	Pemishte dh livadh
Date : 27.03. 2025 Nr: 009/ '25	Artan Haxhi Selmanaj rruga Pishat nr; 63. Istog	Shtëpi, dhoma e kontrollit,			Deshtim ne instalim, shtëpi me instalime Smart.	Instalime ne shtëpi
Date : 26.05. 2025 Nr: 010/ '25	Granit Pacaj, Prekallë, rruga Lidhja e Pejës			Ushqim bagëti	Moskujdesi i vet pronarit,	Pastrim mbeturinash
Date : 26.05. 2025 Nr: 011/ '25	Shkelzen Sejdiqaj, rrugen Ali Fethau në Istog		Objekt percjelles (saunë verore)		Moskujdesi i vet pronarit,	Kamina e nd dhe qyngat n kontakt me n drunore
Date : 12.06. 2025 Nr: 012/ '25	Kosovë Rexhaj			Traktor	Problem me instalimet ne traktor	I tërë traktor
Date : 12.06. 2025 Nr: 013/ '25	Adem (Isa) Hajdaraj e Shushicë e Ulët , rruga Ali Demi nr 79	Shtëpi banimi, një dhomë			Dyshohet te jet shkaktuar nga nje adapter.	Dhoma me c dritaret dera nxierja e hap
Date : 17.06. 2025 Nr: 014/ '25	Fadil Berisha Dobrushë, rruga Lidhja e Pejës			Grunajë, rreth 10 ari	Kabllo e vazhduara per furnizim te pompes ne bunarë	Rreth 10 ari
Date : 17.06. 2025 Nr: 015/ '25	Xhevat Ramiz Kelmendit, Dubovë e Vogël, rruga Driloni nr: 37		Objekt përcjellës, garazh dhe dhomë vere		Moskujdesi njerëzor, harres e ndonje mjeti qe ka shkaktuar	E tërë garazh gjesendet dh orenditë për

					zjarr dyshohet ne nje poq elektrik, dhe inst I improvizuar	
Date : 03.07. 2025 Nr: 016/ '25	Gurrakoc, rruga Lidhja e Pejës,			Zjarrë i hapur	Rrjeti elektrik furnizues I lagjes , era	
Date : 03.07. 2025 Nr: 017/ '25	Xhevdet Shoshit Kashicë rruga 8 Maji			grunajë, mbi 1(një) ha Zjarrë i hapur fushorë	Dyshohet në zjarrvënije	
Date : 03.07. 2025 Nr: 018/ '25	Dubravë rruga Spanja			Zjarrë i hapur fushorë	Dyshohet se është shkaktuar nga rrjeti elektrik I lagjes	sipërfaqëja e livadheve, grunajës se c pombë fruto shtylla elekt
Date : 04.07. 2025 Nr: 019/ '25	Radoje Pumpallovij Dubravë, rruga Brahim Hasani			Zjarrë i hapur	Dyshohet ne zjarrvënije , ndezje e mbeturinave	grunajë rreth
Date : 04.07. 2025 Nr: 020/ '25	Ahmet Rexhaj. Tomoc,rruga Krasniqja			Zjarrë i hapur	Dyshgohet zjarrvënije	grunajë, 0,5
Date : 04.07. 2025 Nr: 021/ '25	Burgun e Dubraves			Zjarrë i hapur	Puna me kosë te traktorit	Livadhe
Date : 09 .07. 2025 Nr: 022-1/ '25	Llukafc i That, Kovragë, Dubravë.			Zjarrë i hapur	Dyshohet se ka filluar ne Llukafc te thatë nga rrjeti elektrik I perkrahur nga era	Siprfaqe me grunaja, liva dhe pyje, një shtepi dhe n object përcje
Date : 09 .07. 2025	Llukafc i That, shepinë e Ivko	Shtepi			Dyshohet nga rrjeti elektrik	Shtepija

Nr: 022-1/ '25	Mishiq.					
Date : 09 .07. 2025	Dragan Gjuriq, rruga: Nikolla Tesla, Osojan	Shjtepi			Dyshohet nga rrjeti elektrik	Shtepija
Nr: 022-2/ '25						
Date : 09 .07. 2025	Sllavisha Peroviq, Bllagaq,rruga: Ballkani nr 53.	Shtepi			Dyshohet nga rrjeti elektrik	Shtepija
Nr: 022-3/ '25						
Date : 09 .07. 2025	Dragan Repanoviq, nga Osojani , rr Mihajl Pupin	Shtepi			Dyshohet nga rrjeti elektrik	Shtepija
Nr: 022-4/ '25						
Date : 09.07. 2025	Ljubisav Popoviq Shalinovicë, udhëkryqi i rrugëve Nikolla Tesla			Zjarrë i hapur		grunajë me sipërfaqe rre 2ha
Nr: 023/ '25						
Date : 09.07. 2025	Zallq, lagjësja e Romëve			Zjarrë i hapur	Djegije e mbeturinave	Zjarri është përhapur në grunaja
Nr: 024/ '25						
Date : 14.07. 2025	Halil Hysenaj në fshatin Uçë			Zjarrë i hapur	Problem me kombajen	rreth 30 ari grunajë, dhe kombaji
Nr: 025/ '25						
Date : 14.07. 2025	Shefqet Dreshaj në fshatin Orroberdë			Zjarrë i hapur	Dyshohet ne zjarrvenije	Humullishte dhe livadhe
Nr: 027/ '25						
Date : 14.07. 2025	Varrezat serbe ne Dragolec			Zjarr i hapur	Dyshohet zjarrvenije ka ardhur si pasoje e ndezjes se humullishteve	Mal ne varre
Nr: 027/ '25						
Date : 21.07. 2025	Jozef Frrokaj, nga Koshi. rruga Gjergj Frroku, nr 40		Object përcjellës		zjarri është shkaktuar nga ngacmimi i rrjetit elektrik	Objekti përd me kulm dhe orenditë mbr
Nr: 028 / '25						

					nga brejtësit	
Date : 23.07. 2025 Nr: 029 / '25	Ramë Gusturanaj, Lagjësja gusturanaj			Zjarrë i hapur	Pasojë e harreses se zjarrit nga pjekja e nje flije	Barishte
Date : 23.07. 2025 Nr: 030 / '25	Rruga Daut Zagraxha Banjë			Zjarrë i hapur	Dyshohet zjarrvënije	livadhi i pak dhe vende duket se ka mbeturina sipërfaqe 0,5ha.
Date : 23.07. 2025 Nr: 031 / '25	Veriq, Kovragë dhe Dubravë			Zjarrë i hapur	Dyshohet zjarrvënije	sipërfaqe përbërë nga mexha, frutore, humullishte livadhe pakositura
Date : 25.08. 2025 Nr: 031-1 / '25	Firma Agroprodukt ka pësuar dëme në instalime te ujitjes, respektivisht në paisje te modeleve te fundit te menqura (Smart) për ujitje te automatizuar			Zjarrë i hapur	Dyshohet në zjarrvënije	paisjet e automatizuar tipit Smart të firmes Agroprodukt ujitje
Date : 28.07. 2025 Nr: 032 / '25	Dobrushë, rruga Rusolija			Zjarrë i hapur	Dyshohet nga rrejtji elektrik	janë djegur sipërfaqe te pyjeve, mex livadheve dhe humullishteve dhe dy objekte familjes Nik
Date : 28.07. 2025 Nr: 033 / '25	Sherif Ramqaj Banjë, rruga Lidhja e Pejës nr 862	Shtepi			Zjarri është shkaktuar nga oxhaku I furrës se bukës	Është djegur sipërm me kulmin, instalime dhe orenditë përkatëse.

Date : 29.07.2025 Nr: 034 / '25	Burbuqe Curraj Llukafc i Begut, rruga Azem Shkreli			Zjarrë i hapur	Dyshohet se janë ndezur mbeturina në afërsi	Mexhë livadhe dhe fidane pemesh
Date : 29.07.2025 Nr: 035 / '25	Gazmir Shoshi Dobrushë			Zjarrë i hapur	Nuk dihen, dyshohet në zjarrvënije	sipërfaqe me fidane të ndryshme pemesh, si dhe barishte
Date : 07.08.2025 Nr: 036 / '25	Zenel Rugova. Saradran, rruga: Drini i Bardhë		Puntori me vegla për dritare plastike etj		Nuk dihen shkaqet	Puntorija me vegleri dhe për bujqësore
Date : 08.08.2025 Nr: 037 / '25	Butrint Sadikaj Ne rrugen Burimi në Istog		Objekt përcjellës, garazhë		Fqinji ka ndezë mbetjet bari dhe zjarri është përhapur	Djegur struktura kulmi dhe dru
Date : 11.08.2025 Nr: 038 / '25	Naser Hajzeraj Uçë, rruga: Col Bajraktari		Objekt përcjellës lloji i një strehimoreje për dru		shkaku i vertetë i zjarrit nuk dihet	rrethoja dhe koqatqë për dru për djegje dhe sera
Date : 12.08.2025 Nr: 039 / '25	Shalinovicë, rruga: Gurina			Zjarrë i hapur	Dyshohet në rrjetin furnizues të fshatit I përkratur nga era	sipërfaqe konsiderueshme me fidane a livadhe, në humullishte pyje bungu.
Date : 14.08.2025 Nr: 040 / '25	Haki Smajl Rexhaj Katun i Ri, rruga „11 Maji”, nr: 231		Objekt përcjellës, garazhe puntori		Dyshohet në zjarrvënije	Vetura dhe veturë te puntorisë
Date : 18.08.2025 Nr: 041 / '25	Vitomericë Pejë Rr, Ismajl Nikoqeviq, Mustafë Hasangjekaj dhe, Sylejman Paqarrizi.			Zjarrë i hapur	Dyshohet në zjarrvënije	Barishte me rrjet elektrik

Date : 18.08.2025 Nr: 042 / '25	Xhevat Bajramaj Gurrakoc, rruga: Smajl Kabashi, nr 60		Objekt percjellës, makineri bujqesore dhe ushqim bagetije	Zjarrë i hapur	Dyshohet në zjarrvënije	ushqim bagë teknikë bujq si dhe në obj percjellëse s shtallë bagët dhe depo drithërash et
Date : 18.08.2025 Nr: 043 / '25	Mustafë Ademaj Katuni i Ri rruga Riza Aliu			Vendpunishte me hekurishte dhe plastikë	Shkak makinerija e selektimit dhe bluarjes se mbeturinave	Pjesërisht makinerija, s
Date : 18.08.2025 Nr: 044 / '25	Granit Kelmendit fshati Ruhot			Zjarrë i hapur	Zjarrvënije	Mal I rritur d ruajtur mirë
Date : 20.08.2025 Nr: 045 / '25	Muhamet Madanaj Saradran, rruga „Drini i Bardhë”.			Zjarrë i hapur, ushqim bagëtije	dyshohet të jet zjarrvënije	janë djegur n 15 rrotoballa ushqim bagë
Date : 20.08.2025 Nr: 046 / '25	Zallq rruga „24Qershori”			Zjarrë i hapur	Dyshohet ne zjarrvënije	humullishtes pylli në lug t humullishtes pembë dhe mbeturina af shtepive në a lindore
Date : 22.08.2025 Nr: 047 / '25	Zekë Osmanaj Trubuhovc, rruga „Idriz Osmanaj” nr:3	Shtepi			zjarri ka ardhë për shkak të përdorimit të paisjes elektrike (tupanit) për përgaditjen e ushqimit, në hapsirat e mbrendeshme	Një dhomë n orendi dhe instalime përkatëse
Date : 23.08.2025 Nr: 048 / '25	Prekallë, rruga „Imer Osmanaj”.			Zjarrë i hapur	Dyshohet zjarrvënije	sipërfaqe me barishte, me dhe mal

Date : 28.08.2025 Nr: 049 / '25	Lubozhdë, rruga „24 Marsi” nr:189		Object I përbashket I fshatit		Zjarrvënije	Orendi dhe c te objektit
Date : 02.09.2025 Nr: 050 / '25	Lagjen Kurtaj, Istog i poshtem			Zjarrë i hapur	Dyshohet zjarrvënije	mexhë, mbe dhe humullis
Date : 03.09.2025 Nr: 051 / '25	Orroberdë, rruga Faik Konica			Zjarrë i hapur	Dyshohet zjarrvënije	humullishte, mexhë, pem mal dhe një i rrënuar
Date : 04.09.2025 Nr: 052 / '25	Rakosh, Rruga Lajthijat			Zjarrë i hapur	Dyshohet zjarrvënije	fidane lajthis rreth 2ha, humullishte barishte
Date : 12.09.2025 Nr: 053 / '25	Bellopojë, rruga „17 shkurti”			Zjarrë i hapur	Dyshohet zjarrvënije	barishte te (humullishte i dushkut rritur.
Date : 12.09.2025 Nr: 054 / '25	Gusarë			Zjarrë i hapur	Dyshohet ne zjarrvënije	barishte te th humullishte, dhe mexha
Date : 18.09.2025 Nr: 055 / '25	Azem Mexhedoviq Llukafc i Begut, rruga „Sarajeva		Object përcjellës, kuzhinë verore		Zjarri është pasojë e harresës se furrës te ndezur për qellime te përgadithes së ushqimit apo nevoja tjera.	Orendi dhe instalim ne c
Date : 22.09.2025 Nr: 056 / '25	Vrellë , veshtijet.			Zjarrë i hapur	Dyshohet zjarrvënije	Mal në vesh te vrellës

Date :25.09.2025 Nr: 057 / '25	Kerrninë			Zjarrë i hapur	Dyshohet ne zjarrvënije	mal, tuba dru te rralluara dhe barishte
Date : 02.10 2025 Nr: 058 / '25	Muhamet Ibish Sylaj rruga ,, Tahir Beka: nr 60	Shtepi			Dyshohet ne luhatje te tensionit fuenizues	është djegur hapsira nënk ku jan 3(tre) dhoma, koric dhe banjoja gjith instalim
Date : 27.10 2025 Nr: 059 / '25	Mirlinda Kika		Veturë (Audi)		Problem me instalim	vetura ka pë dëmtime te konsideruesh

Nga tabela e mesiperme raporteve te zjarreve kemi ;

1. Shtepi banimi : 9, nga te cilat 4 shtepi jan djegur terësisht si pasoj e zjarreve fushore, Osojan dhe Bllagaq, një rast kati dhe kulmi në Banjë, dhe kulmi i një shtepije në Studenicë. Rastet tjera ka dëme te pjesëshme në dhoma etj...,
2. Objekte percjellse; 12
(garazha puntori e ahure bagetishë)
3. Ushqim bagëtije :3
4. Pemishte : 5
5. Fushoro malore : 26
6. Stane : 2
7. Vetura : 1
8. Traktor : 1

Nje mori e rasteve te zjarreve ne objekte percjellese kan ardh nga zjarret fushore .

Shtirja e rasteve te zjarreve :

Dominon ne masen mbi 70% ana jugore dhe juglindore e komunes sonë, sidomos zjarret sezonale, gjat verës.

Inspektime jan kryer ne objekte te banimit në bashkësi dhe në institucionet edukativo-arsimore te komunws sonw, tabelen e inspektimeve dhe gjendjen mund ta siguroni nga Zyrtari Abedin Idrizaj

DREJTORIA PER PUNE DHE MIREQENIE SOCIALE
RAPORTI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2025

Gjatë periudhës Janar – Qershor 2025, Drejtoria e Mirëqenies Sociale ka luajtur një rol kyç në përballjen me sfidat sociale që prekin komunitetet tona. Në një kohë kur nevojat sociale janë në rritje, kemi punuar me përkushtim për të ofruar shërbime të qëndrueshme, efikase dhe të orientuara drejt përmirësimit real të jetës së qytetarëve në nevojë.

Ky raport pasqyron punën intensive të ekipit tonë, arritjet konkrete dhe pengesat që kemi hasur gjatë kësaj periudhe, si dhe masat e ndërmarra për të adresuar këto sfida. Synimi ynë është të vazhdojmë të forcojmë kapacitetet dhe të avancojmë strategjitë e mirëqenies sociale, duke kontribuar në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe më solidaritet.

Gjatë periudhës Janar-Qershor, në Drejtorinë e Mirëqenies Sociale të Komunës së Istogut janë pranuar rreth 260 kërkesa me karakter social. Stafit është angazhuar maksimalisht për t'u përgjigjur këtyre kërkesave në mënyrë të drejtë dhe të barabartë, duke u mbështetur në mundësitë që ofron buxheti i disponueshëm.

- Ofrimi i shërbimeve logopedike dhe psikologjike të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe sociale
Ofrimi i shërbimeve logopedike , psikologjike dhe sociale të fëmijëve me nevoja të veçanta është një proces gjithëpërfshirës dhe shumëdimensional që synon mbështetjen e zhvillimit të tyre dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.

Drejtorja e Mirëqenies Sociale , është përfutuese e projektit “ SORI3” , iniciativa kryesore e këtij projekti është dedikimi për të promovuar përfshirjen sociale dhe ekonomike të grupeve të cenushme . Përfutuesit kryesor janë: Personat me aftësi të kufizuara, Gratë në situata të vështira ekonomike dhe Sociale dhe Grupet e Margjinalizuara .

- Qendra e qendrimit ditor për pensionistët në Istog

Qendra e qendrimit ditor për pensionistët në Istog ofron një hapësirë të dedikuar për të moshuarit, ku organizohen aktivitete të ndryshme sociale, kulturore dhe rekreative. Kjo qendër ka një rëndësi të veçantë për komunitetin, pasi u mundëson pensionistëve të kalojnë kohën në mënyrë aktive, të shoqërohen me njëri-tjetrin dhe të ndihen të vlerësuar. Aktivitetet e organizuara ndihmojnë në ruajtjen e shëndetit mendor dhe fizik të pjesëmarrësve, duke përmirësuar cilësinë e jetës së tyre.

- Subvencionimi i Shtëpisë së Sigurtë në vlerë prej 4.000 euro.
-

Femrat që përjetojnë dhunë në familje strehohen për një periudhë të caktuar në strehimoren në Pejë. Drejtoria e Mirëqenies Sociale siguron subvencion vjetor në vlerë prej 4,000 €, me qëllim mbështetjen dhe sigurimin e kushteve të nevojshme për qëndrimin e tyre.

- Subvencionimi i Familjeve Strehuse

Me qëllim ruajtjen dhe trajtimin adekuat të familjeve strehuse, Drejtoria e Mirëqenies Sociale ka subvencionuar tre familje strehuse. Këto familje kanë qenë gjithashtu me prioritet në mbështetjet e tjera që kemi ofruar për qytetarët e komunës së Istogut.

- Subvencionimi i nënave vetëushqyese në vleren prej 200€

Qëllimi kryesor i subvencionimit është përmirësimi i kushteve ekonomike dhe sociale, si dhe fuqizimi i këtyre nënave për t'u përballur më mirë me sfidat e përditshme.

- Realizimi i pagesave të qerasë

Aktualisht, kemi mbi 10 pagesa qeraje për familjet në kushte të rënda ekonomike, duke iu dhënë përparësi femrave që përjetojnë dhunë në familje, në përputhje me Planin Trevjeçar të Banimit Social.

- Shpërndarja e pakove ushqimore

Drejtoria e Mirëqenies Sociale ka shpërndarë rreth 400 pako ushqimore dhe higjienike për familjet që gjenden në kushte të vështira ekonomike, me qëllim mbështetjen e tyre në përballimin e nevojave bazë.

- Inspektimet javore në Shtëpinë e të Moshuarve në Gurrakoc.

Një praktikë shumë e rëndësishme për të siguruar cilësinë e kujdesit dhe mirëqenien e rezidentëve janë inspektimet javore në shtëpinë e të moshuarve. Këto inspektime synojnë që të mbikqyrin standartet e shërbimeve, të adresojnë sfidat dhe të promovojnë një mjedis të sigurtë dhe të përshtatshëm për të moshuarit.

- Plani strategjik për përfshirje Sociale të fëmijëve me aftësi të kufizuara

Aktualisht ndodhemi në fazat përfundimtare të hartimit të Planit Strategjik për Përfshirjen Sociale të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara. Ky plan synon të ofrojë masa konkrete për përfshirjen e barabartë dhe mbështetjen e plotë të kësaj kategorie në jetën shoqërore dhe institucionale.

- Përmirësimi i lëvizshmërisë dhe jetës së përditshme për personat e moshuar

Në kuadër të përkushtimit për kujdesin dhe përfshirjen sociale të personave të moshuar, kemi ndërmarrë iniciativa konkrete për përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre. Gjatë kësaj periudhe, kemi furnizuar disa qytetarë të moshuar me karroca elektrike, duke u mundësuar atyre lëvizshmëri më të lehtë dhe më të pavarur. Po ashtu, janë shpërndarë edhe veshmbathje të nevojshme, si pjesë e mbështetjes së drejtpërdrejtë

për ta. Këto veprime janë realizuar në bashkëpunim me donatorë dhe përmes planifikimit të kujdesshëm të burimeve të Drejtorisë për Mirëqenie Sociale. e të Moshuarve në Gurrakoc.

QENDRA PËR PUNË SOCIALE – ISTOG

Raporti Gjashtëmujor Janar - Qershor 2025 të Ekipit për të Drejtat e Fëmijës

1.1 Në kuadër të shërbimeve sociale Qendra për Punë Sociale ofron shërbime të ndryshme për kategoritë si në vijim:

- Fëmijë i braktisur
- Fëmijë jetim
- Fëmijët e prindërve të privuar nga e drejta prindore
- Fëmijët me aftësi të kufizuara
- Fëmijët e prindërve të shkurorëzuar apo të ndarë
- Fëmijët e keqtrajtuar
- Fëmijët në punë
- Martesa e të miturve
- Fëmijët me sjellje asociale
- Delikuentë të mitur
- Përdorues të substancave narkotike
- Trafikimi i qenieve njerzore
- Dhuna në familje
- Regjistrim i mëvonshëm i fëmijëve

Në kuadër të Qendrës për Punë Sociale bëhen shërbime për të gjitha kategoritë e fëmijëve të cilat i kanë nevojat e ndryshme sipas kategorive të ndryshme.

Puna fillon me identifikimin e nevojave të fëmijëve e gjithmonë nëse fëmija kanë familje, në bashkëpunim me familjet e tyre si dhe me institucionet tjera të cilat punojnë me fëmijë.

Pas identifikimit të nevojave punohet me plotësimin e tyre me shërbimet e ndryshme të cilat ofrohen tek ne si, strehimi i fëmijëve, adoptimi, regjistrimi i tyre, kujdestaria, mbikqyrja dhe realizimi i kontaktimeve në mes fëmijëve dhe prindërve, përfaqësimi në Gjykatë, këshillimi psikosocial, këshillimi ligjor, ofrimi i ndihmave sociale si dhe ndihmave emergjente, etj dhe gjitha këto shërbime për interesin më të mirë të fëmijës.

1.2 Komuna e Istogut fatmirsisht i ka përmbushur standardet minimale dhe ka arritur të ketë gjithsej 3 familje strehuese të cilat që të trija për momentin kanë 11 fëmijë të strehuar. Gjatë këtij gjashtëmujori nuk kemi pasur asnjë fëmijë të braktisur. Në vazhdimësi kemi realizuar vizita në familje për të monitoruar kujdesin që i'u ofrohet fëmijëve të strehuar aty.

Për nder të ditës së Familjes kemi vizituar familjet me që rast iu kemi dërguar nga një pako ushqimore në shenjë përkrahje si dhe është mbajtur Tryeza në bashkëpunim me Drejtorinë e Mirëqenies Sociale, Drejtorinë e Administratës Publike - Sektorin e Barazisë Gjinore dhe Familjet Strehuese. Nga Komuna e Istogut, familjet strehuese kanë përkrahje të vazhdueshme në forma të ndryshme.

1.3 Në muajin Mars, nga Shkolla Fillore “Bajram Curri” jemi informuar për 8 raste të braktisjes së shkollës. Si organ i Kujdestarisë, jemi marrë me rastin dhe kemi vizituar familjet e fëmijëve të cilët kanë braktisur shkollën për arsye të ndryshme e kryesisht nga gjendja e dobët ekonomike.

1.4 Nga Gjykata kemi pranuar 29 raste të mitur delikuentë, të përfshirë në Kundërvajtje në komunikacion, për të cilët Gjykata nga ne kërkon që t’i realizojmë raportin social. Ne ju jemi përgjigjur pozitivisht kërkesave të pranuar duke realizuar takimet me të miturit dhe prindërit e tyre dhe i kemi dorëzuar Raportet Sociale në Gjykatë.

1.5 Gjatë gjashtëmuajorit të parë të vitit 2025 kemi qenë të pranishëm në 21 raste tek të miturit me sjellje asociale gjatë marrjes në pyetje në Stacion Policor të cilëve i’u ofrojmë këshillim psiko-social.

1.6 Në periudhen Janar-Qeshor kemi pranuar 10 raste të reja të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara. Kemi realizuar gjithsej 64 vizita tek të gjitha familjet e fëmijëve të cilët janë përfitues të Ndhmës Materiale për Familjet me Fëmijë me Aftësi të Kufizuar të Përhershme.

1.7 Kemi proceduar me rastin e dy fëmijëve të paregjistruar ku kemi realizuar vizitë në Shërbimin Sprovues Korrektues në Dubravë tek babai i fëmijëve për të marrë deklaratë lidhur me pranimin e atësisë.

1.8 Në Qendrën për Punë Sociale kemi 9 fëmijë të cilët realizojnë kontaktimet me prindin me të cilin nuk jetojnë në bazë

Institucioni i Qendrës për Punë Sociale në kuadër të Drejtoratit për Mirëqenie Sociale të Komunës së Istogut, gjegjësisht sektori i Shërbimeve Sociale ka ofruar shërbime për qytetarë të kategorive të ndryshme, drejtëpërdrejtë si dhe me aktivitete të shumta duke bashkëpunuar me zingjirin e institucioneve, të cilat e kanë objektiv mirëqenien e fëmijëve, të rriturve si dhe të moshuarve.

Pergjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2025 llojet e shërbimeve që janë ofruar nga sektori i Shërbimeve Sociale janë të shumta dhe ne gjithmonë jemi në dispozicion, duke përfshirë edhe Organin e Kujdestarisë i cili është 24 orë nën shërbimin e qytetarëve në nevojë.

Në tabelën në vijim janë të paraqitura shërbimet dhe numri total për secilën nga to si dhe përshkrimi i Shërbimeve të ofruara.

	Lloji i shërbimit	Numri i rasteve	Përshkrimi i Shërbimeve të ofruara në sektorin e Shërbimeve Sociale
1	Fëmijë të braktisur	0	<i>Përcaktimi i kujdestarit ligjor, vendosja në strehim familjar, ndihmat e përgjithshme për familjet strehuese dhe për fëmijet.</i>
2	Adoptim	0	<i>Adoptimi është një aspekt i mbrojtjes së fëmijës, vlerësimi i familjës për adoptim dhe monitorimi fazës paraadoptuese.</i>
3	Keqtrajtim i fëmijës	0	<i>Keshillim psiko-social me familje</i>
4	Strehim familjar tek familja strehuese	4	<i>Ofrimi i strehimit fëmijëve të braktisur dhe të lënë pas dore dhe percjellja e trajtimit të fëmijëve në familje strehuese.</i>
5	Strehim familjar tek të afërmit	6	<i>Ofrim i strehimit tek familja e gjerë dhe percjellja e zhvillimit dhe trajtimit të tyre.</i>
6	Kujdestaria për të mitur	5	<i>Fëmija pa kujdes prindëror duhet të ketë një kujdestar ligjor.</i>
7	Fëmijë me aftësi të kufizuar të plotë (FAKP)	9	<i>Kompletimi i dokumentacionit, pas vleresimit të komisionit mjekësor percjelllet mundësimi i marrjes së pagesës perkatëse si dhe monitorimi i Qendrës Ditore për FAKP dhe udhëzimet e nevojshme.</i>
8	Braktisje e shkollës	8	<i>Bashkëpunimi me shkolla, me prindër me fëmijë si dhe këshillime</i>

			<i>për të gjitha keto ne interes me të mirë të fëmijëve.</i>
9	Fëmijë me vështirësi në sjellje	0	<i>Këshillime psiko-sociale, të miturit gjithashtu.</i>
10	Të miturit në konflikt me ligjin	29	<i>Këshillim dhe ofrim i shërbimit perkatës për referim në institucionet relevante.</i>
11	Martesa e të miturëve	0	<i>Vlerësimi i pjekurisë emocionale të të miturëve të cilët deshirojnë të hyjnë në martesë si dhe referimi në institucionet tjera.</i>
12	Ikje nga shtëpia	0	<i>Këshillim psiko-social dhe bashkim familjar dhe përcjellja e zhvillimit të përgjithshëm të të miturit.</i>
13	Këshilla martesore	2	<i>Organizimi i seancave të pajtimit të bashkeshortëve me objektiv të pajtimit të tyre.</i>
14	Besimi i fëmijës	5	<i>Besimi i fëmijëve bëhet pasi pajtimi bashkeshortor nuk është arritur dhe vlerësohet lidhja e fëmijës me prindin si dhe kujdesi i prindit ndaj fëmijës. Vizita në terren me qëllim të identifikimit të kushteve ekonomike dhe sociale të dy prindërve dhe të përcaktohet cili është interesi më i mirë i fëmijës dhe të jepet mendimi me cilin prind fëmiju ambientohet me mirë.</i>
15	Kontaktime	9	<i>Me vendim të gjykatës ku specifikohet që kontaktimi të mbahet në lokalet e QPS- së, në i përcjellim që keto kontaktime të realizohen në rrethana sa me të mira.</i>
16	Pjesëmarrja gjatë intervistimit në polici	23	<i>Ne si Organ i Kujdestarisë jemi të obliguar që t'i mbrojmë interesat e fëmijës gjatë intervevisimit të tyre</i>

			<i>në polici. Gjithashtu gjatë intervistimit të viktimave të dhunës, ne marrim pjesë për mbeshetje dhe këshillim të viktimës për me tutje.</i>
17	Viktimat e dhunës në familje	19	<i>Pasi jemi njoftuar me viktimën i ndërmarrim hapat si ne vijim: vendosja në strehimore (sipas nevojës), pjesëmarrja gjatë marrjes së rrobave në shtëpi me shoqerimin e policisë, organizojmë bashkimin e nënës me fëmijën në rast se fëmija ka mbetur i ndarë nga nëna, këshillim psiko- social, ofrojmë pagesë për banim social të viktimave të dhunës, i ndihmojmë rreth punësimit të viktimës, i ndihmojmë rreth perfshirjes së fëmijëve në institucionet parashkollore, si dhe ofrimi i pakove ushqimore.</i>
18	Konflikt familjar	2	<i>Këshillim psikosocial për zgjidhje të konflikteve mes antarëve të familjes.</i>
19	Ngacmim seksual	0	<i>Prezenca në seanca gjyqësore dhe këshillim si dhe percjellja e viktimës.</i>
20	Caktim i kujdestarit të përkohshëm	0	<i>Për nevojat gjyqësore me intervistimin e antarëve të familjes caktohet një kujdestar.</i>
21	Person me problem të shendetit mendor	0	<i>Ndihmë e përgjithshme për klientin si dhe vendosja në strehim rezidencial.</i>
22	Strehim rezidencial	1	<i>Kompletimi i dokumentacionit të nevojshëm dhe sipas pranimi të antarëve të komisionit të rregullorës bazë, vizitat e rregullta në shtëpi.</i>
23	Vërtetim për zotësi të veprimit	168	<i>Në bazë të dëshmive të siguruar nga Gjykata. Ne i lëshojmë</i>

24	Konstatim për lirim nga shtetësia	2	<i>Ne bazë të dokumentacionit që posedon QPS, e që nuk ka të caktuar alimentacion për fëmijët e tij e lëshojmë vërtetimin për lirim nga shtetësia.</i>
25	Konstatim për marrje të shtetësisë	6	<i>Në bazë të deklaratës nën betim që ka mjete të mjaftueshme për jetesë në Kosovë dhe nuk do të bëhet barrë e sistemit social të shtetit dhe argumentimi i vendbanimit përmes faturës së rrymës. Ne i lëshojmë vërtetimin për fitim ose rifitim të shtetësisë.</i>
26	Qertifikatë për punësim	20	<i>Në bazë të dëshmive të siguruar nga Gjykata. Ne i lëshojmë vërtetimin që nuk i'u ka marrë zotësia e veprimit për punësim.</i>
27	Konstatime të ndryshme	7	<i>Qendra për punë Sociale sipas nevojave të ndryshme lëshon edhe konstatime të ndryshme.</i>
			<i>vërtetimin që nuk i'u ka marrë zotësia e veprimit për armëmbajtje.</i>

	Aktivitetet/aktivnosti	Kategoria I-rë	Kategoria II-të	Gjithsejt / Okup.
APLIKIMI APLIKACIJA	1. Nr. i rast. qe kane aplik. për herë të parë Br. Aplik. koji su apli ko.po prvi put	8	6	14
	Sa prej tyre janë të aprovuara Koliko od njih je odobreno	0	2	2
	Numri i landve te cilat jane ne shqyrtim	0	-	0
	Sa prej tyre janë të refuzuara Koliko od njih je odbijeno	0	1	1
RIAPLIKIMI RIAPLIKACIJA	2. Nr. i rast. të larguara për mos ri-aplikim Br. prdmeta deregistrovani zato sto nisu re-aplikovali	-	-	-
	Nr. i rasteve që kanë ri-aplikuar Br. predmeta koji su re-aplikovali	115	137	252
	Nr. i rasteve të larguar për mungesë të dokumentacionit Koliko od njih je derigistrovano zbog ne kompletiranja dokumentacije	0	0	0
VERIFIKIMI VERIFIKACIJE	3. Numri total i familjeve të verifikuara/riverifikuara Ukupan br. porodica verifik./riverifikov.	115	137	252
	3.1 Sa prej tyre janë aprovuar Koliko od njih je usvojeno.	112	137	252
	3.2 Sa prej tyre janë refuzuar/çregjistruar Kol.od njih je odbijeno/derigistrovano	6	4	10

KOM . MJEKSOR DOK . KOMISIA	4. Nr. i rasteve të dërg.në Komis.Mjek.(KM) Broj predmeta poslatih na Lekarsku Komisiju(LK)	71	51	122
	4.1 Numri i rasteve të aprovuara nga KM Broj predmeta odobrenih od LK	71	51	122
	4.2 Numri i rasteve të refuzuara nga KM Broj predmeta odbijenih od LK	0	-	0
	4.3 Nr. i rasteve të kthjera nga KM për kompletim dokumentacioni Broj predmeta vracenih od LK za kompletiranje Dokumentacije	5	-	5
ANKESAT ZALBE	5. Nr. i ankesave të paraqitura nga shfrytëzuesit Broj zalbi podneti od korisnika	-	-	-
	a) Në shkallë të parë (I) Na prvi stepen (I)	-	-	-
	b) Në shkallë të dytë (II) Na drugi stepen (II)	-	-	-
	5.1 Nr. i ankesave të aprovuara Broj odobrenih zalbi	-	-	-
	5.2 Nr. i ankesave të refuzuara Broj odbijenih zalbi	-	-	-
	5.3 Nr. i ankesave në shqyrtim Broj zalbi u procesu resavanja	-	-	-
	5.4 Kontestet në Gjykata Sudski sporovi	-	-	-
	a) Konteste të pranuar Odobreni sporovi	-	-	-
	b) Konteste të refuzuara Odbijeni sporovi	-	-	-

- Vërtetime49
- Vërtetimet për nevoja personale.....10

- Vërtetimet për marrjen e shtetësisë Kosovare.....	35
- Marrje e fletëinformacionit për ndihmë sociale.....	104
- Kartela të lëshuara për familjet shfrytëzuese të SNS-së.....	156
- Vizitë rutinore tek rastet sociale.....	157
- Rastet e larguara nga krasimi përmes ATK.....	6
- Raste që kanë aplikuar përmes pilotimit në QPS.....	0
- Gjithsej raste aktive	360
- Vizita në teren	18

Projekti për Reformën e Sistemit të Asistencës Sociale

- Vlen të theksohet se nga data 20.05.2024 kemi filluar me pilotimin e SAS-it, i cili është projekt testimi i një modeli të ri për ofrimin e asistencës sociale, ku nga ky projekt mund të përfitojnë familjet e varfra dhe në kushte të rënda ekonomike, si vazhdimësi e skemës sociale egzistuese, por me dallimin që është pa kritere diskriminuese. Ky është projekt qeveritar i përkrahur nga Banka Botërore.
- Nga data 14.08.2024 kemi pranuar listën e parë në Qendren për Punë Sociale nga Ministria e Financave për SAS Pilotimin dhe kemi realizuar vizitat te 41 familjet sipas listës së dhënë.
- Me datë 05.11.2024 kemi pranuar listën e përfituesve të listës së parë ku gjithsej janë 36 përfitues.
- Me datë 18.09.2024 kemi pranuar listën e dytë në Qendren për Punë Sociale nga Ministria e Financave për SAS Pilotimin dhe kemi realizuar vizitat te 76 familjet sipas listës së dhënë.
- Me datë 11.11.2024 kemi pranuar listën e tretë në Qendren për Punë Sociale nga Ministria e Financave për SAS Pilotimin dhe kemi realizuar vizitat te 85 familjet sipas listës së dhënë.
- Me datë 13.01.2025 kemi pranuar listën e katërt në Qendren për Punë Sociale nga Ministria e Financave për SAS Pilotimin , e cila ka përmbajtur gjithsej 83 familje të cilat i kemi verifikuar.
- Me datë 27.05.2025 kemi pranuar listën e pestë në Qendren për Punë Sociale nga Ministria e Financave për SAS Pilotimin , e cila ka përmbajtur gjithsej 29 familje të cilat i kemi verifikuar.
- **Gjithsej përfituese nga SAS- Pilotimi janë 97 familje.**

Ky proces na ka ndihmuar në rritjen e transparencës në përzgjedhjen e përfituesve, standartizimin e vlerësimit të nevojave sociale dhe testimin praktik të funksionalitetit të sistemit SAS- Pilotimit në terren. Gjatë kësaj periudhe gjashtë mujore kemi realizuar të gjitha verifikimet në terren sipas afateve të përcaktuara dhe kemi siguruar transparencë në vlerësimin e përfituesve.

Jemi të përgatitur dhe të angazhuar për të vijuar me fazat e ardhshme të këtij projekti, në pritje të udhëzimeve të mëtejme nga insitucionet përkatëse, dhe për të kontribuar në përmirësimin e mëtejshëm të skemës së asistencës sociale në përputhje me standardet e reja.

Ndërsa për gjashtëmuajorin e dytë:

Në kuadër të kompetencave të saj ligjore dhe në përputhje me politikat dhe orientimet strategjike të Kryetarit të Komunës së Istogut, Drejtoria e Mirëqenies Sociale zhvillon veprimtarinë e saj në fushën e shërbimeve sociale, duke qenë përgjegjëse për planifikimin dhe zbatimin e masave dhe aktiviteteve që synojnë mbështetjen e qytetarëve në nevojë.

Plani i Punës për vitin 2026 përbën një dokument planifikues dhe drejtues për veprimtarinë e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale, i hartuar me qëllim të përmirësimit të kushteve të jetesës, fuqizimit të përfshirjes sociale dhe garantimit të ofrimit të shërbimeve cilësore, të qasshme dhe të qëndrueshme për qytetarët e Komunës së Istogut.

Duke u mbështetur në analizën e situatës sociale dhe ekonomike të komunitetit, si dhe në përvojën e fituar gjatë realizimit të aktiviteteve në vitet paraprake, ky plan përcakton prioritetet dhe drejtimet kryesore të veprimit për vitin 2025, me fokus në ndërhyrje të drejtpërdrejta dhe të orientuara drejt rezultateve konkrete.

Plani i Punës i Drejtorisë së Mirëqenies Sociale për vitin 2026 është ndërtuar mbi bazën e punës së deritanishme të drejtorisë, detyrave të realizuara në vitet e kaluara, si dhe objektivave dhe përgjegjësisë të përcaktuara për periudhën planifikuese 2026, duke marrë parasysh kapacitetet institucionale dhe burimet në dispozicion.

Qëllimi kryesor i këtij plani është përmirësimi i mirëqenies sociale dhe ofrimi i ndihmës së nevojshme për individët dhe familjet në gjendje të vështirë sociale, me synim rritjen e sigurisë sociale dhe të cilësisë së jetës në Komunën e Istogut.

Përmes këtij plani pune, Drejtoria e Mirëqenies Sociale shpreh angazhimin e saj për veprim transparent, profesional dhe efikas në realizimin e përgjegjësisë institucionale dhe në shërbim të qytetarëve.

Gjatë vitit 2025, *Drejtorija e Mirëqenies Sociale* ka realizuar një sërë projektesh dhe aktiviteteve me rëndësi të veçantë, me qëllim të përmirësimit të mirëqenies sociale dhe ofrimit të shërbimeve cilësore për kategoritë më të ndjeshme të shoqërisë.

Në këtë kuadër, janë realizuar këto projekte dhe aktivitete:

1. Ofrimi i shërbimeve logopedike, psikologjike dhe sociale për fëmijët me nevoja të veçanta, ku komuna jonë është komuna e parë që ka ofruar këto shërbime në mënyrë të organizuar dhe të qëndrueshme.

Aktualisht, këto shërbime funksionojnë në kuadër të një klase me rreth 18 fëmijë, të cilët në mënyrë të vazhdueshme përfitojnë nga shërbimet profesionale. Përveç mbështetjes psikologjike dhe sociale, Drejtoria ka qenë vazhdimisht pranë këtyre fëmijëve dhe familjeve të tyre, duke ofruar përkrahje të vazhdueshme.

Në çdo festë dhe datë të veçantë, organizohen aktivitete të ndryshme dhe shpërndahen dhurata, ku përfitojnë si fëmijët ashtu edhe familjet e tyre.

Në këtë klasë, fëmijët përfshihen në një trajnim gjithëpërfshirës, duke përfshirë përmirësimin e aftësive, zhvillimin personal, përkrahjen sociale si dhe kujdesin ndaj ushqyerjes së tyre.

2. Subvencionimi i nënave lehona, si mbështetje financiare për përmirësimin e mirëqenies familjare dhe kujdesit ndaj fëmijëve.
3. Subvencionimi i nënave vetëushqyese, me qëllim të përkrahjes së tyre sociale dhe ekonomike. Drejtoria u ka qëndruar vazhdimisht pranë, duke i ndihmuar në çdo sfidë përmes mbështetjes financiare, pakove ushqimore, veshmbathjes, mjeteve shkollore si dhe sigurimit të banimit, i cili përfshin të gjitha kushtet e nevojshme për një jetë dinjitoze.
4. Subvencionimi i familjeve strehuese, ku mbështetja financiare është trefishuar nga 500 € në 1,500 €, duke rritur ndjeshëm përkrahjen për këto familje.

Komuna jonë është e vetmja në rajon që ka tri familje strehuese aktive, të cilat kanë shprehur vullnet të plotë dhe përkushtim të vazhdueshëm, si rezultat i bashkëpunimit dhe mbështetjes së pandërprerë nga Drejtoria.

Këto familje përkrahen gjithashtu me materiale ushqimore, mbështetje financiare, mjete shkollore, veshmbathje dhe lodra për fëmijët.

5. Subvencionimi i viktimave të dhunës në familje, në funksion të rehabilitimit, mbrojtjes dhe integritetit të tyre social.
6. Realizimi i pagesës së qirasë për familjet në nevojë dhe në kushte të vështira ekonomike, ku gjatë vitit janë mbështetur 15 familje.
7. Subvencionimi i Shtëpisë së Sigurt nga Drejtoria e Mirëqenies Sociale, si mekanizëm i rëndësishëm për mbrojtjen dhe sigurinë e viktimave të dhunës në familje.
8. Dyfishimi i shpërndarjes së lëndëve djegëse (dru zjarri) për familjet në nevojë, ku numri i përfituesve është rritur nga 20 në 50 familje, me nga 3 metra dru zjarri për secilën familje.
9. Inspektime javore për të moshuarit në Shtëpinë e Pleqve, me qëllim të monitorimit të kushteve të jetesës dhe ofrimit të kujdesit adekuat. Përveç inspektimeve, Drejtoria është vazhdimisht pranë të moshuarve, veçanërisht gjatë festave dhe datave të rëndësishme, duke organizuar dreka të përbashkëta ku përfshihet edhe stafi, shetitje të ndryshme brenda territorit, si dhe aktivitete të shumta argëtuese e sociale, të cilat ndikojnë pozitivisht në mirëqenien e tyre emocionale dhe psikologjike.
10. Organizimi i aktiviteteve të ndryshme për rezidentët, përfshirë shetitje periodike dhe aktivitete sociale, me qëllim të përmirësimit të mirëqenies fizike dhe psikologjike.

11. Funksionalizimi i Qendrës së Qëndrimit Ditor, përfshirë zgjedhjen e Pensionistit të Vitit dhe mbulimin e shpenzimeve të Shoqatës së Pensionistëve.
12. Shpërndarja e mbi 400 pakove ushqimore për familjet në nevojë.
13. Shpërndarja e mjeteve shkollore për fëmijët jetim, në mbështetje të arsimimit dhe integritit të tyre shoqëror.
14. Miratimi i Planit Strategjik për Fëmijët me Nevoja të Veçanta, ku komuna jonë është komuna e parë që ka hartuar dhe miratuar një plan të tillë strategjik.
15. Furnizimi me karroca elektrike për të moshuarit e palëvizshëm, me qëllim të rritjes së pavarësisë dhe përmirësimit të cilësisë së jetës së tyre.

Duke ju referuar muajit Qershor-Dhjetor 2025 mbi detyrat, obligimet, përgjegjësitë dhe gjendjes mbi mbarvajtjen e punëve në Shtëpinë për Komunitete japim këtë raport:

Raport pune:

Të dhënat në këtë raport janë të sakta dhe të bazuara, andaj duke u mbështetur në këtë raport ju ofrojmë keto të dhëna:

18 Rezident

8 meshkuj

10 femra

QPS- Istog 3

QPS-Pejë 7

QPS-Klinë 4

QPS-Gjakovë 1

QPS-Deqan 2

QPS-Junik 1

18 Nacionalitetit shqiptar

Gjendja shëndetësore e Rezidenteve

Gjendja shëndetësore e Rezidenteve për këtë periudhë kohore ishte relativisht e mirë e vënë nën kontroll.

Rezidentë gjatë kësaj periudhe ju është ofruar një shërbim mjaft cilësor, falë angazhimit të stafit infermieror duke i dërguar në qendrat spitalore QKUK-Prishtinë, spitali rajonal-Pejë, QMF etj Për ekzaminime sipas nevojave të Rezidentëve janë kryer analizat laboratorike, vaksinimi është kryer sipas protokollit.

Stafi I punëtoreve

Pëbërja strukturore e punëtorëve:

1. Drejtor
5. Infermier
3. Kuzhinier
4. ndihmes mjekësor
1. Mirëmbajtës

Falë diciplines dhe angazhimeve të punëtorëve kemi një gjëndje mjaft stabile dhe sukses që vlenë të veqohet.

Puna në këtë Institucion bëhet sipas planit dhe akteve të tjera në fuqi.

Vendosja dhe sistemimi I rezidenteve të rinjë

Brenda këtij gjashtëmuajori nuk kemi pasu pranim të ndonjë Rezidenti të ri.

Vdekja e Rezidenteve

Gjatë kësaj peridhe kemi pasur 2 vdekje.

Furnizimi dhe sherbime:

Gjatë kësaj periudhe kohore kemi qenë të furnizuar 146ire deri ne këtë moment kur raportojmë. Artikujt janë përmbajtësor me vlera normale ushqyese dhe të bazuara në cilësi. Falë koordinimit më të tjerët si pale mbështetës qëndrojmë mirë. Të gjithë artikujt arrijnë me kohë dhe sipas këkesës për të gjithë artikujt ushqimor, medikamenteve,hixhienes etj. Për çdo artikull që hynë mbrenda I nënshtrohet komisionit AD HOC për pranim prej tre anëtareve me një verifikim edhe nga Drejtoresha e Institucionit.

Vizitat:

Vizitat në këtë institucion janë gjithmonë të rregullta sipas orarit dhe sidomos gjatë festave nga familjaret e Rezidenteve.

Donacionet:

Gjatë kesaj periudhe kemi pasur një donacion nga Organizata “SYRI I VIZIONIT” ku na kanë dhuruar nje televizion si dhe kemi pasur një drakë nga Organizata e” QENDRA PËR JETË TË PAVARUR” ku na sollen një drekë, si dhe dhurata për të moshuarit e shtëpisë.

	Aktivitetet/aktivnosti	Kategoria I-rë	Kategoria II-të	Gjithsejt / Okup.
APLIKIMI APLIKACIJA	4. Nr. i rast. qe kane aplik. për herë të parë Br. Aplik. koji su apli ko.po prvi put	23	16	39
	Sa prej tyre janë të aprovuara Koliko od njih je odobreno	4	2	6
	Numri i landve te cilat jane ne shqyrtim	0	-	0
	Sa prej tyre janë të refuzuara Koliko od njih je odbijeno	0	4	4
RIAPLIKIMI RIAPLIKACIJA	5. Nr. i rast. të larguara për mos ri-aplikim Br. prdmeta deregistrovani zato sto nisu re-aplikovali	-	-	-
	Nr. i rasteve që kanë ri-aplikuar Br. predmeta koji su re-aplikovali	150	185	335
	Nr. i rasteve të larguar për mungesë të dokumentacionit Koliko od njih je derigistrovano zbog ne kompletiranja dokumentacije	0	0	0
VERIFIKIMI VERIFIKACIJE	6. Numri total i familjeve të verifikuara/riverifikuara Ukupan br. porodica verifik./riverifikov.	150	185	335
	3.3 Sa prej tyre janë aprovuar Koliko od njih je usvojeno.	150	185	335

	3.4 Sa prej tyre janë refuzuar/çregjistruar Kol.od njih je odbijeno/derigistrovano	6	4	10
--	---	----------	----------	-----------

KOM . MJEKSOR DOK . KOMISIA	4. Nr. i rasteve të dërg.në Komis.Mjek.(KM) Broj predmeta poslatih na Lekarsku Komisiju(LK)	107	58	165
	4.1 Numri i rasteve të aprovuara nga KM Broj predmeta odobrenih od LK	107	58	165
	4.2 Numri i rasteve të refuzuara nga KM Broj predmeta odbijenih od LK	0	-	0
	4.3 Nr. i rasteve të kthjera nga KM për kompletim dokumentacioni Broj predmeta vracenih od LK za kompletiranje Dokumentacije	5	-	5
ANKESAT ZALBE	5. Nr. i ankesave të paraqitura nga shfrytëzuesit Broj zalbi podneti od korisnika	-	-	-
	c) Në shkallë të parë (I) Na prvi stepen (I)	-	-	-
	d) Në shkallë të dytë (II) Na drugi stepen (II)	-	-	-
	5.1 Nr. i ankesave të aprovuara Broj odobrenih zalbi	-	-	-
	5.2 Nr. i ankesave të refuzuara Broj odbijenih zalbi	-	-	-
	5.5 Nr. i ankesave në shqyrtim Broj zalbi u procesu resavanja	-	-	-
	5.6 Kontestet në Gjykata Sudski sporovi	-	-	-
	a) Konteste të pranuar Odobreni sporovi	-	-	-

	b) Konteste të refuzuara Odbijeni sporovi	-	-	-
--	---	---	---	---

- Vërtetime	49
- Vërtetimet për nevoja personale.....	14
- Vërtetimet për marrjen e shtetësisë Kosovare.....	35
- Marrje e fletëinformacionit për ndihmë sociale.....	210
- Kartela të lëshuara për familjet shfrytëzuese të SNS-së.....	198
- Vizitë rutinore tek rastet sociale.....	255
- Rastet e larguara nga krasimi përmes ATK.....	6
- Raste që kanë aplikuar përmes pilotimit në QPS.....	0
- Gjithsej raste aktive	357
- Vizita në teren	64

Projekti për Reformën e Sistemit të Asistencës Sociale

- Vlen të theksohet se nga data 20.05.2024 kemi filluar me pilotimin e SAS-it, i cili është projekt testimi i një modeli të ri për ofrimin e asistencës sociale, ku nga ky projekt mund të përfitojnë familjet e varfra dhe në kushte të rënda ekonomike, si vazhdimësi e skemës sociale egzistuese, por me dallimin që është pa kritere diskriminuese. Ky është projekt qeveritar i përkrahur nga Banka Botërore.
- Nga data 14.08.2024 kemi pranuar listen e parë në Qendren për Punë Sociale nga Ministria e Financave për SAS Pilotimin dhe kemi realizuar vizitat te 41 familjet sipas listes së dhënë.
- Me datë 05.11.2024 kemi pranuar listën e përfituesve të listës së parë ku gjithsej janë 36 përfitues.
- Me datë 18.09.2024 kemi pranuar listën e dytë në Qendren për Punë Sociale nga Ministria e Financave për SAS Pilotimin dhe kemi realizuar vizitat te 76 familjet sipas listes së dhënë.
- Me datë 11.11.2024 kemi pranuar listën e tretë në Qendren për Punë Sociale nga Ministria e Financave për SAS Pilotimin dhe kemi realizuar vizitat te 85 familjet sipas listes së dhënë.
- Me datë 13.01.2025 kemi pranuar listën e katërt në Qendren për Punë Sociale nga Ministria e Financave për SAS Pilotimin , e cila ka permbajtur gjithsej 83 familje të cilat i kemi verifikuar.
- Me datë 27.05.2025 kemi pranuar listën e pestë në Qendren për Punë Sociale nga Ministria e Financave për SAS Pilotimin , e cila ka permbajtur gjithsej 29 familje të cilat i kemi verifikuar.

- Gjithsej përfituese nga SAS- Pilotimi janë 97 familje.

Ky proces na ka ndihmuar në rritjen e transparencës në përzgjedhjen e përfituesve, standartizimin e vlerësimit të nevojave sociale dhe testimin praktik të funksionalitetit të sistemit SAS- Pilotimit në terren. Gjatë kësaj periudhe gjashtë mujore kemi realizuar të gjitha verifikimet në terren sipas afateve të përcaktuara dhe kemi siguruar transparencë në vlerësimin e përfituesve.

Jemi të përgatitur dhe të angazhuar për të vijuar me fazat e ardhshme të këtij projekti, në pritje të udhëzimeve të mëtejme nga insitucionet përkatëse, dhe për të kontribuar në përmirësimin e mëtejshëm të skemës së asistencës sociale në përputhje me standardet e reja.

	Lloji i shërbimit	Numri i rasteve	Përshkrimi i Shërbimeve të ofruara në sektorin e Shërbimeve Sociale
1	Fëmijë të braktisur	2	<i>Përcaktimi i kujdestarit ligjor, vendosja në strehim familjar,</i>

Institucioni i Qendrës për Punë Sociale në kuadër të Drejtoratit për Mirëqenien Sociale të

Komunës së Istogut, gjegjësisht sektori i Shërbimeve Sociale ka ofruar shërbime për qytetarë të kategorive të ndryshme, drejtëpërdrejtë si dhe me aktivitete të shumta duke bashkëpunuar me zingjirin e institucioneve, të cilat e kanë objektiv mirëqenien e fëmijëve, të rriturve si dhe të moshuarve.

Pergjatë gjashtë mujorit të dytë të vitit 2025 llojet e shërbimeve që janë ofruar nga sektori i Shërbimeve Sociale janë të shumta dhe në gjithmonë jemi në dispozicion, duke përfshirë edhe Organin e Kujdestarisë i cili është 24 orë nën shërbimin e qytetarëve në nevojë.

Në tabelën në vijim janë të paraqitura shërbimet dhe numri total për secilën nga to si dhe përshkrimi i Shërbimeve të ofruara.

			<i>ndihmat e pergjithshme per familjet strehuese dhe per femijet.</i>
2	Adoptim	0	<i>Adoptimi është një aspekt i mbrojtjes së femijës, vlerësimi i familjës për adoptim dhe monitorimi fazës paraadoptuese.</i>
3	Keqtrajtim i fëmijës	2	<i>Keshillim psiko-social me familje</i>
4	Strehim familjar tek familja strehuese	2	<i>Ofrimi i strehimit femijëve të braktisur dhe të lënë pas dore dhe percjellja e trajtimit të fëmijëve në familje strehuese.</i>
5	Strehim familjar tek të afërmit	0	<i>Ofrim i strehimit tek familja e gjerë dhe percjellja e zhvillimit dhe trajtimit të tyre.</i>
6	Kujdestaria për të mitur	2	<i>Fëmija pa kujdes prindëror duhet të ketë një kujdestar ligjor.</i>
7	Fëmijë me aftësi të kufizuar të plotë (FAKP)	8	<i>Kompletimi i dokumentacionit, pas vleresimit të komisionit mjekësor percjellet mundësimi i marrjes së pagesës perkatëse si dhe monitorimi i Qendrës Ditore për FAKP dhe udhëzimet e nevojshme.</i>
8	Braktisje e shkollës	0	<i>Bashkëpunimi me shkolla, me prindër me fëmijë si dhe këshillime për të gjitha keto ne interes me të mirë të fëmijëve.</i>
9	Fëmijë me vështirësi ne sjellje	0	<i>Keshillime psiko-sociale, të miturit gjithashtu.</i>
10	Të miturit në konflikt me ligjin	64	<i>Këshillim dhe ofrim i shërbimit perkatës për referim në institucionet relevante.</i>
11	Martesa e të miturëve	0	<i>Vlerësimi i pjekurisë emocionale të të miturëve të cilët deshirojnë të hyjnë në martesë si dhe referimi në institucionet tjera.</i>
12	Ikje nga shtëpia	0	<i>Këshillim psiko-social dhe bashkim familjar dhe percjellja e zhvillimit të pergjithshëm të të miturit.</i>
13	Këshilla martesore		<i>Organizimi i seancave të pajtimit të bashkeshortëve me objektiv të pajtimit të tyre.</i>

14	Besimi i fëmijës	5	<i>Besimi i fëmijëve bëhet pasi pajtimi bashkëshortor nuk është arritur dhe vlerësohet lidhja e fëmijës me prindin si dhe kujdesi i prindit ndaj fëmijës. Vizita në terren me qëllim të identifikimit të kushteve ekonomike dhe sociale të dy prindërve dhe të përcaktohet cili është interesi më i mirë i fëmijës dhe të jepet mendimi me cilin prind fëmiju ambientohet me mirë.</i>
15	Kontaktime	11	<i>Me vendim të gjykatës ku specifikohet që kontaktimi të mbahet në lokalet e QPS- së, ne i percjellim që keto kontaktime të realizohen në rrethana sa me të mira.</i>
16	Pjesëmarrja gjatë intervistimit ne polici	41	<i>Ne si Organ i Kujdestarisë jemi të obliguar që t'i mbrojmë interesat e fëmijës gjatë interevisimit të tyre në polici. Gjithashtu gjatë intervistimit të viktimave të dhunës, ne marrim pjesë për mbeshetje dhe këshillim të viktimës për me tutje.</i>
17	Viktimat e dhunës ne familje	21	<i>Pasi jemi njoftuar me viktimën i ndërmarrim hapat si ne vijim: vendosja në strehimore (sipas nevojës), pjesëmarrja gjatë marrjes së rrobave në shtëpi me shoqerimin e policisë, organizojmë bashkimin e nënës me fëmijën në rast se fëmija ka mbetur i ndarë nga nëna, këshillim psiko- social, ofrojmë pagesë për banim social të viktimave të dhunës, i ndihmojmë rreth punësimit të viktimës, i ndihmojmë rreth përfshirjes së fëmijëve në institucionet parashkollore, si dhe ofrimi i pakove ushqimore.</i>
18	Konflikt familjar	7	<i>Këshillim psikosocial për zgjidhje</i>

			<i>të konflikteve mes antarëve të familjes.</i>
19	Ngacmim seksual	0	<i>Prezenca në seanca gjyqësore dhe këshillim si dhe percjellja e viktimës.</i>
20	Caktim i kujdestarit të përkohshëm	0	<i>Për nevojat gjyqësore me intervistimin e antarëve të familjes caktohet një kujdestar.</i>
21	Person me problem të shëndetit mendor	0	<i>Ndihmë e përgjithshme për klientin si dhe vendosja në strehim rezidencial.</i>
22	Strehim rezidencial	0	<i>Kompletimi i dokumentacionit të nevojshëm dhe sipas pranimi të antarëve të komisionit të rregullorës bazë, vizitat e rregullta në shtëpi.</i>
23	Vertetim për zotësi të veprimit	173	<i>Në bazë të dëshmive të siguruar nga Gjykata. Ne i lëshojmë vërtetimin që nuk i'u ka marrë zotësia e veprimit për armëmbajtje.</i>
24	Konstatim për lirim nga shtetësia	2	<i>Ne bazë të dokumentacionit që posedon QPS, e që nuk ka të caktuar alimentacion për fëmijët e tij e lëshojmë vërtetimin për lirim nga shtetësia</i>
25	Vertetim për marrje shtetësie	130	<i>Ne bazë të dokumentacionit që posedon QPS, vërteton që pala posedon mjete të mjaftueshme materiale për jetesë.</i>
26	Qertifikatë për punësim	17	<i>Në bazë të dëshmive të siguruar nga Gjykata. Ne i lëshojmë vërtetimin që nuk i'u ka marrë zotësia e veprimit për punësim.</i>
27	Konstatime të ndryshme	13	<i>Qendra për punë Sociale sipas nevojave të ndryshme lëshon edhe konstatime të ndryshme.</i>

Plani i projektve për vitin 2026 nga Drejtoria për Mirëqenie Sociale:

- Hapja e Qendres Ditore për fëmijet me nevojat të veçanta

- Hapja e qendres së qendrimit për të moshuarit në Banjë dhe Rakosh
- Blerja e pompes termike në shtëpinë e komuniteteve në Gurrakoc,

- Ofrimi i shërbime sociale dhe përkujdesje për rastet sociale të popullatës, brenda territorit të komunës
- Renovimi i shtëpisë së komuniteteve
- Organizimi i fushatave sensibilizuese me organizatat qeveritare dhe joqeveritare
- Mbeshtetja me pako ushqimore për familjet në nevojë .
- Mbeshtetja me lënd djegëse (dru zjarri) për familjet në nevojë
- Mbeshtetja me mjete shkollore për fëmijët e familjeve përfituese të Asistencës Sociale në Qendren për Punë Sociale.
- Përmirësimi i shërbimeve për fëmijet në nevojë
- Subvencionimi për nënat vetëushqyese
- Subvencionimi për fëmijët jetim
- Shërbime për grupe të cënueshme (të moshuarit , persona me aftësi të kufizuara, gratë dhe fëmijët në situata të rrezikshme)
- Bashkëpunimi me institucionet dhe organizatat e tjera.
- Aktivitetet kulturore dhe argetuese për integrim social.

1. Hapja e Qendrës Ditore për fëmijët me nevoja të veçanta

Ky projekt synon krijimin e një hapësire të specializuar për ofrimin e shërbimeve ditore për fëmijët me nevoja të veçanta në Komunën e Istogut. Qendra do të ofrojë mbështetje profesionale për zhvillimin fizik, emocional, psikologjik dhe social të fëmijëve, përmes shërbimeve si logopedi, psikologji, terapi zhvillimore dhe aktivitete edukative. Përmes këtij projekti synohet gjithashtu lehtësimi i barrës së kujdesit për prindërit dhe përmirësimi i përfshirjes sociale të fëmijëve.

2. Hapja e Qendrave të qëndrimit ditor për të moshuarit në Banjë dhe Rakosh

Ky projekt ka për qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës së personave të moshuar, veçanërisht në zonat rurale. Qendrat ditore do të ofrojnë hapësira për socializim, aktivitete rekreative, këshillim dhe mbështetje psikosociale. Hapja e këtyre qendrave do të ndihmojë në zvogëlimin e izolimit social të moshës së tretë dhe do të lehtësojë familjet që kujdesen për ta.

3. Blerja dhe instalimi i pompës termike në Shtëpinë e Komuniteteve në Gurrakoc

Ky projekt parashikon instalimin e një sistemi modern të ngrohjes dhe ftohjes për Shtëpinë e Komuniteteve në Gurrakoc. Përdorimi i pompës termike do të sigurojë kushte të përshtatshme për shfrytëzim të objektit gjatë gjithë vitit, do të ulë kostot e energjisë dhe do të rrisë efikasitetin energjetik të ndërtesës.

4. Ofrimi i shërbimeve sociale dhe përkujdesjes për rastet sociale në territorin e komunës

Ky projekt synon ofrimin e shërbimeve të vazhdueshme sociale për individët dhe familjet në nevojë, përfshirë vlerësimin e rasteve, këshillimin social, referimin institucional dhe mbështetjen emergjente. Përmes këtij projekti sigurohet mbrojtje sociale për kategoritë më të rrezikuara të popullsisë në Komunën e Istogut.

5. Renovimi i Shtëpisë së Komuniteteve

Renovimi i Shtëpisë së Komuniteteve ka për qëllim përmirësimin e kushteve infrastrukturore dhe funksionale të këtij objekti. Projekti do të përfshijë përmirësimin e hapësirave të brendshme, rregullimin e nyjeve sanitare dhe krijimin e kushteve më të mira për organizimin e aktiviteteve sociale, kulturore dhe edukative.

6. Organizimi i fushatave sensibilizuese në bashkëpunim me institucione qeveritare dhe joqeveritare

Ky projekt synon rritjen e ndërgjegjësimit të qytetarëve mbi çështje sociale të rëndësishme si dhuna në familje, të drejtat e fëmijëve, shëndeti mendor dhe përfshirja sociale. Fushatat do të realizohen në bashkëpunim me institucione publike dhe organizata joqeveritare, përmes aktiviteteve informuese dhe edukative.

7. Mbështetja me pako ushqimore për familjet në nevojë

Ky projekt parashikon shpërndarjen e pakove ushqimore për familjet me gjendje të rëndë ekonomike. Paketat do të përmbajnë produkte bazike ushqimore dhe do të kontribuojnë në sigurimin e nevojave elementare për ushqim, duke lehtësuar përkohësisht barrën financiare të familjeve përfituese.

8. Mbështetja me lëndë djegëse (dru zjarri) për familjet në nevojë

Ky projekt ka për qëllim sigurimin e ngrohjes gjatë sezonit dimëror për familjet që nuk kanë mundësi ekonomike për të siguruar lëndë djegëse. Mbështetja me dru zjarri do të kontribuojë në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe në mbrojtjen e shëndetit të anëtarëve të familjeve përfituese.

9. Mbështetja me mjete shkollore për fëmijët përfitues të Asistencës Sociale

Projekti synon sigurimin e mjeteve shkollore për fëmijët nga familjet përfituese të asistencës sociale, me qëllim të rritjes së përfshirjes në arsim dhe parandalimit të braktisjes shkollore. Mbështetja do të ndihmojë në krijimin e kushteve të barabarta për arsimin.

10. Përmirësimi i shërbimeve për fëmijët në nevojë

Ky projekt përfshin zhvillimin e aktiviteteve edukative, kulturore dhe sportive për fëmijët në nevojë, si dhe ofrimin e mbështetjes psikosociale. Qëllimi është fuqizimi i fëmijëve, zhvillimi i aftësive të tyre dhe përmirësimi i mirëqenies së përgjithshme.

11. Subvencionimi për nënat vetëushqyese

Ky projekt synon mbështetjen financiare të nënave vetëushqyese për të përmirësuar kushtet e jetesës dhe për të siguruar mirëqenien e fëmijëve të tyre. Subvencionimi do të kontribuojë në zvogëlimin e varfërisë dhe rritjen e pavarësisë ekonomike.

12. Subvencionimi për fëmijët jetim

Ky projekt ka për qëllim ofrimin e mbështetjes financiare dhe sociale për fëmijët jetim, me synim përmirësimin e kushteve të jetesës, përkrahjen në arsim dhe integrimin e tyre në shoqëri.

13. Ofrimi i shërbimeve për grupet e cenueshme

Ky projekt përfshin ofrimin e shërbimeve sociale për grupet e cenueshme, si personat e moshuar, personat me aftësi të kufizuara, gratë dhe fëmijët në situata të rrezikshme. Shërbimet do të fokusohen në mbrojtje sociale, këshillim dhe përkrahje institucionale.

14. Bashkëpunimi me institucionet publike dhe organizatat e tjera relevante

Ky projekt synon forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve sociale. Bashkëpunimi do të realizohet me institucione qeveritare, organizata joqeveritare dhe partnerë të tjerë relevantë.

15. Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe argëtuese për integrim social

Ky projekt synon organizimin e aktiviteteve kulturore, rekreative dhe argëtuese për kategori të ndryshme sociale, me qëllim promovimin e integritit social, forcimin e kohezionit shoqëror dhe rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në jetën komunitare.

Për vitin 2025, angazhimi i *Drejtorisë së Mirëqenies Sociale* është të krijojmë një sistem të qëndrueshëm dhe të barabartë të mbrojtjes sociale, i cili jo vetëm që i përgjigjet sfidave aktuale të shoqërisë, por gjithashtu garanton që askush të mos mbetet pas. Ne besojmë se çdo qytetar ka të drejtë për mbështetje dhe mundësi të barabarta për të përmirësuar jetën e tij. Me bashkëpunim të ngushtë, përkushtim të palëkundur dhe veprim të përbashkët, synojmë të ndërtojmë një komunitet ku solidariteti, drejtësia dhe mirëqenia janë vlera që udhëheqin çdo vendim dhe iniciativë.

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE
RAPORTI I PUNËS PËR PERIUdhËN JANAR-DHJETOR 2025

Në kuadër të Drejtoratit për Shërbime Publike(Përfshirë Emergjencën), gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2025 nga ana e palëve gjegjësisht nga qytetarët na janë parashtruar **gjithsejtë 990** kërkesa nga ato kërkesa janë :

- **Të miratuara** **586**
- **Të refuzuara** **188**
- **Anuluar** **16**
- **Në Proces** **200**

Në kuadër të Drejtoratit për Shërbime Publike, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2025 nga ana e palëve gjegjësisht nga qytetarët na janë parashtruar kërkesa të ndryshmedhe atë për:

**Licencë Auto-Taxi,
Kërkesa për furnizim me gypa te ujësjellësit dhe kanalizimit,
Kërkesa për furnizim me material ndërtimor për raste emergjente,
Kërkesa nga lëmia e komunikacionit (transport , sinjalizim),
Kërkesa për furnizim me Zhavor për rrugët lokale te pa asfaltuara,
Kërkesë për prerje asfalti,
Kërkesa për shpenzime të varrimit, etj. Si dhe
Kërkesa për dalje ne teren dhe verifikim te vendit te ngjarjes**

SEKTORI I SHERBIMEVE PUBLIKE:

Gjatë kësaj periudhe bazuar ne kërkesat e qytetareve kemi dal në teren duke shqyrtuar dhe analizuar te gjitha rastet varësisht prej mundësive buxhetore ju kemi dal në ndihmë duke u bazuar në kontratat e aktiviteteve të ndryshme të cilat përmbushin edhe kërkesat e qytetareve qofshin ato furnizim me zhavorr,furnizim me gypa te ujësjellësit dhe kanalizimit etj. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe vjetore është përgatitur dokumentacioni me kohë për shpalljen të tenderëve të paraparë në planin buxhetor për vitin 2025. Gjatë vitit 2025 DSHP pas themelimit te komisionit komunal për hartimin e planit nder komunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave 2025-2030, dhe në bashkëpunim me komunat e Dukagjinit është përfunduar hartimi i këtij Plani dhe ka kaluar edhe ne Asamblenë Komunale .E po ashtu gjatë Viti 2025 është Grupi punues i koordinuar nga Drejtoria e Shërbimeve Publike ne bashkëpunim me organizatën GIZ-i dhe Konsulent te jashtëm jemi ne hartim e sipër Projektin e Fizibilitetit të Qëndresë Ricikluese në Komunën e Istogut

Ndërsa gjatë këtij viti nga planifikimi buxhetor për DSHP **janë realizuar këto projekte si me poshtë:**

NGA KODI BUXHETOR MALLERA DHE SHERBIME (ME KONTRATA KORNIZË)

- Mirëmbajtja dhe sanimi i pusetave, në vlerë prej 48,000.00€,
- Mirëmbajtja e ndriçimit publik,në vlerë prej 30,00.00€,
- Blerja dhe furnizimi me gypa te kanalizimit dhe ujësjellësit, në vlerë prej 45,365.45€,
- Eliminimi i mbeturinave nga hapësirat publike, në vlerë prej 21,850.00€,
- Riparimi i rrugëve lokale të rendit IV dhe sanimi i gjendjes nga vërshimet, në vlerë prej 100,881,00€,
- Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve lokale të asfaltuara,në vlerë prej 109,226.00€,
- Mirëmbajtja e Parkut të qytetit, në vlerë prej 15,125,.00€.

LISTA E PROJEKTEVE KAPITALE TE REALIZUAR JANË:

NDERTIMI I NDRIÇIMEVE PUBLIKE

- Ndërtimi i ndriçimit publik në Kovragë, në gjatësi L=5000m, në vlerë prej 25,000.00€,
- Ndërtimi i ndriçimit publik në Shushicë ne gjatësi L=3200m, në vlerë prej 15,000.00€,
- Ndërtimi i ndriçimit publik në Kaliqan,në gjatësi L=4470m, në vlerë prej 20,000.00€,

NDERTIMI I TROTUAREVE

- Ndërtimi i Trotuarit ne Shushicë te Epërme dhe Shushicë të poshtme në gjatësi L=1100m, ne vlerë prej 65,000€.
- Ndërtimi i Trotuarit në Istog të poshtëm me gjatësi prej L=1250m dhe vlerë prej 52,000€.

NDERTIMI I KANALIZIMEVE

- Ndërtimi i kanalizimit në Prigodë,në gjatësi L=1300m në vlerë prej 20,000€
- Ndërtimi i kanalizimit në Cerkolez-Lagja Sadriaj dhe Balaj, ,në gjatësi L=650m në vlerë prej10,000€,
- Ndërtimi i kanalizimit në Istog të poshtem,Rruga Hul Huli, në gjatësi L=750m, në vlerë prej10,000€,
- Ndërtimi i kanalizimit në Dubravë,Rruga Haki Hoti, në gjatësi L=1050m, në vlerë prej15,000€,
- Ndërtimi i kanalizimit në Lagjet Arifaj,Zekaj dhe Bardhecaj L=1300m, në vlerë prej 20,000€,
- Ndërtimi i kanalizimit në Shushicë të Ulët, në gjatësi L=600m, në vlerë prej 10,000€,
- Ndërtimi i kanalizimit në Saradran në gjatësi L=3000m, në vlerë prej45,000.0€,

PROJEKTETE TE NATYRAVE TJERA

- Ndërtimi i murit mbrojtës te mulliri ne Vrellë në vlerë prej 25,000.00€
- Ndërtimi i murit mbrojtës ne Shushicë në Vlerë prej 10,000.00€
- Ndërtimi i Urave në komunën e Istogut në vlerë 23,000.00€.,
- Trasimi i rrugëve në Istog të poshtëm Dubravë dhe Tomoc në vlerë prej 25,000.00€
- Vazhdimi i ndërtimi të tregut të ri në Istog, vazhdim..., në vlerë prej 146,000.00€,
- Ndërtimi i murit mbrojtës të mulliri në Vrellë, në vlerë prej 25,000.00€,

Nga kodi i subvencioneve janë realizuar 100 pagesa për shpenzime të varrimit, në vlerë prej 20,000.00€.

Po ashtu ne aspektin profesional ne si sektor kemi qenë të kyçur në kryerjen e shumë projekteve-paramasa dhe parallogarit, gjithashtu kemi qenë të kyçur në komisione për vlerësimin e tenderëve tjerë, mbikëqyrje

të projekteve të ndryshme dhe në verifikime të punimeve për projekte të ndryshme të Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe **Drejtoreve tjera në kuadër të komunës.**

INFRASTRUKTURA RRUGORE, NDRIÇIMI PUBLIK (MIRËMBAJTJA)

Në kuadër të mirëmbajtjes së infrastrukturës rrugore dhe ndriçimit publik të rrugëve lokale dhe qendrave urbane ne territorin e komunës, **për 651.39 km** rrugë zyrtare -të regjistruara në territor të komunës (bazuar në Listën me emërtim të rrugëve më gjatësi përkatëse- të lëshuar nga DPUM Nr.protok.47/2022, datë 07.04.2022), prej tyre **500.63 km** janë rrugë të shtruara-asfaltuara (bazuar ne raportet vit pas viti duke mos përfshirë asfaltimin e rrugëve në vitin 2025).

Si drejtori bazuar në menaxhimin e kontratave kornizë të nënshkruar, si kontratat për:“Mirëmbajtje verore dhe dimërore te rrugëve lokale”, “Riparimi i rrugëve lokale të rendit IV dhe sanimi i gjendjes nga vërshimet”, “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal – smartcity”, “Mirëmbajtje e ndriçimit publik”, konkretisht gjatë periudhës së vitit 2025 janë të mirëmbajtura rreth:

- **530km** rrugë në territor të komunës të mirëmbajtura gjatë se zonës verore (rrugë te asfaltuara dhe te pa asfaltuara - rendit IV), ne kuadër të kësaj kilometrazhe janë të përfshira edhe km të rrugëve regjionale dhe nacionale që kalojnë në territor të komunës së Istogut dhe që mirëmbahen rregullisht nga kompanitë e kontraktuara nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, të cilat janë 114 km,
- 600 km rrugë në territor të komunës të mirëmbajtura gjatë se zonës dimërore (të gjitha rrugët e asfaltuara dhe disa rrugë lidhëse të rendit IV- me ç’rast kushtet atmosferike dimërore në periudhën e vitit 2024/2025 kanë qenë pa te reshura te shumta bore, kështu qe ka pasur mundësi mbulimi thuajse i terë territorit të komunës për mirëmbajtje dimërore nga kompania kontraktuese), ne kuadër të kësaj kilometrazhe janë të përfshira edhe km të rrugëve regjionale dhe nacionale që kalojnë në territor të komunës së Istogut dhe që mirëmbahen rregullisht nga kompanitë e kontraktuara nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, të cilat janë 114 km,
- Rreth 71.55 km rrugë te cilat posedojnë trotuare (rrugë urbane, rrugë lokale dhe regjionale ne territor te komunës), bazuar ne punët e kryera përmes kontratave vit pas viti, duke përfshirë edhe 2.35 km trotuare të ndërtuara ne vitin 2025,
- Rreth 10.9 km, janë me shteg për biçikleta i ndërtuar para disa viteve, për deri sa ne vitet e fundit nuk është realizuar ndonjë projekt për shteg të Biçikletave.
- 108.18 km rrugë ne territor te komunës janë te pajisur me ndriçim publik bazuar ne punët e kryera përmes kontratave vit pas viti, duke përfshirë edhe ndërtimin e ndriçimit publik ne vitin 2025 në gjatësi prej 12.5 km, dhe i cili ndriçim në tersi mirëmbahet permanent nga kompania e kontraktuar (kontrata kornizë),
- 390km rrugë lokale kryesore janë të pajisura me sinjalizim horizontal dhe vertikal,ne kuadër te kësaj kilometrazhe 55 km janë rrugë urbane dhe 114 km rrugë Nacionale dhe Regjionale qe kalojnë ne territor te komunës janë te sinjalizuar dhe mirëmbahen rregullisht nga kompanitë e kontraktuara nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës,

- Ne territor te komunës janë te evidentuara rreth 120 vend ndalje për autobus (BUS Stacione) duke përfshirë edhe akset e rrugëve Regjionale e Nacionale qe kalojnë ne territor te komunës tonë, ku rreth 90 Bus Stacione janë të ndërtuara dhe te pajisura me shenjë përkatëse sinjalizuese.

TRANSPORTI PUBLIK I UDHËTARËVE

- Transporti publik, ne territorin e komunës së Istogut mbulohet kryesisht nga kompanitë transportuese që mbajnë linja nder urbane, të cilat linja lëshohen dhe vërtetohen nga Ministria e Infrastrukturës, **ndërsa** në zonat tjera rurale organizohet transporti lokal nga kompanitë komunale që kryesisht kanë linja që i përshtatet orarit shkollor të nxënësve, duke përfshirë njëkohësisht edhe transport të veçanet të nxënësve që kryhet me bus. Numri i vendbanimeve të përfshira në transportin publik duke përfshirë edhe trasat Regjionale e Nacionale që kalojnë përgjatë territorit tonë janë: rreth 40 lokalitete te territorit te komunës. Në transportin publik lokal janë gjithsejtë 6 kompani që veprojnë në kuadër të mbulimit të linjave komunale që kanë vërtetuar linjat nga DSHP, ku ju vazhdohet rendi i udhëtimit për periudhën 12 muaj (1 vit), para skadimit te afatit kompanitë janë te obliguara te parashirojnë kërkesë ne DSHP për vazhdimin e linjës komunale dhe përmbushjen e pagesës se taksës komunale sipas Rregullores komunale në fuqi. Në përfundim të vitit janë shtatë (6) kompani me leje pune me vlefshmëri që kryejnë transportin e udhëtareve apo transportin veçanet të nxënësve.
- Transporti me Auto-Taxi, gjatë vitit 2025 janë licencuar apo kanë vazhduar lejen e punës për këtë veprimtari 21 persona, të cilët e ushtrojnë veprimtarinë e transportit jashtë linjor.

PARKINGJET PUBLIKE

- Janë rreth 32 parkingje publike ne territor te komunës qe e kane te vendosur sinjalizimin me një kapacitet prej rreth 750 vetura, ndërsa parkingje për persona me aftësi te kufizuar ne 7 vend parkime publike është i destinuar për persona me aftësi te kufizuar, ndërsa për auto taxi janë 6 vende publike për këtë veprimtari me një kapacitet prej 35 vende për automjete, parkingjet në Istog (2) dhe qendrat Urbane: Gurrakoc (1), Vrellë (1), Rakosh (1), Banjë (1).

Në fund të vitit buxhetor 2025 është bërë edhe planifikimi i prokurimit për vitin vijues 2026.

ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM
RAPORTI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2025

HYRJE

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (në vazhdim do i referohemi si ZKKK), është përgjegjëse për rritjen mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve dhe për sigurinë e qasjes së drejtë të komunitetit në shërbimet publike në nivel komunal. Është pjesë integrale e Komunës dhe strukturës së përgjithshme administrative.

Që nga fillimi, ZKKK ka qenë e inkuadruar në procesin e përmirësimit të marrëdhënieve ndëretnike dhe formimit të klimës së duhur për riintegrim të të gjitha komuniteteve që jetojnë në Komunën e Istogut.

Struktura e ZKKK-së sipas pozitës, gjinisë dhe përkatnisë etnike, është paraqitur më poshtë.

NR	EMRI DHE MBIEMRI	POZITA	GJINIA
1.	Rasim Mahmutović	Shef i ZKKK-së	M
2.	Almina Eco	Zyrtare për te drejta dhe mundesi te barabarta të kominiteteve	F
3.	Vesna Malikovič	Zyrtare për kthim të qëndrueshëm	F
4.	Esad Samkić	Zyrtar për buxhet dhe financa	M
5.	Abedin Neziraj	Zyrtar për kordinimin e të drejtave dhe integrim të qendrushem	M
6.	Aida Kelmenaj	Zyrtare për integrim dhe drejta të kominiteteve	F
7.	Armend Keraj	Zyrtar për te drejta dhe mundesi te barabarta të kominiteteve	M

PËRMBLEDHJE

Gjatë peridhës së lartëcekur, ZKKK-ja në Komunën e Istogut ka pranuar gjithsej 34 lëndë.

Kemi realizuar vizita në terren, kemi pasur takime me organizta të huaja dhe vendore lidhur me realizimin e projekteve që ka ZKKK-ja.

Në kuadër të punëve të rregullta, ZKKK kryen edhe punë të tjera si në vijim:

- Angazhohet për integrimin e të gjitha komuniteteve në komunë tonë, duke iniciuar çështjen e bashkëjetesës së komuniteteve pakicë me atë shumicë;
- Merrë pjesë në mbledhjet e Komiteteve, si: Komitetin për Komunitete, dhe në këtë Komitetë kontribuonë dhe mbronë interesat e të gjitha komuniteteve të cilat jetojnë dhe punojnë në Komunën e Istogut.
- Bashkëpunon me Ministrin për Komunitete dhe Kthim me qëllim të realizimit të shumë projekteve në të mirë të të gjitha bashkësive minoritare etnike dhe bashkësive të tjera;
- Viziton familjet të cilat janë kthyer nga shtetet fqinjë dhe vendet tjera, me qëllim që të njihet me problemet e tyre në të cilat ata hasin dhe integrimin e tyre në shoqërinë Kosovare. Gjithashtu viziton edhe familjet që ende gjenden në hapësirat e shteteve fqinje, ku bisedon me ata persona të shpërngulur dhe njëkohësisht i njofton me mundësinë e kthimit dhe mënyrën si mund të kthehen ata.
- Bashkëpunon me organizatat joqeveritare të cilat merren me kthimin e personave të kthyer siç janë: UNHCR, IOM, USAID, MercyCorps, OSCE, DRC etj.

AKTIVITETET E PLANIFIKUARA (Në kuadër të Planit të Punës së ZKKK-së)

ZKKK-ja, duke u bazuar në kompetencat e saj, ka planin e punës, në të cilin përfshihen planifiket për aktivitet të cilat presin që të realizohen gjatë vitit. Planifikonë dhe menaxhon me të gjitha kodet buxhetore, me përjashtime të shpenzimeve komunale. Me poshtë i gjeni të listuara aktivitetet e planifikuara:

- Asfaltimi i rrugës "sarajeva dhe Isuf Visoqi" në Dobrushë
- Ndertimi I rruges Kamer Loshi ne Veriq
- Ndërtimi i rrugës "Shaban Hajrezaj" në Llukafc te Thatë
- Ndertimi I rruges ne lagjen Gerguri dhe Berishaj ne Llukafc
- Ndërtimi i rrugës "Musë Brahimi" dhe Nurqaj në Kashicë
- Asfaltimi i rrugës "Bjelopoljska" në Dobrushë
- Ndërtimi i rrugës në Llukafc të Thatë
- Ndertimi I rruges ne Saradran- Lugu i Drinit

AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

- Asfaltimi i rrugës "sarajeva dhe Isuf Visoqi" në Dobrushë
- Ndertimi I rruges Kamer Loshi ne Veriq
- Ndërtimi i rrugës "Shaban Hajrezaj" në Llukafc te Thatë
- Ndertimi I rruges ne lagjen Gerguri dhe Berishaj ne Llukafc
- Ndërtimi i rrugës "Musë Brahimi" dhe Nurqaj në Kashicë
- Ndërtimi i rrugës në Llukafc të Thatë
- Ndertimi I rruges ne Saradran- Lugu i Drinit

AKTIVITETET NË BASHKËPUNIM ME OJQ

- Komuniteti komunal për kthim ka jep ropozimin komisionit qëndror për ndërtimin të 20 shtepijave nga të cilet 19 janë te miratuara kurse 10 shtepija te propozuara ne vitin 2024 janë te ndertuara ne vitin 2025.

PROCESI I RIATDHESIMIT

Të riatdhesuar siapas SMR

- Sipas Sistemit të Mënaxhimit të Rasteve, kemi 6 persona të cilët janë riatdhesuar si individ dhe 1 familje kdy anëtarëshe.

Kërkesa të parashtruara pranë ZKKK-së

- Kemi gjithsej 7 kërkesa të parashtruara pranë ZKKK-së për ndihmë në Programi, të cilat KKR-ja i ka shqyrtuar dhe ka vendosur si në vijim:
- 2 kërkesa për Akomodim me qira, janë të refuzuara nga KKR-ja,
- 1 kerkese për rindertim eshte refuzuar nga KKR-ja,
- 2 kerkesa per orendi shtepiake janë te aprovuaranë nga KKR,
- 2 kërkesë për Renovim, janë te aprovuaranga KKR,

Përmbyllje:

- Raportimi i të dhënave nga të gjitha drejtoritë dhe nga Zyra e Kryetarit për periudhën Janar-Dhjetor 2025, i punuar nga Kabineti i Kryetarit në bashkëpunim me drejtoritë dhe sektoret e Komunës së Istogut.

Komuna Istog
Datë; 29.12.2025

Kryetari i Komunës
z. Ilir FERATI

